
Sasia dhe vendndodhja e stacioneve u përcaktuan duke u mbështetur tek Heinonen (2000) dhe Michaud (1998), në bashkëpunim me ekspertët e Impiantit të Trajtimit dhe banorët e zonës. Në figurën 2-3 janë paraqitur vendndodhjet e tre stacioneve; kurse për më tepër mbi batimetrinë e liqenit *shih* hartën topografike të ujëmbledhësit në figurën 1-4 tek Miho et al. (në këtë vëllim).

- Stacioni S1, pozicioni Gjatësi N41°26'44" Gjerësi EO19°52'9.4": ndodhet në afërsi të digës dhe portës së marrjes së ujit (Fig 2-1), në zonën më të thellë (thellësia maksimale e gjetur 45-48 m). Stacioni gjendet aty ku bashkoheshin më parë dy degëzimet kryesore të liqenit, pikërisht të lumit Tërkuza me atë të lumit të Bruzit. Sipas literaturës ky stacion përfaqëson më mirë kushtet limnologjike të liqenit.

- Stacioni S2, pozicioni Gjatësi N 41°26'36.3" Gjerësi EO19°53'7.6": ndodhet në jug-lindje të liqenit (thellësi maksimale 30-36 m); gjendet në krahun më kryesor, në të djathtë të ujëmbledhësit, në qendër të pjesës më të gjerë të degëzimit të dikurshëm të lumit Tërkuzë (lumit të Zall Bastarit); këtu mblidhen pikërisht gjithë prurjet kryesore dhe anësore të këtij degëzimi.

- Stacioni S3, pozicioni Gjatësi N41°27'28.3" Gjerësi EO19°52'34.0": ndodhet në verilindje (thellësi maksimale deri 32 m); ai gjendet në krahun e majtë të liqenit, në një pjesë të zgjeruar të shtratit të dikurshëm të lumit Bruz, pikërisht aty ku bashkohej më parë lumi i Bruz Zallit me atë të Bruz Malit; këtu mblidhen të gjitha prurjet kryesore të kësaj zone.

Monitorimi ka filluar në maj të vitit 2006 dhe ka përfunduar në maj të vitit 2008 me shpeshësi çdo dy muaj. Janë kryer gjithsej 13 ekspedita: në **vitin 2006** pikërisht në datat 20 maj, 15 korrik, 16 shtator dhe 8 nëntor; në **vitin 2007** në datat 13 janar, 17 mars, 12 maj, 23 korrik, 16 shtator dhe 25 nëntor; kurse në **vitin 2008** në 19 janar, 16 mars dhe 18 maj; në datën 28 shtator u bë edhe ekspeditë tjetër me kolegët nga Universiteti i Zyriut (*shih* Bachofen, Nr. 7 në këtë vëllim).

Matjeve dhe mostrave ujore u morën në thellësitë 1, 3, 5, 10, 15, 20, 30, 40 dhe 45 metra (për S2 dhe S3 deri në thellësinë maksimale të gjetur). Pas vitit të parë, monitorimi ka vazhduar vetëm në stacionin S1 meqenëse u arrit në

përfundimin se nuk kishte ndryshime thelbësore ndërmjet parametrave në të tre stacionet. Mostrat janë marrë duke përdorur shishen Ruttner (Hydro-Bios) me vëllim 2 litra. Uji për analizat kimike është transportuar në enë polietileni dhe ruajtur në të ftohtë (-20°C). Mostrat për oksigjenin e tretur dhe BOD-në janë marrë në enë qelqi Winkler 250 ml. Mostrat për përcaktimin e klorofileve janë marrë në enë polietileni 2.5 litra dhe janë filtruar në vend.

2.4. Metodat e matjeve dhe analizave kimike

Në tabelën 2-1 janë treguar parametrat e matura, parimet e metodave të matjeve si dhe referimi i literaturës për secilin parametër.

2.5. Rezultatet dhe diskutime

Në tabelën 2-2 janë dhënë rezultatet e përgjithshme të matjeve dhe analizave kimike të kryera gjatë monitorimit.

2.5.1. Temperatura

Temperatura e ujit është e rëndësishme për shkak se ajo ndikon fort në përmbajtjen e oksigjenit të tretur, në aktivitetin e biotës ujore, në shpejtësinë e mjaft reaksioneve kimike dhe, në veçanti, në dukurinë e shtresëzimit dhe të përzierjes dimërore të ujërave në liqen.

Në tabelën II-1 të Shtojcës II janë dhënë vlerat e temperaturës së matur në thellësi të ndryshme për gjithë ekspeditat e kryera. Në figurën 2-4 janë paraqitur ndryshimet e temperaturës mesatare gjatë periudhës së monitorimit për shtresën e epilimnit, hipolimnit, shtresën termokline dhe për të gjithë matjet.

Në figurën 2-5 janë dhënë vlerat e ndryshimeve ndërmjet temperaturës maksimale dhe minimale si dhe vlerat e temperaturës së ajrit. Shihet se shtresëzimi termik është zhvilluar plotësisht në muajin Korrik 2006 dhe 2007, kur ndryshimet e temperaturës ndërmjet shtresës sipërfaqësore dhe asaj të thellësisë janë rreth 19 gradë. Të dy shtresat nuk përzihen dhe paraqesin karakteristika të ndryshme fizike dhe kimike, sikur të kishim dy liqene të ndryshëm; në veçanti, kjo vlen për nivelin e oksigjenit të tretur. Shtresëzimi termik është i dukshëm deri në fund të shtatorit.

Gjatë periudhës dy-vjeçare janë vërejtur vetëm dy gjendje të përzierjes së plotë, i pari në Janar 2007 dhe i dyti nga Nëntori 2007 deri Janar 2008; në këto periudha gjithë shtresat e liqenit ishin plotësisht të përziera (ndryshimi i temperaturës me thellësinë është zero) (Fig. 2-4). Kjo tregon se ujëmbledhësi i Bovillës u përket grupit të **liqeneve monomitikë të ngrohtë** (Heinonen, 2000).

Tabela 2-1. Metodatat e matjeve dhe analizave kimike të monitorimit të liqenit të Bovillës / Measured parameters and chemical methods used for the monitoring of Bovilla Lake

Parametri	Parimi i matjes	Aparatura, Literatura
Temperatura, °C	Termometri (matje direkte)	Termometër;(APHA, 1988)
pH	Potenciometri (matje direkte)	HACH (2001); (APHA, 1988)
Përcjellshmëria elektrike, $\mu\text{S}/\text{cm}$	Konduktometri (matje direkte)	HACH (2001); (APHA, 1988)
Turbullia, NTU	Turbidimetri (matje direkte)	WTW model pHOtoFlex Turb 430 IR
Tejpamja, m	Disku Secchi (matje direkte)	Disku Secchi
Oksigjeni i tretur, mg/L	Metoda Winkler	Standard procedure 421A, (APHA, 1988)
BOD ₅ , mg/L dhe %		Standard procedure 507, (APHA, 1988)
Alkaliniteti, mg/L HCO ₃	Vëllimetri	Standard procedure 403, (APHA, 1988)
Fosfatet P-PO ₄ , mg/L	SF UV-VIS	Shimadzu UV-2401PC; Standard procedure 424 F, (APHA, 1988)
Nitratet N-NO ₃ , mg/L	SF UV	Shimadzu UV-2401PC; Standard procedure 418A (APHA, 1988)
Nitritet N-NO ₂ , $\mu\text{g}/\text{L}$	SF UV-VIS	Shimadzu UV-2401PC; Standard procedure 419 (APHA, 1988)
Amoniumi N-NH ₄ , mg/L	SF UV-VIS, metoda fenate	Shimadzu UV-2401PC; Standard procedure 417 C (APHA, 1988)
Pigmentet klorofilike (a,b,c, phytophytin)	SF UV-VIS, metoda trikromatike dhe kromatike	Shimadzu UV-2401PC; Standard procedure 10200 H (APHA, 1988)
Karboni organik total (TOC), mg/L	Metoda me kite 10054 HACH	HACH, US Patent
Absorbanca në UV-A 253.7 nm/cm	SF UV	Shimadzu UV-2401PC; Standard procedure 5910 B (APHA, 1988)
Indeksi i KMnO ₄ , mg/L O ₂	Vëllimetri	Standard procedure, (EN ISO 8467:2000)
Lëndët e ngurta në pezulli, mg/L	Peshim	Standard procedure, (APHA, 1988)
Hekuri, mg/L	SAA	AAS Varian 10+ SpectrAA
Zinku, mg/L		AAS Varian 10+ SpectrAA

Tabela 2-2. Vlerat e mesatares së përgjithshme dhe percentileve 90% dhe 10% gjatë periudhës Maj 2006-Maj 2008 në ujëmbledhësin e Bovillës / Means and percentile 90% and 10% for the water quality parameters of Bovilla Reservoir.

<i>Parametri i matur</i>	<i>Mesatarja</i>	<i>Percentile 10%</i>	<i>Percentile 90%</i>	<i>n</i>
Temperatura, °C	12.58	8.51	16.82	176
pH	7.99	7.88	8.09	176
Përcjellshmëria elektrike, µS/cm	305.7	298.5	313.8	155
Oksigjeni i tretur, mg/L	8.96	8.06	9.88	176
Ngopja me oksigjen, %	86.5	57.5	105.8	176
Alkaliniteti, mg/L HCO ₃ ⁻	156.3	147.4	165.1	175
Fosfatet, mg/L P-PO ₄	6.34	4.38	9.22	176
Nitratet (mg/L N-NO ₃)	0.172	0.121	0.232	176
Nitritet, µg/L N-NO ₂	6.59	5.15	8.03	175
Amoniumi (mg/L N-NH ₄)	0.04	0.021	0.064	175
Klorofili a, µg/L	1.36	0.23	1.94	169
Tejpamja, disku Secchi, m	2.6	2.0	3.1	25
Indeksi permanganatit, mg/L O ₂	5.77	5.55	6.02	176
Absorbanca UV-A 253.7/cm	0.018	0.016	0.020	176
Karboni organik (DOC), mg/L	4.06	1.40	7.56	22
BOD ₅ , mg/L O ₂	1.43	0.87	2.08	40
Turbullia, NTU	3.54	2.74	4.57	166
Lëndët e ngurta pezull, mg/L	39.87	35.75	44.20	155
Kloruret*, mg/L	6.37	5.67	7.09	54
Sulfatet*, mg/L	22.9	20.5	25.0	54
Ca*, mg/L	38.1	37.6	39.2	54
Fortësia, d	7.79	7.71	7.93	54
Fe, mg/L	0.153	0.021	0.333	54

* Rezultatet e analizave të ujit në hyrje të impiantit të trajtimit, të kryera nga Laboratori kimik i Impiantit të Përpunimit të Ujit, Kodra Kuqe

Sipas Horne & Goldman (1994) dhe Brönmark & Hansson (2005), këta liqene pak a shumë të thellë gjenden në zonat me klimë të butë, pra nuk mbulohen me akull në dimër; për këta liqene “nuk janë të rralla rastet që të paraqesin vetëm një përzierje, e cila shtrihet gjatë një periudhe të gjatë nga vjeshta deri në pranverë dhe që janë në gjendje të shtresëzuar gjatë verës”.

Në ujërat e sipërfaqes, temperatura maksimale e gjetur ka qenë 27.2 °C (në Korrik 2007), ndërsa temperatura minimale 7.6°C (në Janar 2008); në shtresat e thellësisë temperatura maksimale 11.2°C i takon muajit Nëntor 2007, ndërsa temperatura minimale 6.8°C është gjetur në Mars 2007. Si shihet edhe nga figura 2-3, shkaku kryesor në ndryshimet të temperaturës së ujit janë ndryshimet stinore të temperaturës së ajrit; kjo shprehet edhe nëpërmjet vlerës së lartë të koeficientit të korrelimit ndërmjet këtyre dy parametrave, R² = 0.912 (n=13).




Figura 2-4. Ndryshimet e temperaturës së ujit në tre shtresat gjatë monitorimit të liqenit të Bovillës; A₁ dhe A₂, kategoritë e cilësisë së ujërave sipas Standardit të BE-së 75/440 për ujërat sipërfaqësore që shfrytëzohen për ujë të pijshëm. / Changes of temperature during a two year period in three layers of Bovilla Lake. A₁ and A₂, categories of water quality after the EU Standard 75/440.





Figura 2-5. Temperatura mesatare e ajrit dhe ndryshimi ndërmjet vlerave maksimale dhe minimale të temperaturës së ujit në liqenin e Bovillës / Mean air temperature and differences between maximum and minimum water temperatures (surface – bottom layer) in Bovilla Lake

Figura 2-6. Pesë raste të gjendjeve termike karakteristike në liqenin e Bovillës: tre gjendje të shtresëzimit dhe dy përzierje të plotë. / Five selected thermal situations in Bovilla lake: three fully developed stratifications and two mixings.

Në figurën 2-6 janë paraqitur disa raste klasike të profileve termike në liqenin e Bovillës për stacionin S1: tri profile të shtresëzimit dhe dy të përzierjes së plotë. Vlerat e temperaturave të matura gjatë vitit të parë të monitorimit për stacionin S2 dhe S3 (Pasqyra II-1, Aneksi II) paraqesin pamje shumë të ngjashme me ato të stacionit S1, ndonëse shtresa e termoklinit paraqitet më pak e qëndrueshme për shkak të ndikimit të shkarkimeve të lumenjve dhe përrenjve.



Sipas Direktivës së BE 75/440 niveli i detyrueshëm i temperaturës është 25°C dhe niveli i rekomanduar 22°C; uji që merret për prodhimin e ujit të pijshëm (zakonisht nga thellësia 10-15 m) i plotëson këto kërkesa.

2.5.2. Oksigjeni i tretur (DO)

Përmbajtja e oksigjenit të tretur në ujë konsiderohet si një tregues shumë i rëndësishëm i “shëndetit” të liqeneve, që karakterizon cilësinë e ujërave. Dy janë burimet natyrore të DO në ujërat e liqeneve: difuzioni nga ajri dhe fotosinteza e algave dhe bimëve ujore.

Veç ndikimit të drejtpërdrejt në organizmat, përmbajtja e DO ka pasoja të rëndësishme në proceset kimike dhe eutrofikimin e ujërave. Në veçanti, kur përqendrimi i oksigjenit në shtresat e thella zvogëlohet ndjeshëm, atëherë mund të ndodhë lëshimi i fosforit të lidhur me hekurin nga sedimentet në shtresën e ujit më sipër. Kjo dukuri që quhet shkarkim i brendshëm (*internal loading*) mund të ndikojë në përsheptimin e eutrofikimit kulturor të liqenit dhe të problemeve shqetësuese që lidhen me të. Gjithashtu, hekuri dhe mangani në gjendje të reduktuar kalojnë në ujëra duke shkaktuar probleme të shijes dhe erës së ujit të pijshëm (Harrison, 1992).

Në tabelën II-2 të Shtojcës II janë treguar vlerat e DO në thellësi të ndryshme për gjithë ekspeditat e kryera, kurse në tabelën II-3 janë dhënë vlerat përkatëse të ngopjes (%) të ujërave me oksigjen.

Në figurën 2-7 janë paraqitur 7 profile të DO me thellësinë gjatë periudhave të shtresëzimit të liqenit. Mund të vërehet se përqendrimet e DO ndryshojnë shumë me thellësinë: përbajtja e DO është më e lartë në shtresat sipërfaqësore për shkak të zhvillimit të fotosintezës dhe tretjes së oksigjenit nga ajri dhe mjaft më e vogël në shtresën afër sedimentit, ku konsumi i oksigjenit është më i madh për shkak të dekompozimit të lëndëve organike. Nga profilet e DO me thellësinë del se zvogëlimi i përbajtjes së oksigjenit ndodh në rreth 10-15 m dhe në disa raste deri në 20 m. Gjatë periudhave të përzierjes, përbajtja e DO në gjithë kolonën e ujit është kudo e njëjtë.




Figura 2-7. DO me thellësinë gjatë periudhave të shtresëzimit të liqenit të Bovillës; A₁ – A₃, kategoritë e cilësisë së ujërave sipas Standardit të BE-së 75/440. / DO (% saturation) profiles during the stratification periods of Bovilla Lake.

Është interesante të vrojtohet ndryshimi ciklik i përqendrimit të DO, i cili është treguar në figurën 2-8. Prirja e ndryshimeve është e njëjtë për të tre shtresat e ujit: nivelet më të larta të DO rezultojnë në periudhën Janar - Mars, zvogëlohen në muajin Maj, arrijnë nivelin më të ulët në Korrik dhe luhaten gjatë vjeshtës. Intervali i ndryshimeve është më i vogël për shtresën sipërfaqësore (me rreth 2.5 mg/L), por shumë më i madh në shtresën e hipolimnit, nga rreth 6 mg/L në periudhën e shtresëzimit në më shumë se 10 mg/L gjatë përzierjes së plotë.




Figura 2-8. Ecuria e oksigjenit të tretur (DO, mg/L) mesatar dhe e DO-së së tre shtresave të liqenit të Bovillës. / Dynamics of average dissolved oxygen (DO, mg/L) on the whole water column and average DO in three layers of Bovilla Lake.

Nga të dhënat e shkallës së ngopjes së ujërave me oksigjen (Tab. II-3 tek Shtojca II) rezulton se niveli minimal në shtresën e hipolimnit luhetet nga 45 në 55% (me vlerë mesatare të dy viteve 73%), ndërsa niveli maksimal në shtresën e epilimnit luhetet ndërmjet 80-115% (me vlerë mesatare 98%). Pra, mund të arrihet në përfundimin se liqeni i Bovillës është mjaft i oksigjenuar gjatë gjithë vitit, madje edhe në shtresat e thella të ujërave. Kjo është karakteristike e liqeneve në gjendje oligotrofe deri lehtësisht mesotrofe. Në nivelet relativisht të larta të përbajtjes së DO ndikon edhe lëvizja vertikale e ujërave për shkak të marrjes së vazhdueshme të një vëllimi të madh të ujit (1200-1800 L/s) nga Impianti i Trajtimit të Ujit, Tiranë.




Figura 2-9. Varësitë e DO% dhe temperaturës me thellësinë për dy gjendje të shtresëzimit dhe dy gjendjet pa shtresim / Variation of DO% and temperature with depth during two stratification months and two mixing periods

Si mund të pritej, ndikim të rëndësishëm në përbajtjen e DO ka temperatura e ujit, gjë që është pasqyruar në figurën 2-9; këtu janë paraqitur 4 gjendje karakteristike të varësive të DO% dhe temperaturës me thellësinë. Varësitë e DO nga vlerat e temperaturës paraqesin korrelim të madh negativ, si për ujërat në tërësi, dhe sidomos për shtresën deri 10 m, si shihet nga ekuacionet e mëposhtme:

$$DO = - 0.315 (\text{Temp}) + 12.785; R^2 = - 0.826; n=13$$

$$DO_{0-10} = - 0.244 (\text{Temp}) + 12.517; R^2 = - 0.834; n = 13$$

Është e qartë se faktorët kryesorë që ndikojnë në ngopjen me oksigjen të ujërave janë temperatura dhe përzjerja.

Në përgjithësi, mostrat nga stacionet S2 dhe S3 paraqesin nivele më të larta të DO se ato të S1, ndoshta për shkak të thellësisë më të vogël, ndikimit të prurjeve dhe përzierjes më të mirë.

Sipas kufijve të Direktivës së BE-së 75/440 thuhet gjithë uji i Bovillës që merret nga Impianti i Trajtimit është i klasës A₁ (ngopja me oksigjen >70%).

Sipas klasifikimit të UNECE të cilësisë së ujërave sipërfaqësore (në 5 klasa) rezulton se thuhet gjithë ujërat e Bovillës janë të klasës së parë (> 7 mg/L) me përjashtim të ujërave të shtresave të thella gjatë periudhës së shtresëzimit; këto i përkasin klasës së dytë (7-6 mg/L)

2.5.3. pH dhe alkaliniteti

Vlerat e pH-it janë treguar në pasqyrën II-4 të Shtojcës II. Ato luhaten relativisht pak, mesatarisht nga 7.64 në 8.33; vlerat maksimale janë luhatur ndërmjet 7.82 dhe 8.47, ndërsa ato minimale ndërmjet 7.39 dhe 8.15. Si mund të pritej, vlerat më të larta të pH-it janë gjetur në pranverë, menjëherë pas periudhave të përzierjes, kur aktiviteti i fotosintezës ka qenë maksimal. Profili i pH-it me thellësinë paraqet një maksimum në shtresën 5-10 m; në shtresat më sipër, pH-i zvogëlohet lehtësisht, me sa duket për shkak të tretjes së dyoksidit të karbonit dhe proceseve të frymëmarrjes. Në periudhat e shtresëzimit të liqenit, zvogëlimi i pH-it me thellësinë arrin deri në 0.56 njësi për shkak të proceseve të dekompozimit të gjallesave në shtresat e thella. Ndonëse ndryshimet e vogla të pH-it nuk kanë ndikim të drejtpërdrejt në jetën e biotës ujore, ato japin ndikim të madh në tretshmërinë e shumë lëndëve kimike, përfshirë edhe të mostrave të fosforit.

Ndikim të rëndësishëm në ndryshimet e vlerave të pH ka kapaciteti buferik i liqenit, i cili varet kryesisht nga alkaliniteti i ujërave. Në rastin e Bovillës, thuhet gjithë alkaliniteti i përket përmbajtjes së karbonatit acid HCO₃. Rezultatet e matjeve të alkalinitetit janë paraqitur në pasqyrën II-5 (Shtojca II), ndërsa vlerat mesatare për çdo ekspeditë janë paraqitur në figurën 2-10. Nivelet më të ulëta të alkalinitetit i përkasin periudhës Janar 2007-Maj 2007, ndoshta për shkak të reshjeve të shumta (832 mm ose rreth ½ sasisë së reshjeve të vitit). Është interesante të shënohet se edhe nivelet e klorofilit a kanë rezultuar shumë të ulëta gjatë kësaj periudhe, në përputhje me faktin se alkaliniteti shërben si burim i karbonit inorganik që nevojitet për fotosintezën e bimëve ujore. Nivelet relativisht të larta të alkalinitetit janë, gjithashtu, tregues i natyrës gëlqerore të pellgut ujëmbledhës.

Ujërat e liqenit të Bovillës plotësojnë kërkesat e kategorisë A₁ të cilësisë sipas Direktivës së BE-së 75/440, në lidhje me pH dhe alkalinitetin.




Figura 2-10. Vlerat mesatare të alkalinitetit të ujërave në stacionin S1 / Mean values (0 – 40 m) of alkalinity of the water at station S1.

2.5.4. Përcjellshmëria elektrike

Përcjellshmëria elektrike lidhet drejtpërdrejt me përmbajtjen e joneve të tretura në ujë. Rezultatet e matjeve të shprehura në $\mu\text{S}/\text{cm}$ në 20°C janë dhënë në pasqyrën II-5 (Shtojca II). Intervali i luhatjeve të vlerave të përcjellshmërisë elektrike ka qenë mjaft i vogël: nga $288.4 \mu\text{S}/\text{cm}$ në muajt e lagët në $330.4 \mu\text{S}/\text{cm}$ në muajt e thatë të vitit (mesatarja e përgjithshme $307.4 \mu\text{S}/\text{cm}$. Vlera paksa më të larta janë gjetur pas përzierjes, për oksidimit të lëndëve në ujërat, si dhe të formimit biocenik të grimcave koloidale të CaCO_3 .

Gjatë periudhave të shtresëzimit vërehet një rritje e përcjellshmërisë deri në thellësinë 10-15 m dhe vlera konstante në thellësitë më të mëdha. Gjatë overturneve vlerat e përcjellshmërisë janë krejt uniforme me thellësinë. Nivelet e përcjellshmërisë elektrike të ujërave të liqenit të Bovillës janë shumë më të ulëta sesa kufiri i rekomanduar sipas Direktivës së BE 75/440, prej $1000 \mu\text{S}/\text{cm}$.

2.5.5. Turbullia, tejpanja dhe lëndët e ngurta pezull

Turbullia dhe lëndët e ngurta pezull (TSS) tregojnë sasinë e grimcave të ngurta që ndodhen në ujë në gjendje pezull, qofshin ato me natyrë minerale (p.sh. argjilat) apo organike (p.sh. algat). Të dy këta parametra ndikojnë në depërtimin e dritës (dhe në vlerat e diskut Secchi). Përmbajtja e grimcave të ngurta ndikon, gjithashtu, në prodhimtarinë e biotës ujore si dhe në kapjen e lëndëve ndotëse, në veçanti të fosforit, azotit, metaleve dhe baktereve. Vlerat e këtyre parametrave mund të ndryshojnë për dy arsye kryesore – njëra fizike,

për shkak të erozionit dhe rrymave ujore, dhe tjetra biologjike, për shkak të ndryshimeve stinore në shpejtësinë e rritjes së algave.

Në pasqyrën II-5 (Shtojca II) janë dhënë vlerat e matjeve të turbullisë nefelometrike, ndërsa në figurën 2-11 janë paraqitur nivelet mesatare të turbullisë në të tre stacionet. Nivelet më të larta janë gjetur në Nëntor 2007 dhe Janar 2008, menjëherë pas reshjeve intensive në zonën e liqenit. Mund të shihet, se vlerat e turbullisë për stacionet S2 dhe S3, të cilët ndodhen më afër derdhjeve të lumenjve dhe përrrenjve janë më të larta sesa për stacionin S1. Ato përputhen, gjithashtu, me gjendjen e përzjerjes.




Figura 2-11. Nivelet e turbullisë në ujërat e liqenit të Bovillës gjatë periudhës së studimit / Mean turbidity levels (0 – 40 m) in Bovilla water during study period

Ndikimi i reshjeve në vlerat e turbullisë shihet qartë në figurën 2-12 dhe shprehet në koeficientin e rëndësishëm të korrelimit ($R^2=0.711$, $n=13$) ndërmjet këtyre dy parametrave. Është e qartë se erozioni dhe rrymat e fuqishme ujore gjatë reshjeve intensive janë faktori kryesor i turbullisë së lartë dhe përqendrimeve të larta të TSS dhe jo rritja e algave. Mungesa ose mbulesa bimore e varfër në kodrat rreth liqenit shkakton ekspozim të lartë të tokave ndaj erozionit dhe pasojave të tij. Shkarkimet nga reshjet mund të transportojnë në liqen sasi të konsiderueshme të mbeturinave të lëndëve organike, argjilave, llumrave dhe materialeve të tjera nga pellgu ujëmbledhës. Një pasojë tjetër është mbushja e fundit të liqenit duke zvogëluar, në këtë mënyrë, aftësinë ujëmbajtëse të tij. Gjatë ekspeditave në liqeni ne kemi gjetur thellësinë maksimale në 45-48 m në afërsi të digës, kur thellësia e projektuar është 53 metra. Reduktimi i erozionit në pellgun e ujëmbledhësit është faktori kryesor i përmirësimit të cilësisë së ujit dhe ruajtjes së jetëgjatësisë së liqenit.

Në pasqyrat II-6 dhe II-7 (Shtojca II) janë dhënë vlerat e matura të tejpamjes (m) sipas diskut Secchi dhe përqendrimet e TSS (mg/L). Si mund të pritej, ekzistojnë korrelime të rëndësishme ndërmjet këtyre tre parametrave: në këtë mënyrë, korrelimi ndërmjet turbullisë dhe TSS është nga 0.88 për periudhën Korrik 2006 - Mars 2007 dhe 0.995 për periudhën Korrik 2007 – Maj 2008. Ndërkaq, ndërmjet turbullisë dhe tejpamjes ka korrelim negativ të rëndësishëm me vlerë -0.853 ($n=13$), gjë që shihet qartë edhe në figurën 2-12. Prania e kësaj lidhjeje dhe mungesa e një korrelimi të rëndësishëm ndërmjet turbullisë ose tejpamjes dhe përmbajtjes së klorofilit *a* provon se përmbajtja e algave ka pak ndikim në vlerat e këtyre parametrave.




Figura 2-12. Ndryshime e niveleve të turbullisë, tejpamjes dhe sasisë së reshjeve / Variation of turbidity levels, transparency and rainfall in Bovilla lake during study period.

Si mund të shihet nga pasqyra II-7 (Shtojca II) jo të gjitha mostrat plotësojnë kërkesat e Direktivës 75/440 të BE-së për TSS <25 mg/L. Në këtë Direktivë nuk ka kufij për vlerat e turbullisë. Në disa standarde të tjera kërkohet që vlera e turbullisë të jetë nën 5 njësi NTU. Thuajse të gjitha mostrat nga Bovilla e përmbushin këtë kërkesë.

2.5.6. Përmbajtja e lëndëve organike

Përmbajtja e karbonit organik të tretshëm (DOC) është një nga faktorët kryesorë që ndikon në mjedisin nënujor të liqeneve. Gjatë monitorimit kemi kryer vetëm një numër të kufizuar matjesh të DOC. Ndërkaq janë matur tre parametra të tjerë që lidhen tërthorazi me përmbajtjen e lëndëve organike në ujëra: absorbanca e rrezatimit UV-A (në 253.7 nm), treguesi i permanganatit dhe kërkesa biokimike për oksigjen (BOD₅).

Përqendrimi i karbonit organik total (TOC) dhe të tretshëm (DOC) është parametri kryesor që karakterizon përmbajtjen e lëndës organike në ujëra; ata maten zakonisht me Spektrometri infra të kuqe (SIR), pas oksidimit të karbonit deri në CO₂. Për shkak të mungesës së aparaturës përkatëse, ne kemi përdorur një metodë të thjeshtë me kite (HACH, US Patent). Nga matjet e kryera në periudhën Nëntor 2006 deri në Maj 2007, përmbajtja e DOC-së është luhatur në intervalin nga 0.90 deri në 16.7 mg/L me vlerë mesatare 5.0 mg/L (n=13) (Mehmeti, 2007). Të gjitha rezultatet tregojnë për përmbajtje relativisht të ulët të karbonit organik në ujëra, gjë që ka shumë rëndësi në mënjanimin e formimit të komponimeve klororganike (me veti kancerogjene) gjatë trajtimit të ujit me hipoklorit.

Disa studime kanë treguar se matja e vlerave të absorbancës së ujërave në zonën UV mund të shërbejnë si tregues konvencional për të karakterizuar përmbajtjen e DOC, në veçanti të lëndëve humike në ujëra (Uyguner, 2003). Kjo përdoret sidomos për të monitoruar oksidimin e lëndëve organike të ujit gjatë proceseve të trajtimit me hipoklorit, procese që mund të çojnë në formimin e komponimeve kancerogjene të trihalometaneve (THM). Për të vlerësuar shkallën e absorbimit të rrezatimit UV nga ujërat përdoret zakonisht koeficienti i absorbancës *K_a*, i cili njehsohet me formulën:

$$K_a = 2.303 \frac{A}{l}$$

Ku, *A* është vlera e absorbancës e matur në 253.7 nm, dhe *l* është gjatësia e rrugës së dritës në metra. Rezultatet janë treguar në pasqyrën II-8 (Shtojca II) dhe në figurën 2-13. Vihet re se mund të dallohen dy periudha: Maj 2006 - Mars 2007 dhe Maj 2007 - Maj 2008, me vlera mesatare të *K_a* përkatësisht 3.68 m⁻¹ dhe 5.30 m⁻¹; nivelet e absorbimit në UV-A janë më të ulëta në periudhën e parë se në periudhën e dytë. Një shpjegim mund të jetë sasia shumë më e madhe e reshjeve në periudhën e dytë (2'324 mm shi) në krahasim me periudhën e parë (1'489 mm); kjo mund të lidhet me sasinë më të madhe të prurjeve të lëndëve organike natyrore (kryesisht të lëndëve humusore) nga pellgu ujëmbledhës.

Rezultatet e absorbancës në UV-A paraqesin rritje graduale nga shtresat sipërfaqësore drejt atyre të thellësisë: vlera mesatare e *K_a* për shtresën 0-5 m është 4.38 m⁻¹ (n=39), për shtresën 10-15 m është 4.61 m⁻¹ (n=26) dhe për

shtresën e hipolimnit (20-45 m) ajo është 4.84 m^{-1} . Shkaqet e kësaj ecurie mund të jenë dy: së pari, lëshimi i produkteve të dekompozimit të biotës nga shtresat e sedimenteve fundore, dhe së dyti, copëtimi i molekulave organike të mëdha në produkte me peshë molekulare më të vogël, të cilat nuk kanë aftësi të absorbojnë rrezatimin UV në 253.7 nm . Vlerat e K_a ishin më të larta në stacionet S2 dhe S3 që ndodhen në afërsi të shkarkimeve ujore, në krahasim me stacionin S1.




Figura 2-13. Ndryshimet e koeficientit të absorbancës (m^{-1}) dhe të treguesit të permanganatit (mg/L O_2) në stacionin S1 të liqenit të Bovillës / Variation of absorbance coefficient (m^{-1}) and mean levels of KMnO_4 index (mg/l O_2) in station S1 of Bovilla Lake.

Treguesi i permanganatit është parametër tjetër jo-spezifk që karakterizon përmbajtjen e lëndëve organike dhe inorganike të oksidueshme. Rezultatet e matjeve të këtij treguesi janë dhënë në pasqyrën II-9 (Shtojca II) dhe ndryshimi i vlerave mesatare gjatë monitorimit është paraqitur në figurën 2-13. Është interesante të vrojtohet ecuria në drejtimin e kundërt të ndryshimit të vlerave të indeksit të permanganatit në krahasim me ndryshimin e vlerave të K_a . Edhe në këtë rast dallohen dy periudhat e mësipërme: vlera mesatare e treguesit në periudhën e parë është 5.95 mg/L O_2 , ndërsa në periudhën e dytë, 5.42 mg/L O_2 . Gjithashtu, vihet re prirje e dukshme e zvogëlimit të këtij treguesi me thellësinë, nga 5.1 mg/L O_2 për shtresën 0-5 m ($n=42$) në 1.46 mg/L O_2 për shtresën 30-45 m ($n=32$). Natyrisht, jo të gjitha lëndët që shkaktojnë reduktimin e KMnO_4 absorbojnë rrezatimin UV-A dhe e kundërta. Por me sa duket edhe nga figura 2-13, ndërmjet këtyre parametrave ka lidhje

relativisht të fortë që mund të shpjegohet me mbizotërimin e lëndëve organike, të cilat njëkohësisht kanë veti reduktuese, si dhe absorbojnë rrezatimin UV. Sidoqoftë, të dy këto parametra mund të përdoren në mënyrë komplementare për vlerësimin e DOC në ujëra.

Në Direktivën e BE-së 75/440 për ujërat që duhet të përdoren për prodhimin e ujit të pijshëm nuk ka kufij për absorbancën UV-A dhe treguesin e permanganatit. Aty rekomandohet vlera e BOD₅ si kriter statistikor për vlerësimin e lëndëve organike që konsumojnë oksigjenin e tretur. Në pasqyrën II-10 (Shtojca II) janë dhënë vlerat mesatare të BOD₅ në mg/L O₂ dhe në % për periudhën Maj 2007 – Maj 2008 (n=40). Mund të vërehet se konsumi i oksigjenit të tretur luhetet nga 9.2% deri në 17%. Vlerat e BOD₅ ishin të gjitha nën kufirin 3.0 mg/L O₂ që i takon ujërave të cilësisë A₁. Nivelet më të larta të BOD₅ kanë rezultuar në thellësinë rreth 10 m.

2.5.7. Fosfori P-PO₄

Përqendrimi i fosforit paraqet rëndësi të veçantë për shkak se fosfori është zakonisht elementi që kufizon prodhimtarinë biologjike të ekosistemeve ujore. Në këto kushte, rritja e shkarkimeve të fosforit shkakton si pasojë rritjen e biomasës së algave, e cila pasqyrohet në rritjen e përqendrimit të klorofilit a (Haggard et al., 1999).

Burimet e fosforit në liqene janë nga shkarkimet e përqendruara dhe të shpërndara nga pellgu ujëmbledhës. Fosfori hyn në ujërat si përzierje e lëndëve të tretshme dhe grimcave të ngurta. Grimcat e ngurta mund të lëshojnë lëndë të tretshme inorganike dhe organike të fosforit në ujërat. Qarkullimi i komponimeve të fosforit ndërmjet përbërësve të sistemit të një liqeni mund të shpjegohet vetëm duke marrë parasysh ekuilibrat dinamikë ndërmjet fosforit të tretshëm dhe atij në grimcat e ngurta, që njihet si mekanizmi i buferit fosfat (Correll, 1999).

Fosfori është element shumë aktiv nga pikëpamja biologjike. Komponimet e ndryshme të fosforit pesëvalent mund të pësojnë hidrolizë në rrugë kimike ose enzimatike duke formuar ortofosfate, të cilat janë forma e vetme që mund të asimilohet nga algat, bakteret dhe bimët. Por, njëkohësisht, komponimet e tretshme të fosforit mund të lidhen me jonet kalcium, hekur dhe alumin duke dhënë lëndë të patretshme ose të adsorbohen nga grimcat e ngurta dhe të sedimentojnë në fund të liqenit. Në të kundërtën, në kushte anoksike, fosfori mund të kalojë nga sedimentet në kolonën e ujit në formën e ortofosfateve si për shkak të reaksioneve kimike (reduktimit të hekurit) ashtu edhe të veprimit të mikroorganizmave mbi lëndët organike (Correll, 1999). Ky proces njihet si “shkarkim i brendshëm” (*internal loading*) dhe ka rëndësi të madhe në studimet limnologjike. Në kushte oligotrofe, kur ujërat e thellësisë mbeten relativisht të oksigjenuara gjatë gjithë vitit, shumica e fosforit do të mbetet në

sedimentet. Vëllimi i liqenit dhe jetëgjatësia hidraulike janë faktorë kritikë në qarkullimin e fosforit: në përgjithësi, liqenet që kanë jetëgjatësi hidraulike relativisht të madhe janë më pak të ndjeshëm ndaj shkarkimeve të fosforit dhe mbajnë sasi të mëdha të fosforit në sedimente. Por ka edhe mjaft faktorë të tjerë që ndikojnë në lëshimin e fosforit në kolonën e ujit, si temperatura, alkaliniteti (pH), turbulenca, aktiviteti biologjik etj. (Harrison, 1992; Virginia Tech, 2007).

Ndërkaq, ujëmbledhësit, si Bovilla, paraqesin disa veçori në lidhje me ndikimin e fosforit. Ndonëse sasia e nutrientëve që shkarkohet në ujëmbledhësa është përgjithësisht e madhe, ujërat e thellësisë nuk pësojnë periudha anaerobe dhe prandaj ndikimi i shkarkimit të brendshëm të fosforit është i vogël. Veç kësaj, largimi i një vëllimi relativisht të madh uji nga ujëmbledhësi (në rastin e Bovillës deri në 1800 L/s) jo vetëm shkakton qarkullim të shtresave të ndryshme të ujit, por edhe largimin e lëndëve të tretshme të fosforit të lëshuara nga grimcat e ngurta inorganike ose gjallesat ujore, pa arritur që ato të futen në qarkullimin sediment-ujë (Correll, 1999).

Rezultatet e përqendrimit të fosforit në ujërat e Bovillës janë paraqitur në pasqyrën II-11 (Shtojca II) dhe vlerat mesatare për çdo ekspeditë – në figurën 2-14. Përqendrimi i fosforit në gjatë dy viteve luhatet nga 2 µg/L (kufiri i diktimit në laboratorin tonë) në 14.7 µg/L; mesatarja aritmetike e 170 mostrave të analizuara është 4.85 µg/L dhe mesatarja gjeometrike 4.59 µg/L. Në figurën 2-14 mund të vërehet se vlerat përqendrimi në stacionet S2 dhe S3 janë pak më të larta sesa në stacionin S1. Nuk ka ndryshime të rëndësishme ndërmjet niveleve të fosforit gjatë periudhave të shtresëzimit dhe përzierjes, ndonëse në këto të fundit mund të vërehen nivele pak më të larta. Kjo tregon se ndikimi i shkarkimeve të brendshme të fosforit nga sedimentet është konstant dhe relativisht i vogël gjatë gjithë vitit, për shkak se nuk vërehen gjendje të mungesës së oksigjenit në shtresat e thella të liqenit. Me sa duket, kontributi kryesor i fosforit në ujërat është nga shkarkimet prej pellgut ujëmbledhës.

Përqendrimi mesatar në shtresën 1-15 m është 4.3 µg/L duke paraqitur maksimumin në thellësinë 10 m, në shtresën 20-40 m përqendrimi mesatar ka rezultuar 3.7 µg/L, ndërsa në shtresën në kontakt me sedimentin 5.3 µg/L. Përqendrimi më i lartë në shtresat sipërfaqësore shpjegohet me përmbajtjen e algave dhe grimcave të ngurta në pezulli, ndërsa niveli më i lartë në shtresën në kontakt me sedimentet shpjegohet me lëshimin e fosfateve nga dekompozimi i lëndëve organike në sedimentet.

Nga analizat kimike të fosforit në sedimentet e marra në të tre stacionet është gjetur se përmbajtja e përgjithshme e tij është 452 – 472 mg P-PO₄/kg (peshë e thatë). Kjo vlerë është relativisht mjaft e lartë dhe provon se shumica dërmuese e shkarkimeve të fosforit precipiton dhe mbetet në shtresën e sedimentit të liqenit duke përbërë një rrezik potencial për kalimin në shtresat ujore në qoftë se kushtet do bëhen të tilla që do e favorizojnë këtë kalim.




Figura 2-14. Përqendrimet mesatare të fosforit ($\mu\text{g/L P-PO}_4$) në liqenin e Bovillës / Mean phosphorus concentration ($\mu\text{g/L P-PO}_4$) in Bovilla lake.

Shumica e fosforit që ndodhet në sedimentet, 87-91.5%, është fosfor i lidhur në lëndë inorganike, kryesisht me kalciumin dhe shumë më pak i lidhur me hekurin (që konsiderohet fosfor i asimilueshëm nga algat). Përmbajtja e fosforit organik luhetet në kufijtë 4.3-8.5% (në varësi të metodës së ekstraktimit). Është interesant të shënohet se rritja e pH-it të ujit në 8,5 shkakton kalimin në tretësi të një sasive të konsiderueshme të fosforit me rreth 32 mg/kg (Vallja, 2008; Vallja et al., 2008).

Direktiva 440 e BE (EC Directive, 1975) rekomandon dy nivele kufi të fosforit të tretshëm reaktiv, të cilat janë të rëndësishëm për shëndetin: 400 $\mu\text{g/L}$ për klasën A₁ dhe 700 $\mu\text{g/L}$ për klasën A₂. Të gjitha mostrat tona paraqesin nivele shumë më të ulëta sesa kufiri për klasën A₁.

Ndërkaq, kufijtë e përqendrimit të fosforit që kanë rëndësi në vlerësimin e cilësisë mjedisore të ujërave janë shumë më rigorozë. Thuajse të gjitha mostrat tona paraqesin nivele më të ulëta se 10 $\mu\text{g/L}$, që është kufiri i gjendjes oligotrofe të ujërave sipas OECD (1982) dhe UNECE. Pra, duke u mbështetur në vlerat e fosforit në ujëra mund të arrihet në përfundimin se liqeni i Bovillës paraqet kryesisht gjendje oligotrofe.

Gjithashtu, mbështetur në klasifikimin e Institutit Norvegjez të Studimit të Ujërave (NIVA) ujërat e Bovillës klasifikohen të cilësisë “shumë mirë” ($< 7 \mu\text{g/L}$) deri “mirë” ($7-11 \mu\text{g/L}$) (Heinonen, 2000).

Çfarë nivel i përqendrimit të fosforit do të konsiderohet i pranueshëm në një objekt uJOR? Nuk ka një përgjigje të qartë dhe gjerësisht të pranueshme për këtë pyetje. Me siguri, për shumë objekte uJore niveli $100 \mu\text{g/L}$ është i papranueshëm dhe nivelet e rendit $20 \mu\text{g/L}$ mund të përbëjnë shpesh herë problem me rëndësi për gjendjen mjedisore të ujërave sipërfaqësore (Correll, 1999). Në literaturën shkencore pranohet, gjithashtu, se ndryshimet në përmbajtjen e fosforit me më pak se $\pm 20\%$, nuk shkaktojnë ndryshime të dukshme në gjendjen trofike të mjedisit uJOR (SEPA, 2002).

Ka disa faktorë që shpjegojnë nivelet e ulëta të përmbajtjes së fosforit në ujërat e Bovillës:

(i) Shkarkimet e brendshme të fosforit nga sedimentet kanë ndikim të vogël për shkak të kushteve oksiduese të ujërave, përfshi edhe ato të shtresave të thellësisë. Kjo dukuri si dhe alkaliniteti relativisht i lartë i ujërave çon në precipitimin e hidroksideve të hekurit (III) dhe të aluminit, si dhe në adsorbimin e fosfateve të tretshme.

(ii) Nivelet relativisht të larta të përmbajtjes së kalciumit në ujë (nga 34 deri 40 mg/L) shkaktojnë precipitimin e fosfateve si hidroksiapatit $\text{Ca}_{10}(\text{PO}_4)_6(\text{OH})_2$.

(iii) Largimi i vazhdueshëm i një vëllimi të madh uji drejt Impiantit të Trajtimit ndikon në largimin e fosfateve të lëshuara nga algat ose sedimentet, pa arritur që ato të lidhen përsëri dhe të hyjnë në qarkullimin ndërmjet përbërësve të sistemit ujë-sediment-botë e gjallë (Virginia Tech, 2007).

1.5.8. Nitratat N-NO₃

Në pasqyrën II-12 (Shtojca II) janë dhënë përqendrimet e nitrateve N-NO₃ në ujërat e liqenit të Bovillës, të cilat luhaten në kufijtë nga 0.02 mg/L në 0.39 mg/L , me një vlerë mesatare 0.18 mg/L .

Si shihet nga figura 2-15, nivelet e nitrateve janë më të larta gjatë muajve të përzierjes dimërore dhe gjatë pranverës, dhe më të ulëta gjatë vjeshtës. Në përgjithësi, nitratat janë më të larta në ujërat në afërsi të digës (stacioni S1) dhe zvogëlohen në stacionet S2 dhe S3. Vërehet rritje e rëndësishme e përqendrimit me thellësinë (me përjashtim të muajve të dimrit): për stacionin S1, vlera mesatare e N-NO₃ në shtresat deri 15 m është 0.16 mg/L ndërsa në shtresat më të thella 0.25 mg/L . Nga vlerat e mesatare rezultojnë dy korrelime të rëndësishme të përmbajtjes së nitrateve me pH-in ($R^2 = 0.823$; $n=13$) dhe me përcjellshmërinë elektrike ($R^2=0.795$; $n=13$). Shumica e të dhënave i përkasin kategorive A₁ dhe A₂ të Direktivës së BE-së 75/440.




Figura 2-15. Ndryshimet e përqendrimit të N-NO₃ në liqenin e Bovillës / Mean concentrations of N-NO₃ during the two years monitoring in Bovilla Lake.

1.5.9. Nitritet N-NO₂

Përqendrimet e azotit nitrit në liqenin e Bovillës luhaten nga 0.26 µg/L në 27.5 µg/L (pasqyra II-13, Shtojca II) me mesatare aritmetike të përgjithshme 5.8 µg/L (n=176). Të gjitha rezultatet tona janë më të vogla se kufiri për ujin e pijshëm (0.1 mg/L; Council Directive 75/440) dhe për ujërat natyrorë për rritjen e peshkut (0.03 mg/L; Fish Directive 2006/44).

Përqendrimet e nitriteve janë më të larta gjatë përzierjes dimërore dhe muajve të pranverës, sidomos në Janar dhe Mars 2007 dhe më të ulëta gjatë periudhave të shtresëzimit. Zvogëlimi i dukshëm i përmbajtjes së nitriteve vërehet me thellësinë nën 15 m: për stacionin S1, përqendrimi mesatar në shtresën 0-10 m është 5.3 µg/L, në 15 m ai arrin vlerën maksimale prej 6.5 µg/L dhe në shtresën nën 15 m përmbajtja mesatare e nitriteve është vetëm 0.73 µg/L. Nuk paraqiten ndryshime të rëndësishme në përqendrimet e nitriteve ndërmjet tre stacioneve.

1.5.10. Amoniumi N-NH₄

Përmbajtja e amoniumit në ujërat natyrore paraqet interes të veçantë për dy arsye kryesore: prania e amoniumit tregon për ndotjet me natyrë antropogjene (nga shkarkimet e ujërave të zeza dhe mbeturinat e kafshëve), si dhe jonet amonium nxisin më mirë zhvillimin e gjallesave, pasi asimilohen më mirë prej tyre se jonet nitrat. Në pasqyrën II-14 (Shtojca II) jepen rezultatet e matjeve të azotit amoniakal në ujërat e Bovillës dhe në figurën 2-16 janë paraqitur ndryshimet e vlerave mesatare të amoniumit gjatë monitorimit. Përqendrimet e azotit amoniakal janë luhatur nga 0.01 mg/L (kufiri i diktimit në matjet tona) deri në 0.198 mg/L, me mesatare të përgjithshme prej 0.036 mg/L (n=173). Mund të vërehet se përqendrimet e azotit amoniakal kanë rezultuar mjaft më të ulëta gjatë periudhës dimër-pranverë dhe shumë më të larta gjatë muajve të shtresëzimit, sidomos në periudhën Korrik-Nëntor 2008. Kjo pamje është e kundërt me atë të ndryshimeve të niveleve të nitrateve dhe nitriteve, gjë që pasqyrohet edhe në figurën 2-16.




Figura 2-16. Ndryshimi i përqendrimeve mesatare të N-NH₄ dhe N-NO₃ gjatë dy viteve të monitorimit të liqenit të Bovillës (stacioni S1) / Mean concentrations of N-NH₄ and N-NO₃ during the two years monitoring in Bovilla Lake (S1).

Rritja e përqendrimit të amoniumit në muajt e ngrohtë mund të shpjegohet me intensifikimin e dekompozimit të biotës dhe zvogëlimin e vëllimit të ujit në liqen. Në të vërtetë, vërehet korrelim pozitiv i rëndësishëm prej 0.68 (n=13) ndërmjet përqendrimit të amoniumit dhe temperaturës së ujit. Ecuria e kundërt e ndryshimeve të niveleve ndërmjet amoniumit dhe nitratit mund të shprehet

edhe në vlerën negative të koeficientit të korrelimit $R^2=-0.83$. Ndërkaq është interesant të vërehen vlerat e rëndësishme, por me shenjë të kundërt të koeficientit të korrelimit ndërmjet përqendrimit të oksigjenit të tretur dhe amoniumit $R^2=-0.714$, dhe përqendrimit të oksigjenit të tretur dhe nitratese $R^2=+0.70$ ($n=13$). Këto vlera tregojnë për ndikimin e drejtpërdrejt të kushteve oksiduese në format e ndryshme të azotit në ujëra.

Një rritje e përqendrimit të amoniumit me thellësinë vërehet (përveç periudhës së përzjerjes dimërore): për stacionin S1, vlera mesatare e përmbajtjes së amoniumit në shtresën 0-15 m është 0.031 mg/L ndërsa në shtresat më të thella – 0.034 mg/L. Rezultatet për stacionet S2 dhe S3 janë më të larta në krahasim me stacionin S1. Të gjitha rezultatet e përqendrimit të amoniumit janë në përputhje me kufijtë e Direktivës së BE-së 75/440 për ujërat e klasave A₁ dhe A₂.

1.5.11. Pigmentet fotosintetike

Matjet e klorofileve janë tregues i sigurt i përmbajtjes së biomasës së florës mikroskopike (fitoplanktonit) në ujërat natyrore. Përqendrimi i klorofileve në ujëra tregon përmbajtjen e gjithë pigmenteve të gjelbra, si ato aktive (të gjalla) edhe ato jo-aktive (të vdekura). Ndërkaq, përqendrimi i klorofilit a (Chl a) është tregues i pjesës së pigmenteve që janë aktive. Analiza e Chl a konsiderohet si metodë e vlerësimit të biomasës së algave që zhvillohen në ujë. Ekziston lidhje e drejtpërdrejt ndërmjet vlerës mesatare të Chl a dhe përqendrimit të fosforit total në liqene (Haggard, 1999). Prandaj, përqendrimi i Chl a përdoret me përparësi për të vlerësuar gjendjen trofike të ujërave natyrore.

Janë të shumtë faktorët që ndikojnë në përqendrimet e klorofileve si p.sh. përmbajtja e ushqyesve (në veçanti përqendrimi i ortofosfateve), por edhe temperatura, intensiteti i ndriçimit dhe prania e erës. Nga ana tjetër, sasia e algave të pranishme në ujëra ka ndikim të rëndësishëm në përqendrimin e oksigjenit të tretur, pH-it, përqendrimet e ushqyesve, tejpamjen, por dhe erën e papëlqyeshme të ujit.

Në pasqyrat II-15 deri II-18 (Shtojca II) janë dhënë rezultatet e matjeve të klorofileve të fituara me dy metoda: trikromatike dhe kromatike. Vlerat maksimale të Chl a luhaten nga 0.55 µg/L që i takojnë stacionit S3 (Mars 2007), deri 11.36 µg/L në stacionin S1 (Shtator 2006); vlera mesatare e përqendrimeve maksimale rezulton 3.2 µg/L, ndërsa vlera mesatare vjetore në shtresën e epilimnit është 2.35 µg/L. Këto vlera janë karakteristike për gjendjen oligotrofe sipas klasifikimit të OECD (OECD, 1982), përveç një vlere 11.36 µg/L (Shtator 2006, thellësia 10 m) që i përket gjendjes mesotrofe.

Në figurën 2-17 jepen ndryshimet e përqendrimit të Chl a në periudhën kulmore, vlerat mesatare të Chl a, përqendrimit mesatar të fosforit total dhe temperaturës në epilimn. Përqendrimet më të larta të klorofilit a janë gjetur në

muajt më të nxehtë. Gjithashtu, ekziston lidhje e fortë ndërmjet përqendrimit të klorofilit në kulm dhe fosforit total; kjo mund të shprehet me ekuacionin: $Chl\ a = 0.0178 + 0.642TP$; me $R^2 = 0.771$. Këto varësi tregojnë se faktorët kryesorë që ndikojnë në përmbajtjen e klorofileve, pra të zhvillimit të algave në ujëra janë temperatura dhe përqendrimi i fosforit. Është e qartë se në temperatura më të larta aktiviteti biologjik përshpejtohet. Gjithashtu, përqendrimi i fosforit ndikon drejtpërdrejt në përqendrimin e klorofileve dhe në zhvillimin e biotës ujore, meqenëse fosfori është ushqyes kufizues i proceseve të fotosintezës. Njëkohësisht, nivelet e ulëta të klorofileve gjatë dimrit tregojnë se shkarkimet e brendshme të fosforit ndikojnë pak në prodhimtarinë e liqenit.




Figura 2-17. Ndryshimi i përmbajtjes së klorofilit a (vlerat mesatare dhe kulmore, µg/L) me përqendrimin e fosforit (µg/L) dhe temperaturës së ujit (°C) në epilimn / Variation of chlorophyll a (peak and mean values, µg/L) with total phosphorus and water temperature (°C) in epilimnion.

Përqendrimet e Chl a ndryshojnë shumë me thellësinë. Vlerat më të larta janë gjetur në shtresën 3-10 m, përveç muajve të dimrit ku përqendrimi i Chl a është uniform në gjithë thellësinë. Zakonisht në shtresat e thella është gjetur vetëm feofitini a, një produkt i degradimit të Chl a. Përqendrimi i Chl a përbën pjesën kryesore të klorofileve të përgjithshme. Është interesante të vërehet se vlerat e Chl c kanë qenë thujtse gjithmonë më të larta se ato të Chl b, e cila lidhet me mbizotërimin e algave silicore (*Bacillariophyceae*) në ujëra (*shih Koni et al., në këtë vëllim*).

Përfundime dhe rekomandime

1) Nga krahasimi me kufijtë e Direktivës së BE-së 75/440 për cilësinë e ujërave sipërfaqësore që duhet të përdoren për prodhimin e ujit të pijshëm, vihet re se cilësia e ujit të liqenit të Bovillës përmbush kërkesat e cilësisë së klasës A₁, për thuajse të gjithë parametrat fiziko-kimikë. Përjashtim bëjnë disa mostra për nivelet e lëndëve të ngurta në pezulli, nitratat dhe amoniumi që i përkasin klasës A₂.

2) Ujëmbledhësi i Bovillës paraqet karakteristika limnologjike të ngjashme me ato të liqeneve të thella të kësaj zone klimatike; ai është i tipit **monomitik të ngrohtë**, me një periudhë shtresëzimi termik që zgjat nga fundi i pranverës deri në fillim të vjeshtës, ku dallohen çartë shtresa e sipërme **epilimni** (1-10 m thellësi), shtresa ndërmjetëse **termoklini** (10-15 m) dhe shtresa fundore **hipolimni** (15-45 m); kjo periudhë shtresëzimi këmbëhet me një periudhë përzjerje të plotë, që fillon nga mesi i vjeshtës, zhvillohet plotësisht në muajin Janar, dhe përfundon në fillim të pranverës, gjatë të cilës temperatura uniformohet në përputhje me atë të klimës përreth. Gjithashtu, profilet me thellësinë e shumë parametrave kimikë (p.sh. DO) kushtëzohen nga kjo dukuri, por ndryshimet relative shfaqen në shkallë më të dobët, për shkak të largimit të një sasive të madhe të ujit drejt Impiantit të Trajtitimit (deri në 1'800 L/s).

3) Përmbajtja e oksigjenit të tretur në ujërat është mjaft e lartë gjatë gjithë vitit dhe liqeni i Bovillës nuk paraqet gjendje anoksie: ujërat e shtresës së epilimnit janë kurdoherë të ngopura me oksigjen (80-115%, mesatarisht 98%), dhe ujërat e shtresës së hipolimnit përmbajnë nivele relativisht të larta të DO (min. 44-55% dhe mesatarja 7%). Këto vlera janë karakteristike për liqenet oligotrofe deri lehtësisht mesotrofe.

4. Nivelet e ushqyesve (fosfori dhe azoti) në ujëra janë mjaft të ulëta. Fosfori është element kufizues: kjo provohet jo vetëm nga raporti i lartë TN/TP, por gjithashtu, nga korrelimi i rëndësishëm ndërmjet P dhe klorofilit *a* ($R^2 = 0.77$). Edhe nivelet e fosforit janë karakteristike për gjendjen oligotrofe. Burimi kryesor i fosforit janë shkarkimet nga pellgu ujëmbledhës, kryesisht për shkak të erozionit të lartë gjatë reshjeve. Shkarkimi i brendshëm nga sedimentet ka shumë pak ndikim për shkak të kushteve mjaft oksiduese në shtresat e thella, alkalinitetit të lartë dhe përqendrimit të lartë të kalciumit dhe hekurit në ujë. Shumica e fosforit mbahet në sedimente; këtu përqendrimi i fosforit është mjaft i lartë, në vlerat 452-472 mg/kg, duke përbërë rrezik potencial për kalimin në ujëra në kushte të caktuara. Pjesa dërmuese e fosforit në sedimente (rreth 90%) ndodhet e lidhur me kalciumin.

5) Përmbajtja e lëndëve organike të tretshme në ujëra është relativisht e ulët dhe ky përfundim arrihet si nga matjet e drejtpërdrejta të DOC (mesatarisht 5 mg karbon/L) ashtu edhe nga matjet indirekte të absorbimit UV 254 nm, treguesit të permanganatit dhe DOB₅. Si pasojë, rreziku i formimit të

komponimeve klororganike (THM) me veti kancerogjene gjatë trajtimit me klor është relativisht i ulët.

6) Nivelet e përqendrimit të pigmenteve klorofilike në ujërat e Bovillës janë shumë të ulëta (përqendrimi mesatar në epilimn 2.35 µg/L dhe përqendrimi mesatar maksimal 3.2 µg/L), karakteristike për ujërat oligotrofe. Faktorët kryesorë që ndikojnë në përmbajtjen e klorofileve, për rrjedhojë dhe të algave në ujërat e Bovillës janë temperatura dhe përqendrimi i fosforit.

Duke pasur parasysh rëndësinë e veçantë që ka Ujëmbledhësi i Bovillës për furnizimin e Tiranës më ujë të pijshëm, si dhe duke u mbështetur në të dhënat e këtij studimi **rekomandohet**:

(i) Të vazhdohet monitorimi i liqenit duke e futur atë në Rrjetin Kombëtar të Monitorimit të Ujërave Sipërfaqësore nën kujdesin e Ministrisë së Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave.

(ii) Të thellohet më tej studimi limnologjik i Bovillës, duke shtuar stacionet dhe shpeshitinë monitoruese, si dhe duke vlerësuar ndikimin e prurjeve në të.

(iii) Të studiohet në veçanti problemi i erës dhe shijes në ujë, duke synuar në gjatjen e shkakut dhe mënjanimin të kësaj dukurie.

(iv) Të merren masat e nevojshme në pellgun ujëmbledhës të Bovillës për ruajtjen e cilësisë së ujërave, si për shembull: pakësimi i erozionit nëpërmjet, ndalimit të prerjeve dhe kullotjeve të tepruara, shtimit të sipërfaqes së pyllëzuar, punimeve në shtretërit lumorë, trajtimit të veçuar të shkarkimeve nga zonat e banuara dhe të fermave të tyre, ndërgjegjësimi i komunitetit të zonës për mënjanimin e ndotjeve të ujërave, por edhe të institucioneve përgjegjëse në Tiranë për mirëmbajtjen e pellgut të liqenit.

Literatura

2006/44/EC Fish Directive: Directive 2006/44/EC of the European Parliament and of the Council of 6 September 2006 on the quality of fresh waters needing protection or improvement in order to support fish life. Official Journal of the European Union. 264/20—264/31 (<http://rod.eionet.europa.eu/show.jsv?id=626&mode=S>)

APHA (1988): Standard Methods for the Examination of Water and Wastewater. 20th ed. American Public Health Association, Washington, DC

Bachofen R. (2008): Solving environmental problems by transdisciplinary research. Proceedings of International Conference on Biological and Environmental Sciences. University of Tirana, Faculty of Natural Sciences: 708-712

Brönmark C., Hansson L. A. (2005): The Biology of Lakes and Ponds. Second Edition. Oxford University Press Inc., New York, NY. 285 pp.

Correll D. L. (1999): Phosphorus: a rate limiting nutrient in surface waters", Poultry Science, 78: 674-682

U analizuan **koliformet totale** dhe ato **fekale** dhe **streptokoku fekal**, duke përdorur teknikën e filtrimit membranor (APHA, 1998) Për secilën prej këtyre tre analizave u filtruan 100 ml ujë me ndihmën e një aparati filtrues me vakum (Fig. 6-1). Në të gjitha rastet u përdorën filtra membranorë me diametër 47-50 mm, dhe përmasa të poreve 0.45 µm. Filtrat me përmbajtjen e ujit të filtruar u vendosën në pjata Petri (pjastra) me terrene të gatshme të dehidratuar, dhe sipas rastit u vendosën në termostatat ose në banjomari, si tregohet në tabelën 6-3. Terrenet dhe reagentët e përdorur jepen në tabelën 6-4. Theksojmë se metoda e përdorur nga ana jonë ka qenë në përputhje me standardin evropian 75/440 për ujërat sipërfaqësore që shfrytëzohen për ujë të pijshëm (Tab. 6-5).

Tabela 6-3. Kushtet e mbjelljes së përmbajtjes së ujit të filtruar. / Growth conditions of the enumeration of bacteria in filtered water.

Tipi i mbjelljes	Koha	Temperatura	Aparati
Koliformet totale	24 orë	36± 0.5°C	Inkubator
Koliformet fekale	24 orë	44± 0.5°C	Inkubator dhe banjomari
Streptokoku fekal	48 orë	36± 0.5°C	Inkubator
Mikroflora e përgjithshme	72 orë	22°C dhe 36°C	Termostat

Tabela 6-4. Terrenet dhe reagentët e nevojshëm të përdorur gjatë analizave mikrobiologjike. / Growth media and techniques used for the microbiological analyses.

Tipi i mbjelljes	Teknika	Terrenet ose reagentët
Koliformet totale	Teknika e filtrimit membranor. Pjata (Pjastra) me terrene të gatshme të dehidratuar në inkubator në temperaturë 36°C dhe nivel të përshtatshëm lagështie.	Nutrient Pads ENDO
Streptokoku fekal		Nutri Disk Azid (Azide)
Koliformet fekale	Teknika e filtrimit membranor. Pjata (Pjastra) me terrene të gatshme të dehidratuar në inkubator në temperaturë 44 ± 0.5°C dhe dhe pjastrat të vendosura në banjo uji.	Nutrient Pads M-FC
Mikroflora e përgjithshme	Mbillet në agar 1 ml ujë (mostër) (dhe pjastrat vendosen në termostatat për 72 orë në temperaturat 22°C dhe 36°C në lagështi të përshtatshme (bëhet mesatarja e tre matjeve paralele).	Plate-Count-Agar

6. Hoxha & Emiri: Microbiological data on the Bovilla reservoir ...




Figura 6-3




Figura 6-4

◀ **Figura 6-3.** Tre komplete pjatash (pjastrash) të renditura për thellësi të ndryshme gjatë leximit të koliformeve dhe streptokokut fekal. / Three sets of Petri dishes ordered according to depth for the enumeration of total Coliforms (*above*), fecal Coliforms (*middle*) and fecal Streptococci (*below*).

◀ ◀ **Figura 6-4.** Pamje gjatë leximit të pjastrave të mikroflorës së përgjithshme. / Petri dishes with growth media for the enumeration of the general bacterial microflora.

Krahas kësaj, për disa prej shtresave kryesore ujore u krye dhe **mikroflora e përgjithshme bakteriale** (Tab. 6-3 dhe 6-4), duke mbjellë drejtpërdrejt 1 ml ujë (mostër) në terren ushqyes agari; pjastrat vendosen në termostat për 72 orë në temperaturat 22°C dhe 36°C; për të fituar sigurinë e duhur për secilën mbjellje u bënë tre matje paralele, duke bërë në fund mesataren e kolonive të vrojtuar.

Me gjithë këto të dhëna është bërë përpunimi numerik në Excel dhe një pjesë e grafikëve janë ndërtuar në programin C2 (Juggins, 2003), duke krahasuar dhe me të dhënat paralele fiziko-kimike të paraqitura në këtë përmbledhje.

Rezultate dhe diskutime

Në tabelat VI-1 deri VI-10 të Shtojcës VI, në fund të punimit, jepen të dhënat e plota për koliformet totale dhe fekale dhe streptokoket fekale (koloni për 100 ml ujë), si dhe për mikroflorën bakteriale totale (koloni për ml ujë), të matura një herë çdo dy muaj në ujërat e Bovillës në gjithë periudhën e studiuar (maj 2006 deri maj 2008). Gjithsej janë rreth 670 analiza, nga 75 deri në 174 matje për secilën parametër të matur, e cila jep një pamje të mirë të gjendjes cilësore të ujit dhe të ecurisë së ndotjes. Në tabelën 5 jepen rezultatet përmbledhëse të gjithë parametrave, krahasuar këto me vlerat kufi të standardit evropian 75/440 për ujërat sipërfaqësore që shfrytëzohen për ujë të pijshëm.

Më poshtë po trajtojmë gjendjen e ujit të Bovillës duke u nisur nga secili prej parametrave të sipërpërmendur.

Koliformet e përgjithshme

Koliformet e përgjithshme ose koliformet totale përfaqësohen nga disa gjini bakteresh që i përkasin familjes *Enterobacteriaceae*. Ky grup dallohet për faktin se është i aftë të zbërthejë laktozin; kjo ka qenë historikisht edhe metoda e përdorur për përcaktimin e tyre. Koliformet totale konsiderohen se anaerobe fakultative, gram pozitive, që nuk formojnë spore; ato kanë formë shkopi, fermentojnë laktozin duke formuar gaz dhe acid brenda 24-28 orësh. Në këtë grup përfshihen gjinitë *Escherichia*, *Citrobacter*, *Enterobacter* dhe *Klebsiella*.

6. Hoxha & Emiri: Microbiological data on the Bovilla reservoir ...

Tabela 6-5. Rezultate përmblendhëse të gjithë parametrave të matur në ujërat e Bovillës, krahasuar këto me vlerat kufi të standardit evropian 75/440 për ujërat sipërfaqësore që shfrytëzohen për ujë të pijshëm. / Summary of the results obtained with Bovilla waters, compared also with the quality values of the EC Directive 75/440 about the quality of surface water intended for the abstraction of drinking water.

Parametrat	Njësia	Rezultatet në ujin e Bovillës	Kufijtë cilësorë të Standardit të BE-së 75/440 (Anex II)*
Koliforme totale	Koloni për 100 ml ujë	Mesatare = 14.6 DVS = 16.2 Maksimale = 110 (S1, 40m, Shta-06) Matje = 174	A ₁ 50 A ₂ 5'000 A ₃ 50'000
Koliforme fekale		Mesatare = 16.8 DVS = 22.5 Maksimale = 80 (S1, 40m, Shta-06, dhe 20m, Nov-06) Matje = 174	A ₁ 20 A ₂ 2'000 A ₃ 20'000
Streptokoke fekale		Mesatare = 15.99 DVS = 20.94 Maksimale = 95 (S1, 30m, Nënt-08) Matje = 174	A ₁ 20 A ₂ 1'000 A ₃ 10'000
Mikroflora e përgjithshme në 22°C	Koloni për 1 ml ujë	Mesatare = 39.88 DVS = 29.58 Maksimale = 180 (S1, 15m, Maj-07) Matje = 75	
Mikroflora e përgjithshme në 36°C		Mesatare = 29.25 DVS = 25.86 Maksimale = 170 (S1, 15m, Maj-07) Matje = 75	
*Kategoria A ₁ , përpunim i thjeshtë - flitrim i shpejtë dhe dezinfektim; A ₂ , përpunim i zakonshëm - paraklorim, koagulim, flokulim, dekantim, flitrim, dezinfektim përfundimtar me klorim; A ₃ , përpunim i thellë - klorim deri në pikën kritike, koagulim, flokulim, dekantim, flitrim, përpunim me karbon aktiv, ozonim dhe klorim përfundimtar.			

Tabela 6-6. Mesatarja e koliformeve totale (koloni për 100 ml ujë), e përgjithshme dhe për secilin stacion, për secilën thellësi në ujërat e Bovillës, matur një herë në çdo dy muaj gjatë periudhës maj 2006 - maj 2008. / Average of total Coliforms (colonies per 100 ml water), in total and in each station and depth in Bovilla water, bimonthly measured during May 2006 to May 2008.

Thellësia, m	Totale	S1	S2	S3
-1	10.44	9.08	10.33	13.50
-3	12.92	9.92	14.80	17.83
-5	12.44	9.15	15.00	17.00
-10	14.64	13.08	20.50	12.17
-15	16.13	15.54	15.00	25.00
-20	16.83	22.31	11.67	8.80
-25	22.00	20.00	-	24.00
-30	16.21	17.92	14.60	2.00
-40	22.00	22.00	-	-
-45	8.33	8.33	-	-
Mean	14.68	14.71	14.48	14.81

Të dhëna të plota për koliformet e përgjithshme në ujërat e Bovillës jepen në tabelat VI-1 dhe VI-2 të Shtojcës VI (*në fund të këtij punimi*). Kurse në tabelën 6, jepet pasqyra përmbledhëse e vlerave mesatare për gjithë periudhën e studiuar. Në mbi 170 matje, koliformet e përgjithshme kapin një vlerë mesatare prej 14.6 koloni/100 ml (Tab. 6-5), por me luhatje relativisht të mëdha. Megjithatë, vetëm në pak raste ato tejkalonin vlerën 50 koloni/100 ml, e cila është vlera kufi për ujërat sipërfaqësorë të cilësisë A₁ që shfytëzohen për pirje (standardi i BE-së 75/440); kjo ndodh vetëm në **shtator 2006**, thuajse në të tre stacionet e vëzhguara në atë periudhë (Shtojca VI: Tab. VI-1); më e dukshme ishte ngarkesa e lartë në hipolimn në stacionin S1, nga 90 koloni/100 ml në 30 m deri në 110 koloni/100 ml në 40 m thellësi. Nga histograma e figurës 5 vihen re ndryshime të dukshme jo vetëm midis stinëve, por edhe midis stacioneve (për periudhën e vitit të parë). Megjithatë, nga një vështrim i vlerave mesatare të tabelës 6 vihet re se stacionet S2 dhe S3 kanë ngarkesë disi më të lartë (sidomos stacioni S3 pranë prurjeve të lumit të Bruzit) se stacioni kryesor S1; theksojmë se këta dy stacione (S2 dhe S3) janë praktikisht më pranë prurjeve të lumenjve, pra më pranë burimit të ndotjes.




Figura 6-5. Ecuria e mesatares së koliformeve totale (koloni për 100 ml ujë), në gjithë kolonën ujore, matur njëherë në çdo dy muaj në Bovillë, gjatë periudhës maj 2006 deri maj 2008, krahasuar edhe me vlerat e standardit evropian 75/440. / Dynamics of average values of total Coliforms (colonies/100ml), in the whole water column, bimonthly measured in Bovilla Lake, during the period May 2006 to May 2008, compared also with values of the EC Directive 75/440.

Koliformet fekale

Koliformet fekale janë baktere ndër koliformet totale, të cilat janë të zakonshme në zorrët e kafshëve dhe të njeriut, dhe të bollshme edhe në jashtëqitjet e tyre; ato përfaqësohen nga *Esherichia coli*, e njohur shpesh si *E. coli*. Prania e *E. colit* në ujëra është tregues i fortë për ndotjen e tyre me ujëra të zeza ose ndotje kafshësh. Këto lloj shkarkimesh mund të përmbajnë edhe shumë lloje të tjera shkaktare të sëmundjeve të ndryshme (US EPA, 2006). Gjatë shirave, koliformet fekale shpelen nga vendburimi i tyre dhe mbliiden në ujërat e përrrenjve, lumenjve dhe trupave ujorë më të mëdhenj të pellgut ujëmbledhës përkatës (liqene ose dete). Kur ujërat e ndotur shfrytëzohen për pirje pa u përpunuar, ose kur përpunohen jo në mënyrë të përshtatshme, *E. coli* mund të përfundojë në rrjetin e ujësjellësit deri tek njeriu.

Organizmat me origjinë fekale përcaktohen duke i rritur në temperaturën $44.5 \pm 0.2^\circ\text{C}$, duke përdorur terren ushqyes të pasur me laktoz. Ky test zbatohet në vlerësimin e ndotjes në ujërat sipërfaqësore, në sistemet e trajtimit të ujërave të shkarkimit dhe për monitorimin e zakonshëm të cilësisë së ujërave (APHA, 1998). Po ky test përdoret edhe për përcaktimin e grupit të koliformeve totale në ujën e pijshëm.

Tabela 6-7. Mesatarja e koliformeve fekale (koloni për 100 ml ujë), e përgjithshme dhe për secilin stacion, për secilën thellësi në ujërat e Bovillës, matur një herë në çdo dy muaj gjatë periudhës maj 2006 - maj 2008. / Average of fecal Coliforms (colonies per 100 ml water), in total and in each station and depth in Bovilla waters, bimonthly measured during the period May 2006 to May 2008.

Thellësia, m	Totale	S1	S2	S3
-1	9.32	6.31	11.00	14.17
-3	10.50	7.08	14.40	14.67
-5	14.88	9.00	22.83	19.67
-10	22.68	12.69	37.00	30.00
-15	13.73	13.15	5.00	30.00
-20	21.04	16.77	28.67	23.00
-25	53.50	50.00	-	57.00
-30	21.21	19.15	30.80	-
-40	18.08	18.08	-	-
-45	22.50	22.50	-	-
Mean	17.71	12.99	24.41	21.24




Figura 6-6. Ecuria e mesatares së koliformeve fekale (koloni për 100 ml ujë), në gjithë kolonën ujore, matur njëherë në çdo dy muaj në Bovillë, gjatë periudhës maj 2006 deri maj 2008, krahasuar edhe me vlerat e standardit evropian 75/440. / Dynamics of average values of fecal Coliforms (colonies/100ml), in the whole water column, bimonthly measured in Bovilla Lake, during the period May 2006 to May 2008, compared also with values of the EC Directive 75/440.




Figura 6-7. Ecuria e vlerave mesatare (vetëm sipër) të koliformeve fekale (koloni për 100 ml ujë) gjatë thellësisë në ujërat e Bovillës në periudhën maj 2006 - maj 2008. / Depth profiles of mean values (only above) of fecal Coliforms (colonies/100ml) in Bovilla waters during May 2006 – May 2008.

Edhe për koliformet fekale në ujërat e Bovillës të dhënat e plota jepen në tabelat VI-3 dhe VI-4 të Shtojcës VI, në fund të këtij punimi. Kurse në tabelën 6-7 jepet pasqyra përmbledhëse e vlerave mesatare për gjithë periudhën e studiuar. Në mbi 170 matje, koliformet fekale kanë një vlerë mesatare prej 16.8 koloni/100 ml (Tab. 6-5), por ato kalojnë shpesh vlerën 20 koloni/100 ml (Fig. 6-6), e cila është vlera kufi për ujërat sipërfaqësorë të cilësisë A₁ që

shfrytëzohen për pirje (standardi i BE-së 75/440); megjithatë ato asnjëherë nuk kapërcejnë vlerat kufi të cilësisë A₂, të këtij standardi; ujëra të tilla kanë nevojë për përpunim të zakonshëm, si paraklorim, koagulim, flokulim, dekantim, filtrim, dezinfektim përfundimtar me klorim, si kryhet rregullisht nga Impianti i Përpunimit në Babru.

Në tabelën VI-3 (Shtojca VI) dhe në figurën 6-6 vihet re se koliformet fekale kanë qenë më të larta gjatë vitit 2006, sidomos në nëntor vlera e të cilave luhatej nga 60-80 koloni/100 ml, kjo thuhetse njëlloj në hipolominin (pjesën fundore) të tre stacioneve; në stacionin S1, po kjo gjendje ishte edhe në shtator 2006. Edhe këtu, nga vlerat mesatare të tabelës 6-7 dhe në grafikët e figurës 6-8 vihet re se stacionet S2 dhe S3 kanë ngarkesë disi më të lartë, veçanërisht në shtresat e sipërme (1-20m thellësi), se stacioni kryesor S1. Një prirje e rritjes së vlerave në shtresat e hipolomit duket edhe në grafikët e figurës 6-7; këtu vihet re edhe rritja e vlerave në muajin nëntor, në të dy rastet, përkatësisht nëntor 2006 dhe nëntor 2007, periudhë e cila përkon me fillimin e shirave dhe shplarjen e vrullshme nga pellgu ujëmbledhës.




Figura 6-8. Ecuria sipas thellësisë e mesatares së përgjithshme të koliformeve dhe streptokoqeve fekale (koloni për 100 ml ujë), për secilin stacion në ujërat e Bovillës. / Depth profiles of total average of fecal Coliforms and fecal Streptococci (colonies per 100 ml water), in all three stations of Bovilla Lake.

Përbajtja më e lartë në vitin 2006 mund të jetë me shumë mundësi në përputhje edhe me sasinë më të madhe të reshjeve në zonë gjatë atij viti, krahasuar me vitin 2007 (*shih* Tab. 12-1 dhe Fig. 12-21, tek Mersinllari *et al.*, Nr. 12 në këtë vëllim). Nga ana tjetër, në muajt e dimrit nëntor deri në janar vihet re edhe një farë uniformiteti midis shtresave ujore, epilimnit dhe hipolimnit, që vjen si rrjedhojë e humbjes së shtresëzimit në këtë periudhë (*shih* Fig. 1-8, tek Miho *et al.*, Nr. 1 në këtë vëllim).

Streptokoket fekale

Streptokoket fekale përfaqësohen nga lloje të gjinisë *Streptococcus* si *S. faecalis*, *S. faecium*, *S. avium*, *S. bovis*, *S. equinus* dhe *S. gallinarum*. Të gjithë veprojnë pozitivisht me antiserumin Lancefield të Grupit D; janë të pranishëm në jashtëqitjet e kafshëve me gjak të ngrohtë; *S. avium* ndonjëherë vepron edhe me antiserumin Lancefield të Grupit Q (Corbin, 1998).

Vend i zakonshëm i streptokokëve është aparati tretës i kafshëve gjakngrohta; *S. faecalis* dhe *S. faecium* mendohet të jenë më shumë të lidhura me njeriun se llojet e tjera të kësaj gjinie. Edhe lloje të tjera janë vënë re në jashtëqitjet e njeriut, por më rallë. Po në këtë mënyrë, *S. bovis*, *S. equines* dhe *S. avium* nuk gjenden vetëm tek kafshët, edhe pse janë shumë të bollshme në jashtëqitjet e tyre. Disa lloje streptokokesh mbizotërojnë në disa lloje kafshësh, megjithatë kjo nuk mund të përcaktohet duke parë jashtëqitjet e tyre (Corbin, 1998).

Streptokokët fekalë përdoren për **të dalluar ndotjen fekale me origjinë nga njeriu nga ndotja e kafshëve të tjera gjak-ngrohta**. Metoda standarde sqarojnë se raporti i koliformeve fekale (FC) me streptokokët fekalë (FS) mund të dëshmojë mbi natyrën e burimit ndotës. Një raport më i madh se 4 ka qenë tregues për ndotjen fekale prej njeriut; kurse një raport më i vogël se 0.7 tregon për ndotje jo të natyrës njerëzore. Por sot vlera e këtij raporti nuk merret shumë parasysh, pasi shumë lloje streptokokesh kanë shkallë mbijetese të ndryshme; kjo dhe disa arsye të tjera kanë bërë që ky raport të mos rekomandohet (Corbin, 1998).

Në mbi 170 matje në Bovillë, streptokokët fekale kanë një vlerë mesatare rreth 16 koloni/100 ml (Tab. 6-5), por ato kalojnë shpesh vlerën 20 koloni/100 ml (Fig. 6-9), vlerë kufi për ujërat sipërfaqësorë të cilësisë A₁ që shfytëzohen për pirje tek standardi i BE-së 75/440; megjithatë, edhe në këtë rast si tek koliformet fekale, ato asnjëherë nuk kapërcejnë vlerat kufi të cilësisë A₂, të këtij standardi; si të tilla këto ujëra nuk kërkojnë përpunim më të zgjeruar se ai që kryhet aktualisht nga Impianti i Përpunimit në Babru.

Tabela 6-8. Mesatarja e Streptokokeve fekale (koloni për 100 ml ujë), e përgjithshme dhe për secilin stacion, për secilën thellësi në ujërat e Bovillës, matur një herë në çdo dy muaj gjatë periudhës maj 2006 - maj 2008. / Average of fecal Streptococci (colonies per 100 ml water), in total, and in each station and depth in Bovilla Lake, bimonthly measured during the period May 2006 to May 2008.

Thellësia, m	Totale	S1	S2	S3
-1	11.04	17.08	5.17	3.83
-3	14.00	17.00	12.80	8.50
-5	13.04	18.85	7.50	6.00
-10	17.88	22.85	11.67	12.40
-15	17.00	19.46	0.00	9.50
-20	17.83	22.46	8.50	16.75
-25	16.00	14.00	-	18.00
-30	20.67	22.38	16.20	-
-40	22.67	22.67	-	-
-45	5.00	5.00	-	-
Mean	15.51	18.17	8.83	10.71




Figura 6-9. Ecuria e streptokokeve fekale (koloni për 100 ml ujë) në çdo dy muaj në Bovillë në periudhën maj 2006 deri maj 2008, krahasuar edhe me vlerat e standardit evropian 75/440. / Dynamics of fecal *Streptococci* (colonies/100ml) in Bovilla during the whole study period (May 2006 – May 2008), compared also with values of the EC Directive 75/440.




Figura 6-10. Ecuria e vlerave mesatare (vetëm sipër) të streptokokeve fekale (koloni për 100 ml ujë) gjatë thellësisë në ujërat e Bovillës në periudhën maj 2006 - maj 2008. / Depth profiles of mean values (only above) of fecal Streptococci (colonies/100ml) in Bovilla Lake during May 2006 – May 2008.

Streptokokët fekalë në ujërat e Bovillës duket se kanë ecuri relativisht të kundër me koliformët fekalë të trajtuar më sipër; ndërsa këta të fundit ishin më të bollshëm gjatë vitit të 2006, ndoshta edhe kur reshjet në pellg kanë qenë më të bollshme. Streptokokët fekalë shtohen dukshëm gjatë periudhës 2007-08 (Fig. 6-9). Edhe në këtë rast të dhënat e plota jepen në tabelat VI-5 dhe VI-6 të Shtojcës VI, në fund të këtij punimi. Kurse në tabelën 6-8 jepet pasqyra

përmbledhëse e vlerave mesatare për gjithë periudhën e studiuar. Ndryshe nga koliformet, përmbajtja mesatare e streptokokeve (Tab. 6-8 dhe Fig. 6-8) duket se është më e madhe në stacionin kryesor S1 (pranë digës dhe kullës së marrjes së ujit), se në dy stacionet e tjera pranë prurjeve të lumënjve kryesorë.

Në figurën 6-9 vihet re se streptokoket fekale kanë qenë më të larta gjatë periudhës maj 2007-janar 2008 (Tab. VI-6, Shtojca VI), me kulme në nëtor 2007 dhe janar 2008, në të cilat arrihet në hipolimn deri në 90 koloni/100 ml; vlera relativisht të larta janë vënë re edhe në korrik 2006 (Tab. VI-5, Shtojca VI), në stacionet S2 dhe S3, por, gjithsesi, më të ulëta se ato periudhës dimërore. Edhe për streptokokun vihet re prirje e rritjes së vlerave në shtresat fundore të hipolimitit, si mund të vihet re në grafikët e figurës 6-10; por kjo është më pak e theksuar se për koliformet fekale; gjithashtu, në muajt nëntor dhe janar vihet re një farë uniformiteti midis shtresave ujore, ashtu si për koliformet fekale, që vjen si rrjedhojë e humbjes së shtresëzimit në këtë periudhë (*shih* Fig. 1-8, tek Miho *et al.*, Nr. 1 në këtë vëllim).

Përmbajtja më e lartë e streptokokeve në periudhën maj 2007 deri nëntor 2008 është ndoshta dëshmi e ndikimit më të madh ndotës të bagëtisë në pellg (krahasuar me ndikimin e ndotjeve nga banorët), ndihmuar kjo dhe nga rreshjet e bollshme gjatë periudhës së dimrit. Pavarësisht se vlerat e grupet bakteriale paraqesin ndryshime midis tyre, vihet re se ka korrelim eksponencial të besueshëm midis koliformeve të përgjithshme dhe koliformeve fekale dhe streptokokeve fekale (Tab. 6-9).

Tabela 6-9. Korrelimi midis disa parametrave të ndryshëm mikrobiologjikë në Bovillë (S1), matur për thellësi të ndryshme gjatë periudhës maj 2006 – maj 2008; r, koeficienti i korrelimit; gl/df, gradët e lirisë; p, besueshmëria. / Correlation between some microbiological parameters in Bovilla Lake, assessed in different depths during May 2006 – May 2008; r, correlation coefficient; gl/df, freedom degree; p, confidence level;

(<http://www.gifted.uconn.edu/siegle/research/Correlation/corrchrt.htm>)

x	y	Ekuacioni	r	gl/df	p
Total Coli	Fekal Coli	$y = 6.4377e^{0.0353} x$	0.35	27	<0.1
Total Coli	Streptococcus	$y = 17.36e^{-0.0424} x$	0.45	27	<0.02

Mikroflora e përgjithshme

Rritja e përgjithshme e baktereve në mostrat e ujit të Bovillës është kryer duke përdorur si terren *Plate count agar* (PCA). Të dhëna të hollësishme për këtë jepen në tabelat VI-7 deri VI-10 të Shtojcës VI, përkatësisht për temperaturën 22°C dhe për 36°C. Në tabelën 6-10 jepen mesataret e mikroflorës së përgjithshme (koloni për ml ujë) për të gjitha thellësitë, për të dy temperaturat përkatëse.

Tabela 6-10. Mesatarja e mikroflorës së përgjithshme bakteriale (koloni për ml ujë) në ujërat e Bovillës në gjithë periudhën e studuar (maj 2006 deri maj 2008). / Average values of the general bacterial microflora cultured at 22°C (colonies/ml) in Bovilla Lake during May 2006 - May 2008.

Thellësia, m	<i>Totale</i>	<i>S1</i>	<i>S2</i>	<i>S3</i>
Mesataret e mikroflorës së përgjithshme në 22°C (koloni për ml ujë)				
-1	36.36	30.92	39.50	45.00
-10	44.25	-	45.17	43.33
-15	50.54	50.54	-	-
-25	40.33	-	-	40.33
-30	37.00	-	37.00	-
-40	33.08	33.08	-	-
Mean	40.26	38.18	40.56	42.89
Mesataret e mikroflorës së përgjithshme në 36°C (koloni për ml ujë)				
-1	25.44	26.46	21.33	27.33
-10	27.33	-	31.83	22.83
-15	44.46	44.46	-	-
-25	31.00	-	-	31.00
-30	23.67	-	23.67	-
-40	24.92	24.92	-	-
Mean	29.47	31.95	25.61	27.06

Nga rreth 75 matje të kryera për secilësn nga dy temperaturat, vlera mesatare e mikroflorës së përgjithshme ishte rreth 40 koloni/ml në 22°C dhe rreth 29 koloni/ml në 36°C (Tab. 6-5), por vlerat maksimale të vrojtuar shumë herë më të larta, përkatësisht 180 dhe 170 koloni/ml në stacionin S1, në maj 2007 (Tab. VI-8 dhe VI-10, Shtojca VI). Nga ecuria vlerave mesatare në të gjitha periudhën e studuar dhe në gjithë stacionet (Fig. 6-11 dhe 6-12), vihet re se mikroflora e përgjithshme bakteriale ka qenë relativisht më e lartë në muajin maj, si në vitin 2006, në 2007 dhe në 2008. Përgjithësisht, midis tre stacioneve vihen re ndryshme, por nuk duket se paraqesin rregullsi, dhe në pak raste duket se janë thelbësore.

Nga të dhënat e tabelave VI-7 deri VI-10 të Shtojcës VI, si dhe nga figurat 6-11 dhe 6-12 nuk duket se ka prirje të rritjes së mikroflorës në shtresat fundore; përgjithësisht vlerat më të larta që janë vrojtuar i përkasin termoklinin (-15 m) në të dy temperaturat. Edhe këtu mund të thuhet se ngarkesa më e madhe është vënë re në pjesën e dytë të studimit (maj 2007 – maj 2008) (Tab. VI-8 dhe VI-10, Shtojca VI), e cila është pak a shumë e ngjashme me atë të streptokokut fekal, vetëm se zhvillimi më i madh këtu ishte gjatë pranverës, sidomos në muajin maj.




Figura 6-11. Ecuria vlerave mesatare në gjithë kolonën ujore të mikroflorës së përgjithshme bakteriale (koloni për ml ujë) në 22°C, të matura një herë në çdo dy muaj në ujërat e Bovillës në gjithë periudhën dhe stacionet e studiuara (maj 2006 deri maj 2008). / Dynamics of mean values in the whole water column of the general bacterial microflora (colonies/ml) cultured at 22°C, measured once in every two months at all stations in Bovilla Lake during May 2006 – May 2008.




Figura 6-12. Ecuria vlerave mesatare në gjithë kolonën ujore të mikroflorës së përgjithshme bakteriale (koloni për ml ujë) në 36°C, të matura një herë në çdo dy muaj në ujërat e Bovillës në gjithë periudhën dhe stacionet e studiuara (maj 2006 deri maj 2008). / Dynamics of mean values in the whole water column of the general bacterial microflora (colonies/ml), cultured at 36°C, measured once in every two months and all stations in Bovilla Lake during May 2006 – May 2008.

Si përfundim mund të pohojmë se ujërat e Bovillës përgjithësisht kanë ngarkesë bakteriale të ulët, që i korrespondojnë cilësisë A₁ të standardit të BE-së 75/440 për ujërat sipërfaqësore që shfrytëzohen për ujë të pijshëm. Megjithatë, edhe në këtë rast vihet re ndikimi i ndotjes nga njeriu dhe nga bagëtitë, qoftë në koliformet fekale dhe në streptokoket fekale, duke bërë që në disa raste ujërat të përkeqësohen deri në cilësinë A₂. Kjo, për **koliformet fekale** është vënë re më shpesh gjatë matjeve të vitit 2006, sidomos në nëntor 2006, kurse për **streptokoket fekale** gjatë periudhës 2007-2008, sidomos në nëntor 2007 dhe janar 2008. Përgjithësisht vlerat e larta përkohë me fillimin e stinës së rreshjeve, të cilat ndihmojnë në shpërndarjen e jashtëqitjeve me origjinë njerëzore dhe blegtorale nga vendbanimet drejt liqenit.

Krahas masave përpunuese që kryhen rregullisht prej Impiantit të Përpunimit të Ujit në Babru, është më se domosdoshme marrja e disa masave të kujdesjes për zvogëlimin e ndotjes bakteriale në liqen. Këtu ka shumë rëndësi **mirëmbajtja dhe kontrolli i Brezit Ekologjik (Sanitar)**, midis kuatove 320-400 m lartësi, duke mbajtur gjithmonë bagëtitë larg nga rrjedhjet ujore dhe nga liqeni; po kjo gjë duhet bërë edhe për shkarkimet e ujërave të zeza të familjeve fshatare dhe fermave të tyre brenda pellgut, duke kërkuar të bëhet **menaxhim i qëndrueshëm i decentralizuar** (Larsen & Gujer, 1997; Otterpohl *et al.*, 1997; Al-Jayyousi, 2003) për secilën lagje ose shtëpi të veçuar. Këto masa do të pakësonin edhe vlerat e lëndëve ushqyese të azotit dhe të fosforit, duke mbajtur gjendjen ushqyese në liqen të ulët, duke mos nxitur etrofikimin e tij dhe lulëzimin e algave, që shpesh shoqërohet me përkeqësime të cilësisë së ujërave (*shih Çullaj & Miho, në këtë vëllim*). Të gjitha këto masa do të ndihmoreshin dukshëm nga **ruajtja dhe ripërtëritja e mbulesës bimore**, e pyjeve dhe shkurretave, sidomos në brezin sanitar, të cilat do të ngadalësonin shpërndarjen e shpejta gjatë reshjeve të vullshme (*shih Mersinllari et al., në këtë vëllim*). Vetëm në këtë mënyrë do të sigurohej vazhdimësia dhe jetëgjatësia e cilësisë së ujërave dhe e shëndetit të njeriut për gjithë Kryeqytetin.

Literatura

Al-Jayyousi R. O. (2003): Greywater reuse: towards sustainable water management. Joint EDS, WSTA and IWA conference on Desalination and the Environment Fresh Water for All UN International Year of Fresh Water 2003. Elsevier B.V.. Volume 156, Issues 1-3: 181-192. <http://www.sciencedirect.com/>

APHA (Ed.) (1998): Standard Methods for the Examination of Water and Wastewater. 20th Edition. American Public Health Association, Washington, DC.

Corbin K. (1998): Water Testing for Microorganisms. Environmental Microbiology. BIOL/CEE/CSSES/ENSC 4164. http://soils1.cses.vt.edu/ch/biol_4684/water.html

Council Directive 75/440/EEC of 16 June 1975 concerning the quality required of surface water intended for the abstraction of drinking water in the Member States as amended by Council Directive 79/869/EEC (further amended by Council Directive 81/855/EEC and Council Regulation

807/2003/EC) and both amended by Council Directive 91/692/EEC (further amended by Regulation 1882/2003/EC). <http://rod.eionet.europa.eu/instruments/202>

<http://www.gifted.uconn.edu/siegle/research/Correlation/corrchrt.htm>: Critical Values of the Pearson Product-Moment Correlation Coefficient. De Siegle, Ph.D. Neag School of Education - University of Connecticut. www.delsiegle.com

Juggins S. (2003): C2 - Software for ecological and palaeoecological data analysis and visualisation. University of Newcastle. <http://www.staff.ncl.ac.uk/stephen.juggins>

Larsen A. T., Gujer W. (1997): The concept of sustainable urban water management. IAWQ Elsevier Science Ltd. Wat. Sci. Tch., Vol. 35, No p: 3-10.
<http://lequia.udg.es/lequianet/WatSciTech/03509/0003/035090003.pdf>

Otterpohl R., Grottker M., Lange J. (1997): Sustainable water and waste management in urban areas. Pergamon, Oxford, ROYAUME-UNI. Water science and technology, vol. 35, no 9: 121-133.
<http://cat.inist.fr/?aModele=afficheN&cpsidt=2033804>

US EPA (Ed.) (2006): Drinking Water Contaminants. Basic Information about E. coli 0157:H7 in Drinking Water. US Environmental Protection Agency.
<http://www.epa.gov/safewater/contaminants/ecoli.html>

SHTOJCA VI :**TABELAT ME TË DHËNAT E PLOTA
MIKROBIOLOGJIKE NGA UJI I BOVILLËS****ANNEX VI: TABLES WITH THE MICROBIOLOGICAL
DATA FROM BOVILLA WATERS**

Tabela VI-1. Koliformet totale (koloni për 100 ml ujë), për secilin stacion dhe secilën thellësi në ujërat e Bovillës, matur një herë në çdo dy muaj gjatë periudhës maj 2006 - mars 2007; M, mesatarja. / Total Coliforms (colonies per 100 ml water), in each station and depth in Bovilla Lake, measured during the period May 2006 - March 2007; M, average.

Depth, m	S1	S2	S3	M
20-May-06				
-1	2	0	2	1.33
-3	7	-	2	4.50
-5	6	2	1	3.00
-10	6	18	23	15.67
-15	7	-	-	7.00
-20	11	24	17	17.33
-25	-	-	24	24.00
-30	25	28	-	26.50
-45	13	-	-	13.00
Mean	9.63	14.40	11.50	11.84
15-Jul-06				
-1	8	2	2	4.00
-3	3	1	2	2.00
-5	5	3	3	3.67
-10	2	2	1	1.67
-15	2	-	-	2.00
-20	30	4	3	12.33
-30	10	5	2	5.67
-40	22	-	-	22.00
Mean	10.25	2.83	2.17	5.08
16-Sep-06				
-1	2	20	50	24.00
-3	3	13	70	28.67
-5	2	35	40	25.67
-10	40	75	20	45.00

Depth, m	S1	S2	S3	M
-15	80	15	25	40.00
-20	70	20	-	45.00
-30	90	-	-	90.00
-40	110	-	-	110.00
Mean	49.63	29.67	41.00	40.10
18-Nov-06				
-1	30	10	15	18.33
-3	25	15	20	20.00
-5	15	10	40	21.67
-10	15	10	10	11.67
-15	10	-	-	10.00
-20	10	13	10	11.00
-25	20	-	-	20.00
-30	10	15	-	12.50
-40	8	-	-	8.00
Mean	15.89	12.17	19.00	15.69
13-Jan-07				
-1	15	20	6	13.67
-3	15	10	3	9.33
-5	10	10	3	7.67
-10	8	3	4	5.00
-15	6	-	-	6.00
-20	10	6	7	7.67
-30	5	5	-	5.00
-40	3	-	-	3.00
Mean	9.00	9.00	4.60	7.53

Depth, m	S1	S2	S3	M
17-Mar-07				
-1	3	10	6	6.33
-3	2	35	10	15.67
-5	4	30	15	16.33
-10	10	15	15	13.33

Depth, m	S1	S2	S3	M
-15	10	-	-	10.00
-20	25	3	7	11.67
-30	5	20	-	12.50
-40	10	-	-	10.00
Mean	8.63	18.83	10.60	12.69

Tabela VI-2. Koliformet totale (koloni për 100 ml ujë), për secilën thellësi të stacionit S1 në Bovillë, matur një herë në çdo dy muaj gjatë periudhës maj 2007 - maj 2008. / Total Coliforms (colonies per 100 ml water), in each depth of the station S1 in Bovilla, measured once in every two months during the period May 2007 - May 2008.

Year 2007 (only S1)				
Depth, m	12-May	23-July	16-Sept	16-Nov
-1	12	10	2	18
-3	6	18	5	20
-5	3	22	4	16
-10	13	10	3	10
-15	6	15	6	15
-20	9	17	10	25
-30	3	10	4	25
-40	5	25	3	30
-45	-	10	-	-
Mean	7.13	15.22	4.63	19.88

Year 2008 (only S1)			
Depth, m	19-Jan	16-March	18-May
-1	10	5	1
-3	12	10	3
-5	9	20	3
-10	15	18	20
-15	20	20	5
-20	18	25	30
-30	15	25	6
-40	11	30	7
Mean	13.75	19.13	8.56

Tabela VI-3. Koliformet fekale (koloni për 100 ml ujë), për secilin stacion dhe secilën thellësi në ujërat e Bovillës, matur një herë në çdo dy muaj, gjatë periudhës maj 2006 - mars 2007; M, mesatarja. / Fecal Coliforms (colonies per 100 ml water), in each station and depth in Bovilla Lake, measured once every two months during the period May 2006 - March 2007; M, average.

Depth, m	S1	S2	S3	M
20-May-06				
-1	1	3	6	3.33
-3	6	-	4	5.00
-5	5	8	9	7.33
-10	8	90	74	57.33
-15	16	-	-	16.00
-20	18	80	36	44.67
-25	-	-	57	57.00
-30	22	72	-	47.00
-45	40	-	-	40.00

Depth, m	S1	S2	S3	M
Mean	14.50	50.60	31.00	32.03
15-Jul-06				
-1	2	2	0	1.33
-3	0	2	2	1.33
-5	8	40	19	22.33
-10	12	10	1	7.67
-15	5	-	-	5.00
-20	4	13	6	7.67
-30	4	10	0	4.67
-40	20	-	-	20.00

6. Hoxha & Emiri: Microbiological data on the Bovilla reservoir ...

Depth, m	S1	S2	S3	M
Mean	6.88	12.83	4.67	8.13
16-Sep-06				
-1	4	5	10	6.33
-3	5	7	20	10.67
-5	3	10	10	7.67
-10	30	30	25	28.33
-15	50	5	30	28.33
-20	55	3		29.00
-30	70			70.00
-40	80			80.00
Mean	37.13	10.00	19.00	22.04
18-Nov-06				
-1	30	50	60	46.67
-3	32	55	55	47.33
-5	40	70	65	58.33
-10	55	80	70	68.33
-15	60	-	-	60.00
-20	80	70	60	70.00
-25	50	-	-	50.00
-30	65	60	-	62.50
-40	60	-	-	60.00

Depth, m	S1	S2	S3	M
Mean	52.44	64.17	62.00	59.54
13-Jan-07				
-1	5	4	7	5.33
-3	4	5	4	4.33
-5	10	7	11	9.33
-10	10	8	8	8.67
-15	3	-	-	3.00
-20	8	3	12	7.67
-30	5	2	-	3.50
-40	3	-	-	3.00
Mean	6.00	4.83	8.40	6.41
17-Mar-07				
-1	2	2	2	2.00
-3	2	3	3	2.67
-5	3	2	4	3.00
-10	2	4	2	2.67
-15	2	-	-	2.00
-20	4	3	1	2.67
-30	5	10	-	7.50
-40	2	-	-	2.00
Mean	2.75	4.00	2.40	3.05

Tabela VI-4. Koliformet fekale (koloni për 100 ml ujë), për secilën thellësi të stacionit S1 në Bovillë, matur një herë në çdo dy muaj, gjatë periudhës maj 2007 - maj 2008. / Fecal Coliforms (colonies per 100 ml water), in each depth of the station S1 in Bovilla, measured once in every two months during the period May 2007 - May 2008.

Year 2007 (only S1)				
Depth, m	12-May	23-July	16-Sept	16-Nov
-1	1	2	7	22
-3	0	4	5	25
-5	1	15	6	20
-10	3	3	15	15
-15	4	1	5	15
-20	2	0	20	18
-30	3	0	35	15
-40	2	2	4	25
Mean	2.00	3.38	12.13	19.38

Year 2008 (only S1)			
Depth, m	19-Jan	16-March	18-May
-1	3	3	0
-3	2	2	5
-5	2	4	0
-10	6	6	0
-15	4	6	0
-20	5	3	1
-30	12	3	10
-40	14	2	3
Mean	6.00	3.63	2.67

6. Hoxha & Emiri: Microbiological data on the Bovilla reservoir ...

Tabela VI-5. Streptokoket fekale (koloni për 100 ml ujë), për secilin stacion dhe secilën thellësi në ujërat e Bovillës, matur një herë në çdo dy muaj, gjatë periudhës maj 2006 - mars 2007; M, mesatarja. / Fecal Streptococci (colonies per 100 ml water), in each station and depth in Bovilla Lake, measured once every two months during the period May 2006 - March 2007; M, average.

Depth, m	S1	S2	S3	M
20-May-06				
-1	0	0	1	0.33
-3	0	-	0	0.00
-5	0	0	6	2.00
-10	3	11	10	8.00
-15	5	-	-	5.00
-20	10	4	6	6.67
-25	-	-	18	18.00
-30	8	13	-	10.50
-45	9	-	-	9.00
Mean	4.38	5.60	6.83	5.60
15-Jul-06				
-1	32	13	10	18.33
-3	25	45	26	32.00
-5	8	30	8	15.33
-10	6	38	30	24.67
-15	16	-	-	16.00
-20	7	15	40	20.67
-30	16	43	-	29.50
-40	20	-	-	20.00
Mean	16.25	30.67	22.80	23.24
16-Sep-06				
-1	0	0	0	0.00
-3	3	2	0	1.67
-5	3	2	2	2.33
-10	10	1	4	5.00
-15	2	0	6	2.67
-20	2	1	-	1.50
-30	0	-	-	0.00
-40	0	-	-	0.00
Mean	2.50	1.00	2.40	1.97

Depth, m	S1	S2	S3	M
18-Nov-06				
-1	5	11	4	6.67
-3	6	9	8	7.67
-5	5	7	3	5.00
-10	4	10	10	8.00
-15	11	-	-	11.00
-20	12	18	15	15.00
-25	14	-	-	14.00
-30	13	8	-	10.50
-40	10	-	-	10.00
Mean	8.89	10.50	8.00	9.13
13-Jan-07				
-1	4	5	6	5.00
-3	5	4	7	5.33
-5	10	4	8	7.33
-10	4	5	-	4.50
-15	5	-	13	9.00
-20	5	5	-	5.00
-30	3	7	-	5.00
-40	3	-	-	3.00
Mean	4.88	5.00	8.50	6.13
17-Mar-07				
-1	9	2	2	4.33
-3	7	4	10	7.00
-5	5	2	9	5.33
-10	9	5	8	7.33
-15	4	-	-	4.00
-20	3	8	6	5.67
-30	7	10	-	8.50
-40	9	-	-	9.00
Mean	6.63	5.17	7.00	6.26

Tabela VI-6. Streptokoket fekale (koloni për 100 ml ujë), për secilën thellësi të stacionit S1 në ujërat e Bovillës, matur një herë në çdo dy muaj, gjatë periudhës maj 2007 - maj 2008. / Fecal Streptococci (colonies per 100 ml water), in each depth of the station S1 in Bovilla Lake, measured once every two months during the period May 2007 - May 2008.

Year 2007 (only S1)					Year 2008 (only S1)			
Depth, m	12-May	23-July	16-Sept	16-Nov	Depth, m	19-Jan	16-March	18-May
-1	2	25	20	70	-1	50	5	0
-3	5	12	30	75	-3	45	3	5
-5	20	50	30	65	-5	35	10	4
-10	50	70	20	65	-10	40	15	1
-15	35	10	25	75	-15	45	20	0
-20	16	15	45	80	-20	80	15	2
-30	6	5	50	95	-30	75	10	3
-40	5	4	35	90	-40	90	5	1
Mean	17.38	23.88	31.88	76.88	-45	-	-	1
					Mean	57.50	10.38	1.89

Tabela VI-7. Mikroflora e përgjithshme (koloni për ml ujë) në 22°C, për secilin stacion dhe secilën thellësi në ujërat e Bovillës, matur një herë në çdo dy muaj, gjatë periudhës maj 2006 - mars 2007; M, mesatarja. / General microflora (colonies/100ml) cultured at 22°C, in each station and depth in Bovilla Lake, measured once every two months during the period May 2006 - March 2007; M, average.

Depth, m	S1	S2	S3	M	Depth, m	S1	S2	S3	M
20-May-06					16-Sep-06				
-1	15	25	40	26.67	-1	7	27	10	14.67
-10	-	48	65	56.50	-10	-	33	25	29.00
-15	35	-	-	35.00	-15	16	-	-	16.00
-25	-	-	72	72.00	-25	-	-	35	35.00
-30	-	62	-	62.00	-30	-	15	-	15.00
-40	90	-	-	90.00	-40	60	-	-	60.00
Mean	46.67	45.00	59.00	50.22	Mean	27.67	25.00	23.33	25.33
15-Jul-06					18-Nov-06				
-1	70	90	60	73.33	-1	30	25	50	35.00
-10	-	80	50	65.00	-10	-	35	35	35.00
-15	110			110.00	-15	28	-	-	28.00
-25	-	-	70	70.00	-25	-	-	20	20.00
-30	-	45	-	45.00	-30	-	55	-	55.00
-40	60	-	-	60.00	-40	50	-	-	50.00
Mean	80.00	71.67	60.00	70.56	Mean	36.00	38.33	35.00	36.44

6. Hoxha & Emiri: Microbiological data on the Bovilla reservoir ...

Depth, m	S1	S2	S3	M
13-Jan-07				
-1	45	30	60	45.00
-10	-	25	55	40.00
-15	35	-	-	35.00
-25	-	-	30	30.00
-30	-	20	-	20.00
-40	30	-	-	30.00
Mean	36.67	25.00	48.33	36.67

Depth, m	S1	S2	S3	M
17-Mar-07				
-1	30	40	50	40.00
-10	-	50	30	40.00
-15	35	-	-	35.00
-25	-	-	15	15.00
-30	-	25	-	25.00
-40	20	-	-	20.00
Mean	28.33	38.33	31.67	32.78

Tabela VI-8. Mikroflora e përgjithshme (koloni për ml ujë) në 22°C, për secilën thellësi të stacionit S1 në ujërat e Bovillës, matur një herë në çdo dy muaj, gjatë periudhës maj 2007 - maj 2008. / General microflora (colonies/100ml) in 22°C, in each depth of the station S1 in Bovilla Lake, measured once every two months during the period May 2007 - May 2008.

Year 2007 (only S1)				
Depth, m	12-May	23-July	16-Sept	16-Nov
-1	10	25	5	10
-15	180	35	15	13
-40	15	15	25	15
Mean	68.33	25.00	15.00	12.67

Year 2008 (only S1)			
Depth, m	19-Jan	16-March	18-May
-1	10	25	120
-15	15	50	90
-40	10	20	20
Mean	11.67	31.67	76.67

Tabela VI-9. Mikroflora e përgjithshme (koloni për ml ujë) në 36°C, për secilin stacion dhe secilën thellësi në ujërat e Bovillës, matur një herë në çdo dy muaj, gjatë periudhës maj 2006 - mars 2007; M, mesatarja. / General microflora (colonies/100ml) cultured at 36°C, in each station and depth in Bovilla lake, measured once every two months during the period May 2006 - March 2007; M, average.

Depth, m	S1	S2	S3	M
20-May-06				
-1	3	3	7	4.33
-10	-	16	15	15.50
-15	12	-	-	12.00
-25	-	-	26	26.00
-30	-	32	-	32.00
-40	25	-	-	25.00
Mean	13.33	17.00	16.00	15.44
15-Jul-06				
-1	38	50	44	44.00
-10	-	60	25	42.50
-15	33	-	-	33.00

Depth, m	S1	S2	S3	M
-25	-	-	50	50.00
-30	-	25	-	25.00
-40	26	-	-	26.00
Mean	32.33	45.00	39.67	39.00
16-Sep-06				
-1	10	10	8	9.33
-10	-	40	27	33.50
-15	23	-	-	23.00
-25	-	-	20	20.00
-30	-	20	-	20.00
-40	80	-	-	80.00
Mean	37.67	23.33	18.33	26.44

6. Hoxha & Emiri: Microbiological data on the Bovilla reservoir ...

Depth, m	S1	S2	S3	M
18-Nov-06				
-1	15	20	40	25.00
-10	-	15	20	17.50
-15	20	-	-	20.00
-25	-	-	60	60.00
-30	-	30	-	30.00
-40	25	-	-	25.00
Mean	20.00	21.67	40.00	27.22
13-Jan-07				
-1	40	25	45	36.67
-10	-	30	25	27.50
-15	30	-	-	30.00

Depth, m	S1	S2	S3	M
-25	-	-	20	20.00
-30	-	20	-	20.00
-40	25	-	-	25.00
Mean	31.67	25.00	30.00	28.89
17-Mar-07				
-1	20	20	20	20.00
-10	-	30	25	27.50
-15	25	-	-	25.00
-25	-	-	10	10.00
-30	-	15	-	15.00
-40	15	-	-	15.00
Mean	20.00	21.67	18.33	20.00

Tabela VI-10. Mikroflora e përgjithshme (koloni për ml ujë) në 36°C, për secilën thellësi të stacionit S1 në ujërat e Bovillës, matur një herë në çdo dy muaj, gjatë periudhës maj 2007 - maj 2008. / General microflora (colonies/100ml) cultured 36°C, in each depth of the station S1 in Bovilla, measured once every two months during the period May 2007 - May 2008.

Year 2007 (only S1)				
Depth, m	12-May	23-July	16-Sept	16-Nov
-1	8	30	10	15
-15	170	40	15	10
-40	10	20	30	8
Mean	62.67	30.00	18.33	11.00

Year 2008 (only S1)			
Depth, m	19-Jan	16-March	18-May
-1	15	30	110
-15	20	80	100
-40	12	30	18
Mean	15.67	46.67	76.00

7

CONCENTRATION AND SIZE DISTRIBUTION OF INORGANIC PARTICLES AND CELLS IN LAKE BOVILLA (ALBANIA)

PËRQENDRIMI DHE SHPËRNDARJA E GRIMCAVE IMORGANIKE DHE QELIZAVE NË LIQENIN E BOVILLËS (SHQIPËRI)*

R. Bachofen

Abstract

Flow cytometry allows to analyze size distribution of the suspended particles in the drinking water reservoir of Tirana. The total particle size distribution follows a Poisson pattern with a size of approximately of 0.3 μm being the most frequent. Based on autofluorescence, inorganic particles and phototrophic organisms can be distinguished and with the use of specific dyes heterotrophic and Gram-positive bacteria can be quantified separately.

Keywords: Drinking water reservoir of Tirana (Al), Flow cytometry, suspended particles, autofluorescence,

Përmbledhje

Citometria me rrjedhje ka lejuar analizën sipas madhësisë të përbërjes së grimcave pezull në ujëmbledhësin e ujit të pijshëm të Tiranës. Shpërndarja e përgjithshme e grimcave sipas madhësisë ndjek ecurinë Poisson, ku madhësia rreth 0.3 μm ishte më e pranishmja. Mbështetur tek autofloreshenca, mund të dallohen grimcat inorganike dhe organizmat fototrofë; ndërsa duke përdorur ngjyrues të posaçëm mund të përcaktohet veç e veç sasia e baktereve heterotrofe dhe atyre Gram-pozitive.

Introduction

Lake Bovilla is an artificial reservoir completed in 1998. It supplies the city of Tirana with at present more than 850'000 inhabitants with drinking water. When completely filled the lake has a volume of about $80 \times 10^6 \text{ m}^3$, with Terkuza River feeding the lake annually with $50 \times 10^6 \text{ m}^3$. The depth was originally about 60m, in recent times due to heavy sedimentation from the catchment only 45 m were measured near the dam.

* *Translations in Albanian language made by Prof. A. Miho, Tirana University*

7. Bachofen: Shpërndarja e grimcave inorganike dhe qelizave në ujin e Bovillës



Figure 7-1. Sampling moments in Bovilla, September 28th, 2008. / Çaste nga marrja e mostrave në Bovillë, në 28 shtator 2008 (Photos: Hoxha).



Based on the chemistry of the water, oxygen, nutrients and chlorophyll concentrations, Lake Bovilla is in an oligotrophic state during most of the year. In contrast, the Secchi disk transparency was unexpectedly low, ranging between 2.2 and 3.2 m. This is due to a high concentration of total suspended solids (TSS) which often exceeded 25 mg/L, the water quality standard for raw drinking water quality.

The phytoplankton concentration varied strongly with depth and season. The main growth period occurred in late spring with a second smaller one in autumn. In spite of the high turbidity the productive layers extended down to 15 m. The maximum of productivity was observed between 5-10 m depth. The most frequent species dominating in the phytoplankton were centric diatoms of *Cyclotella* sp., mainly *C. commensis*, a species typical for reservoirs throughout the region; its number often exceeded 90% of the total number of phytoplankton cells. The microbiological parameters concerning the hygienic quality fulfilled quality class A₁ of EC Directive 75/440.

The present paper will describe the size distribution of the particles suspended in the lake water. By measuring autofluorescence of phototrophic cells and the fluorescence of specific dyes binding to DNA or to cell surfaces, inorganic particles can be discriminated from cells of planktonic algae and bacteria.

Material and methods

Samples were collected at the deepest site of Bovilla Lake on September 28th 2008 (Fig. 7-1), at depths of 1, 3, 5, 10, 15, 20, 30, 40, and 45 meters using a Ruttner water sampler (Hydro-Bios). Depth profiles were obtained immediately on the lake for water temperature, pH, conductivity and nephelometric turbidity, and Secchi disk transparency was measured. Dissolved oxygen (DO) was determined according the standard Winkler procedure. Total phosphate, nitrate, nitrite, ammonium, DO, alkalinity, total suspended solids, chlorophyll *a*, *b*, *c* and phaeophytin were determined using the APHA (1988) standard procedures (for details see Çullaj *et al.*, Nr. 2 *this volume*).

Samples for flow cytometry were taken from 1, 10, and 40 m, a series fixed with p-formaldehyde (3% final concentration) and a second without preservation, and kept at 5°C until analysis.

Flow cytometric analyses were performed with a portable "Microcyte" flow cytometer (BioDetect AS, Oslo, Norway). Scatter and fluorescence are separately determined in 240 channels corresponding to a log particle size distribution of 0.2 to 15 µm. Calibration was performed with standard kits of monodisperse particles between 1 and 10 µm diameter purchased from BioDetect and Molecular Probes (Eugene, OR, USA). The dyes SYTO 62, wheat germ agglutinin (WGA Alexa 633) were obtained from Molecular Probes. SYTO was used in a final concentration of 50 nmol/L, WGA in a final

concentration of 2 µg/ml. Dyes were added to 1 ml water samples and incubated in the dark for 60 min at room temperature prior to analysis. Each measurement is the average of 50 successive 1 µL-countings by the instrument.




Figure 7-2a. Depth profiles of temperature, pH and oxygen concentration on September 28th, 2008. / Ecuria në thellësi e temperaturës, pH dhe oksigjenit në 28 shtator 2008.

Results and discussion

Figure 7-2 shows the chemistry of the lake at the date of sampling. The temperature in the uppermost 5 m layer is close to 20°C and the thermocline lies between 10 and 15 m depth. The pH is throughout the whole water column above 8.1, with a peak of pH 8.6 at 5 m. The oxygen concentration is saturated between the surface and 10m and drops in the thermocline to 70%

with a minimum at 30 m. Turbidity is with 4.2 NTU units highest at the surface, drops to 2.0 at 15 m and increases again towards the sediment surface. Phosphate concentrations are low throughout the profile, with 3.4 to 4.5 $\mu\text{g/L}$ P, while nitrate is depleted at the surface with 0.03 mg/L N but increases to 0.24 mg/L N in the hypolimnion. The profiles show that the water from 1 m and 10 m is very similar concerning most parameters, but very different from the water at 40 m depth.




Figure 7-2b. Depth profiles of turbidity and concentrations of phosphate, nitrate and ammonia on September 28th, 2008. / Ecuria në thellësi e turbullisë, foshateve, nitrateve dhe amoniumit në 28 shtator 2008.

Table 7-1 gives an overview on the total number of particles counted by flow cytometry at each depth and the portion of fluorescent particles of the total in the absence and the presence of dyes. In the counting range of the instrument of 0.2 to 15 μm diameter a total number of 6.4 to 9.0 $\times 10^5$ particles/ml were measured, with the highest value in the surface layer and the number

decreasing with depth. Particle numbers correlate well with the turbidity measured on the lake (Tab. 7-1).

Table 7-1. Total number of particles, percentage of autofluorescent particles and percentage of fluorescent particles after staining with Syto-62 and wheat germ agglutinin (WGA) at different depths. / Numri i përgjithshëm i grimcave, përqindja e grimcave autofluoeshente dhe përqindja e grimcave fluoeshente pas ngjyimit me Syto-62 dhe aglutininën e embrionit të grurit (WGA) në thellësi të ndryshme.

Depth, m	Total particle number / ml x 10 ⁵ (1)	Auto-fluorescent particles (% of total) (1)	Fluorescent particles stained with Syto-62 (% of total) (2)
-1	9.0	1.3	18.4
-10	7.9	1.3	12.2
-40	6.4	0.6	45.9
<hr/>			
Depth, m	Fluorescent particles stained with WGA (% of total) (3)	Turbidity (NTU)	Number of algae/ml* Diatoms - <i>Chlorophyceae</i>
-1	16.7	4.23	2980 - 58
-10	17.4	3.69	1676 - 48
-40	16.7	3.34	243 - 2
* counted by microscopy (Koni et al., this volume); (1) mean values of 20 countings; (2) mean values of 10 countings; (3) mean values of 3 countings			

Autofluorescence is the result of naturally occurring fluorescent particles. Activated by the measuring beam of the instrument of 633 nm wavelength red fluorescence is induced from particles containing chlorophylls and phycobilins. In aquatic systems fluorescence signals originate from eukaryotic algae and phototrophic bacteria. At 1 and 10 m depth these organisms amount for 1.3% of the total counts, while in the deep water they are reduced to about half. As phototrophic organisms depend on light the autofluorescent particles in the hypolimnion are sedimented ones from the production layer and probably decaying.

The dye SYTO-62 serves as a general DNA stain, it is incorporated into the DNA helix. As the dye permeates through membranes of most prokaryotic and eukaryotic cells, it stains both living and dead cells, but it may also stain free DNA adsorbed on inorganic particles.

By incubating the samples with SYTO-62 the portion of the fluorescent particles is highly increased with almost half of them stained at 40 m depth. This is interpreted that heterotrophic non-fluorescent bacteria become now

visible and can be distinguished from purely inorganic material. The high proportion at 40 m depth may be an indication for heterotrophic decay processes. However, these must not be free-living organisms but rather it suggests that tiny bacteria adhere to inorganic particles and live on them.

Wheat germ agglutinin (WGA) coupled to a fluorescent marker is another possibility to selectively stain prokaryotic cells. In contrast to SYTO-62 WGA acts like an antibody and binds to *N*-acetylglucosamine and *N*-acetylgalactosamine residues of the outer cell wall. Gram-positive bacteria, including their spores, become stained with fluorescently labeled WGA, whereas Gram-negative are not (Sizemore *et al.*, 1990; Fife *et al.*, 2000; Holm & Jespersen, 2003). Furthermore vegetative cells of fungi are stained as well, because of their chitin content in the cell walls (Cohen, 2001). The amount of particles stained with WGA in the three Bovilla samples is hardly variable with depth; Gram-positive bacteria seem to be in a rather constant ratio to the total counts.

The size range of the instrument is divided into 240 separate channels; it is thus possible to measure the size distribution of the suspended particles over the range from 0.2 to 15 μm . As illustrated in figures 7-3, the number of scattering particles (filled circles) peaks at approx. 0.3 μm and declines asymmetrically towards larger sizes. The shape is similar for the three depths investigated. Phototrophic organisms detected as autofluorescence (open circles) have a completely different size distribution. A large part of the particles belongs to size class $> 1 \mu\text{m}$, especially in the 1m and 10 m sample. The 40 m sample has only a much reduced number of fluorescent particles, as the live cells become decomposed during sedimentation.

Në pasqyrën 9-5 jepen vlerat e treguesve ushqyës të llogaritur sipas të dhënave të klorofileve (metodat trikromatike dhe kromatike; APHA, 1998) në epilimnion, fosforit total dhe tejpamjes për gjithë matjet në Bovillë, si dhe gjendja përkatëse ushqyese, mbështetur në klasifikim e dhënë në tabelën 9-4 dhe figurën 9-5 (Carlson & Simpson, 1996); po kjo gjendje shprehet veç për secilin parametër edhe në figurat 9-6, 9-7 dhe 9-8. Për krahasim jepet edhe biovëllimi/biomasa ($\text{mm}^3/\text{L} = \text{mg}/\text{L}$) e përmbajtjes mesatare të fitoplanktonit në stacionin S1. Klasat ushqyese mbështetur tek biovëllimi janë sipas Willén (2000) (*shih* Tab. 3-1 tek Koni *et al.*, Nr. 3 në këtë vëllim). Në figurën 9-13 jepet ecuria e fitoplanktonit mesatar dhe e gjendjes ushqyës në epilimn për gjithë stacionet e studiuara gjatë periudhës dy mujore maj 2006 – shtator 2008. Në pasqyrën 9-5 vihet re se vlerat e TSI të njehsuara sipas pigmenteve fotosintetike (Chl) dhe fosforit të përgjithshëm (TP), por edhe krahasuar me biomasën fitoplanktonike, u përkasin përgjithësisht gjendjes oligotrofe dhe oligo-mesotrofe. Kjo nuk përputhet shumë me vlerat e gjendjes ushqyese mbështetur tek tejpamja, e cila është përgjithësisht mesotrofe. Por, si theksohet në literaturë, rezultatet e gjetura sipas këtij parametri mund të konsiderohen si “surrogate” që nuk korrelojnë me nivelet e klorofileve (dhe të prodhimtarisë së algave). Kjo është dëshmi se tejpamja, pra turbullia e

ujërave shkaktohet nga sasia e konsiderueshme e grimcave inorganike të ngurta pezull, që sillen në liqen nga prurjet e lumenjve të pellgut ujëmbledhës. Kjo konfirmohet edhe nga analizat e strukturës së grimcave, analizuar me citometri, për muajin shtator 2008 nga Bachofen (Nr. 7 në këtë vëllim).

Tabela 9-4. Listë e ndryshimeve të mundshme që mund të priten në liqenet e temperuar veriorë gjatë ndryshimit të sasisë së algave dhe të treguesit të gjendjes ushqyese. TSI, treguesi i gjendjes ushqyese; Chl, vlerat e klorofileve ($\mu\text{g/L}$); SD, tej pamja me disk Secchi (m); TP, fosfori i përgjithshëm ($\mu\text{g/L}$) / A list of possible changes that might be expected in a north temperate lake as the amount of algae changes along the trophic state gradient (Carlson & Simpson, 1996).

TSI	Chl ($\mu\text{g/L}$)	SD (m)	TP ($\mu\text{g/L}$)	Gjendja	Përdorim për ujë të pijshëm	Peshkimi & Turizëm
<30	<0.95	>8	<6	Oligotrof: Ujë i kthjellët, i oksigjenuar gjatë gjithë vitit në hipolimn	Uji mund të përdoret për pirje edhe pa u filtruar	Mbizotërojnë troftat (peshqit salmonidë) fisheries dominate
30-40	0.95-2.6	8-4	6-12	Hipolimni i liqeneve të cekët mund të bëhet anoksik (pa oksigjen)		Peshq salmonidë vetëm në liqene të thellë
40-50	2.6-7.3	4-2	12-24	Mesotrof: Uji mesatarisht i kthjellët; mundësi në rritje e anoksisë së hipoliminit gjatë verës	Përkeqësohet hekuri, mangani, dhe problemet e erës dhe shijes. Për turbullinë, uji ka nevojë për filtrim.	Anoksia në hipolimn shkakton humbje të salmonideve. Mbizotërojnë llojet e krapit (ciprinidet).
50-60	7.3-20	2-1	24-48	Eutrofi: Hipolimn anoksik, ka mundësi të shfaqen probleme me zhvillimin e makrofiteve		Mbizotërojnë ciprinidet
60-70	20-56	0.5-1	48-96	Mbizotërojnë algat blu-të gjelbërta, probleme me shkumat algore dhe makrofitet.	Sfaqje të rënda të erës dhe shijes.	Shqetësime prej makrofiteve, shkumave të lagave, tej pamjes së ulët mund të largojnë turistët që lahen dhe vozitën me varkë.
70-80	56-155	0.25-1	96-192	Hipereutrof: (prodhimtari e kufizuar nga ndriçimi). Alga dhe makrofitet të dendura.		
>80	>155	<0.25	192-384	Shkumë algash dhe pakë makrofitet.		Pak peshq mbijetojnë; mund të vihen re ngordhje peshqish në verë.




Figura 9-4. Varësia e vlerave të TSI ndaj përqendrimit të klorofilit a, të fosforit të përgjithshëm dhe tejpamjes. / Values of TSI relative to chlorophyll a, total phosphorus and transparency.

Sipas këtij studimi paraprak vihet re se në ujë mbizotërojnë grimca me përmasa shumë të imta, mesatarisht 0.3 µm; nisur dhe nga përmasat e tyre, ka shumë mundësi që ato të jenë grimca argjilore që vijnë në ujin e liqenit nga shpëlarjet e sipërfaqeve të zhveshura flishore dhe argjilore të kodrave përreth (*shih Mersinllari et al., Nr. 12 në këtë vëllim*). Në të vërtetë, po sipas vlerësimeve citometrike me vetëfloheshencë dhe me floheshencë ngjyruese (*shih Tab. 7-1 tek Bachofen, Nr. 7 në këtë vëllim*), vihet re se përqindja e organizmave fototrofë (pra e gjallesave bimore fitoplanktonike) në epilimn është vetëm sa 1.3% e gjithë grimcave përbërëse; edhe pas ngjyritimit me Syto-62 dhe aglutininën e embrionit të grurit (WGA), të cilat venë në dukje bakteret dhe gjallesa të tjera ujore, kjo vlerë në epilimn nuk kalon 20%. Megjithatë, vlen të thuhet që përqindja e grimcave me origjinë biologjike rritet në fund të liqenit (thellësinë 40 m). Kjo është dëshmi e rritjes së aktivitetit të bakteve heterotrofe; këto lloje janë aktive në kushtet relativisht anoksike të hipolimnit, të cilat njihen edhe si shkaktare të prishjes së shijes dhe të erës së ujit.

Tabela 9-5. Vlerat e TSI në liqenin e Bovillës gjatë periudhës së monitorimit dhe vlerësimi i gjendjes trofike, krahasuar dhe me biovëllimin/biomasën mesatare në kolonën ujore të stacionit S1 (pranë digës), dhe me klasat ushqyese të Willén (2000). / TSI values in Bovilla lake during monitoring period and trophic evaluation (Carlson & Simpson, 1996), compared also with mean biovolume/biomass of whole water column in station S1 (near the dam), and trophic classes given by Willén (2000); UO, ultraoligotrophic; O, oligotrophic; OM, oligo-mesotrophic; M, mesotrophic; E, eutrophic.

Muaji, viti	TSI (Chl a)		TSI (TP)	TSI (SD)	Biovëllimi planktonik, mm ³ /L
	Metoda trikromatike	Metoda kromatike			
Maj-06	26.4 (O)	21.4 (O)	44.4 (M)	44.2 (M)	0.04 (UO)
Korrik-06	35.5 (OM)	34.3 (OM)	26.5 (O)	46.8 (M)	0.23 (O)
Shtator-06	54.4 (E)	35.1 (OM)	39.4 (OM)	43.2 (M)	0.20 (O)
Nëntor-06	38.2 (OM)	36.4 (OM)	25.2 (O)	46.8 (M)	0.19 (O)
Janar-07	-	-	28.0 (O)	50.0 (M)	0.02 (UO)
Mars-07	32.6 (OM)	29.8 (O)	26.3 (O)	43.7 (M)	0.16 (O)
Maj-07	38.6 (OM)	36.0 (OM)	26.2 (O)	46.8 (M)	0.78 (M)
Korrik-07	49.0 (M)	47.3 (M)	20.7 (O)	43.7 (M)	0.17 (O)
Shtator-07	38.7 (OM)	37.4 (OM)	21.7 (O)	46.2 (M)	0.11 (O)
Nëntor-07	26.1 (O)	27.6 (O)	28.5 (O)	56.3 (E)	0.01 (UO)
Janar-08	37.1 (OM)	36.4 (OM)	14.0 (O)	50.1 (M)	0.03 (UO)
Mars-08	39.8 (OM)	37.9 (OM)	12.8 (O)	43.7 (M)	0.01 (UO)
Maj-08	34.9 (OM)	34.1 (OM)	20.7 (O)	43.2 (M)	0.04 (UO)
Mesatarja - Viti I	37.6 (OM)	32.2 (OM)	30.9 (OM)	45.9 (M)	0.23 (O)
Mesatarja - Viti II	37.6 (OM)	36.8 (OM)	20.7 (O)	47.1 (M)	0.06 (UO)

Në pasqyrën 9-5 vihet re se vlerat e TSI-së së llogaritur nga mesataret vjetore të tre parametrave kanë ecurinë e mëposhtme:

$$TSI (TP) < TSI (Chl) < TSI (DS)$$

Kjo gjendje duket edhe më e varfër për sa i përket prodhimtarisë biologjike (biomasës, mg/L), pra edhe më e mirë nga ana cilësore. Kjo i përket një gjendje karakteristike kur fosfori është faktor kufizues për zhvillimin e algave, edhe pse uji përmban shumë grimca të ngurta pezull. Përfundimet e gjetura për liqenin e Bovillës duke njehsuar indeksin TSI (Carlson & Simpson, 1996) janë të njëjta me ato që kanë rezultuar nga përdorimi i modelit OECD (2006).




Figura 9-5. Klasat ushqyese sipas vlerave të treguesit TSI / Trophic classes according to the Carlson TSI values. O, oligotrophic; OM, oligo-mesotrophic; M, mesotrophic; E, eutrophic; H, hypereutrophic (after Moore & Thornton, 1988).




Figura 9-6. Vlerat e treguesit TSI në Bovillë të njehsuara sipas pigmenteve fotosintetike dhe klasat ushqyese përkatëse. / TSI values in Bovilla based on photosynthetic pigments, and the related trophic classes (Carlson & Simpson, 1996); O, oligotrophic; OM, oligo-mesotrophic; M, mesotrophic; E, eutrophic.




Figura 9-7. Vlerat e indeksit TSI në Bovillë të njehsuara sipas fosforit të përgjithshëm dhe klasat ushqyese përkatëse. / TSI values in Bovilla based on total phosphorus, and the related trophic classes (Carlson & Simpson, 1996); O, oligotrophic; OM, oligo-mesotrophic; M, mesotrophic; E, eutrophic.




Figura 9-8. Vlerat e indeksit TSI në Bovillë të njehsuara sipas tejpmjes dhe klasat ushqyese përkatëse. / TSI values in Bovilla based on transparency, and the related trophic classes (Carlson & Simpson, 1996); O, oligotrophic; OM, oligo-mesotrophic; M, mesotrophic; E, eutrophic.




Figura 9-9. Lidhja ndërmjet raportit N:P, gjendjes trofike dhe përbajtjes së cianobaktereve në plankton. / Relation between N:P ratio, trophic state and the abundance of planktonic cyanobacteria (Carlson, 1977). O, oligotrophic; M, mesotrophic; E, eutrophic; H, hypereutrophic.

9.3. Raporti TN/TP

Raporti TN:TP (përqendrimi i azotit total ndaj përqendrimit të fosforit total) mund të përdoret për të studiuar ndryshimet e gjendjes në liqen sepse ndërmjet vlerave të këtij raporti dhe gjendjes trofike ekziston një varësi në përpjesëtim të zhdrejtë, si është treguar në figurën 9-9 (Carlson, 1992). Quiros (2002) thekson se raporti TN:TP është njëkohësisht shkak dhe pasojë e biologjisë së mjediseve ujore. Ky raport mund të ndikohet nga një serë mekanizmesh biokimikë të ndërlikuar që bashkëveprojnë me njëri-tjetrin. Në të njëjtën kohë, ai varet edhe nga shkarkimet në liqen të cilat janë zakonisht të pasura me lëndë të azotit. Zakonisht, raporti TN:TP zvogëlohet gjatë proceseve të eutrofikimit në liqene.

Raporti TN:TP në shtresën e epilimnit është i rëndësishëm në veçanti për vlerësimin e lëndës ushqyese kufizuese në liqen. Në përgjithësi, në liqenet që paraqesin vlera të raportit (molar) $TN:TP > 15-16$, element biokufizues është fosfori; ndërsa në liqenet ku raporti $TN:TP < 7$, ushqyes kufizues është azoti (OECD, 2006). Megjithatë, si përmendet dhe nga Correll (1999), këto raporte duhet të konsiderohet të përafërta dhe supozimet e bëra janë të ndërlikuara dhe mund të mos jenë kurdoherë të vlefshme.




Figura 9-10. Ndryshimi i vlerave të raportit TN:TP në epilimn gjatë monitorimit të liqenit të Bovillës (stacioni S1). / Dynamics of the TN:TP ratio in epilimnion during monitoring of Bovilla Lake (site S1).

Në figurën 9-10 janë paraqitur vlerat e raportit TN:TP të njehsuara nga përqendrimet mesatare në shtresën e epilimnionit të liqenit të Bovillës gjatë periudhës së monitorimit. Ky raport ka rezultuar mjaft më i madh se 7.2 që i takon raportit Redfield sipas masës. Duke u mbështetur në figurën 9-9 arrihet në përfundimet se vlerat e gjetura janë karakteristike për liqenet oligotrofe dhe se fosfori është ushqyes kufizues.

Niveli i ulët i gjetur në muajin shtator 2006 (TN:TP = 6.5) përbën përjashtim, që mund të shpjegohet me sasinë shumë të ulët të reshjeve në 4 muajt e mëparshëm, prej vetëm 291.1 mm (ose 14% të reshjeve të vitit 2006). Ndikimi i sasisë së reshjeve në vlerat e raportit TN:TP mund të pasqyrohet shumë mirë me rezultatet e vitit 2007-2008. Vlerat më të ulëta të këtij raporti për vitin 2007 i takojnë muajve korrik-nëntor ku sasia e reshjeve të rëna ka qenë vetëm 11% e sasisë të përgjithshme të vitit 2007; ndërkaq mund të shihen vlera shumë të larta të këtij raporti gjatë 3 ekspeditave të fundit janar-maj 2008, kur në këtë periudhë kanë rënë 1285 mm shi (e barabartë me rreth 74% e reshjeve të vitit 2007).




Figura 9-11. Varësia ndërmjet raportit TN:TP dhe përqendrimit TP në Bovillë. / Relationship between TN:TP ratio and TP in Bovilla.

Nuk është vërejtur ndonjë varësi e caktuar ndërmjet përqendrimeve TN dhe TP në ujërat e liqenit të Bovillës. Por, si shihet edhe nga figura 9-11, ndërmjet raportit TN:TP dhe vlerave të përqendrimit TP ka një varësi eksponenciale negative, që mund të shprehet me ekuacionin:

$$(TN:TP) = 95.82 e^{-0.14TP}$$

me koeficient korrelimi -0.7819 ($n=13$). Kjo do të thotë, se rritja e përqendrimit të fosforit në ujëra ndikon në zvogëlimin e theksuar të raportit TN:TP, duke synuar arritjen e një gjendje të qëndrueshme. Quiros (2002) përmend se kjo gjendje është karakteristike për liqenet ku faktor kufizues është fosfori. Pamje pak a shumë të ngjashme paraqet edhe varësia ndërmjet vlerave maksimale të klorofilit *a* dhe raportit TN:TP; kjo mund të shpjegohet me korrelimin e rëndësishëm të varësisë lineare ndërmjet Chl *a* dhe TP, e shprehur nga ekuacioni:

$$\text{Chl } a = 0.0178 + 0.642 \text{ TP, me } R = 0.771 \text{ (} n = 11 \text{)}$$

Kjo është një provë tjetër që fosfori është element kufizues i zhvillimit të biotës në liqenin e Bovillës.

Në përgjithësi raporti TN:TP rritet nga shtresat sipërfaqësore drejt thellësisë (Quiros, 2002) për shkak të konsumimit të fosforit në shtresat sipërfaqësore gjatë fotosintezës. Varësi të tilla janë vërejtur edhe në liqenin e Bovillës, sidomos gjatë periudhave të shtresëzimit të plotë.

9.4. Modeli Vollenweider 1976

Ky model (Vollenweider, 1976) është modifikuar nga studimi statistikor i kryer nga OECD (2006), duke dhënë një ekuacion empirik që lidh përqendrimin e fosforit në ujëra, jetëgjatësinë hidraulike dhe shkarkimet e fosforit në liqen:

$$[P]_{\lambda} = 1.55 \left\{ \frac{[P]_j}{(1 + \sqrt{\tau_w})} \right\}^{0.82}$$

ku: $[P]_{\lambda}$ është përqendrimi TP (mg/m³); τ_w , jetëgjatësia hidraulike e liqenit (në vite); $[P]_j$ shpreh shkarkimet e fosforit në liqen (mg/m³) ku $[P]_j = L_P/q_s$; L_P është shkarkimi i fosforit për njësinë e sipërfaqes (mg/m²/vit); dhe q_s është thellësia mesatare e ujërave që merr liqeni gjatë një viti (m/vit).

Ne e kemi përdorur këtë ekuacion për të vlerësuar shkarkimet e fosforit në liqen, të cilat nuk kemi pasur mundësi që t'i matim. Duke marrë përqendrimin mesatar të fosforit $[P]_{\lambda} = 4.85 \text{ mg/m}^3$, jetëgjatësinë hidraulike 1.5 vjet dhe thellësinë mesatare të ujërave që merr liqeni gjatë një viti 10.9 metra, kemi gjetur:

$$[P]_j = 8.94 \text{ mg/m}^3 \text{ dhe } L_P = 97.5 \text{ mg/m}^2/\text{vit}.$$

Duke vendosur të dhënat e liqenit në grafikun e shkarkimeve të fosforit të treguar në figurën 9-12, mund të shihet se liqeni i Bovillës ndodhet në zonën oligotrofe, në afërsi të kufirit që ndan këtë zonë me atë mesotrofe.




Figura 9-12. Grafiku i varësisë së shkarkimeve vjetore të fosforit ndaj thellësisë mesatare të liqenit. / Vollenweider plot of annual phosphorus loading versus the mean depth.

Në Direktivën e Peshkimit 2006/44 të BE-së mbi cilësinë e ujërave sipërfaqësore që lejojnë rritjen e peshqve, jepet një ekuacion për njehsimin e kufirit të lejueshëm të përqendrimit të fosforit në rastin e liqeneve me thellësi ndërmjet 18 dhe 300 metër:

$$L < 10(Z/T_w) (1 + \sqrt{T_w})$$

ku: L është shkarkimi i komponimeve të fosforit gjatë një viti në mg/m²; Z, thellësia mesatare e liqenit; dhe T_w, koha teorike e riqarkullimit të ujërave (në vite).

Duke përdorur këtë ekuacion për Bovillën, për Z = 18 m dhe T_w = 2.42 vjet, është njehsuar vlera L < 190.1 mg P/m²/vit. Kjo vlerë është rreth dy herë më e lartë sesa ajo që përftohet nga ekuacioni Vollenweider, gjë që tregon edhe një herë se shkarkimet e fosforit në liqenin e Bovillës janë relativisht të ulëta.

9.5. Treguesi Morfoedafik - MEI

Treguesi Morfoedafik (MEI) (Ryder, 1982) jepet me raportin e lëndëve të ngurta të tretura ndaj thellësisë mesatare të liqenit. Lëndët e ngurta të tretura mund të maten drejtpërdrejt ose të vlerësohen nëpërmjet matjes së alkalinitetit (MEI_{alk}) ose përcjellshmërisë elektrike (MEI_{cond}). Ky indeks përdoret kryesisht për të parashikuar prodhimtarinë e përgjithshme të peshqve dhe të fitoplanktonit në liqen; por ai mund të përdoret edhe për përqendrimin natyror të fosforit total, duke treguar, në këtë mënyrë, vlerën më të ulët të fosforit që pengon zhvillimin e vrullshëm të biotës në ujërat e liqenit (Vighi & Chiaudani, 1985).

Duke bërë diferencën ndërmjet përqendrimit të fosforit sipas kufijve të OECD-së (të cilat përcaktojnë gjendjen trofike) dhe përqendrimit natyror (sipas indeksit MEI) mund të vlerësohet përqendrimi "i tepërt" i fosforit për shkak të veprimtarisë humane, i cili mund të merret në konsideratë për vendosjen e objektivave të menaxhimit të cilësisë së ujërave.

Formulat për vlerësimin e përqendrimit natyror të fosforit të përgjithshëm në liqenet evropiane bazuar në vlerat e MEI janë:

$$\log P = 1.48 + 0.29 \pm 0.15 \log MEI_{alk} \quad (R=0.77)$$

$$\log P = 0.87 + 0.29 \pm 0.14 \log MEI_{cond} \quad (R=0.76)$$

Formulat e mësipërme mbështeten në faktin se aktivitetet antropogjenë në pellgun e liqenit shkaktajnë rritje të shkarkimeve të nutrientëve dhe, si pasojë, edhe rritje të prodhimtarisë së biotës. Në të kundërtën, këto aktivitete kanë shumë pak ndikim në parametra të tillë si alkaliniteti, përcjellshmëria elektrike

apo sasia e lëndëve të tretura. Gjithashtu, është vërejtur, se ndryshimet e përbërjes gjeokimike të zonave të ndryshme të pellgut të drenazhimit nuk paraqesin ndikim të rëndësishëm në përdorimin e indeksit MEI për vlerësimin e përqendrimit të fosforit.

Rezultatet e indeksit MEI të njehsuara duke u bazuar në vlerat mesatare të alkalinitetit dhe përcjellshmërisë elektrike të ujërave të liqenit të Bovillës gjatë dy viteve të monitorimit janë:

$$MEI_{alk} = 2.675 \text{ (meq/L)} : 18 \text{ (m)} = 0.15 \text{ meq/L}\cdot\text{m}$$

$$MEI_{cond} = 312.2 \text{ (}\mu\text{S}\cdot\text{cm)} : 18 \text{ (m)} = 17.34 \text{ }\mu\text{S}\cdot\text{cm/m}$$

Përqendrimet natyrore të fosforit të njehsuara duke u bazuar në këto vlera janë: 17.4 mg/m³ (min 13.06 dhe max 23.12) nga MEI_{alk} dhe 16.9 mg/m³ (min 11.4 dhe max 25.1) nga MEI_{cond}.

Të dy rezultatet janë shumë afër njëri-tjetrit, ndonëse më të larta nga mjaft vlera të përqendrimeve të fosforit që ne kemi gjetur me analizën kimike të ujërave gjatë dy viteve të studimit. Nivelet e përqendrimit natyror të fosforit në liqenin e Bovillës janë brenda kufijve të dhëna nga EEA (Leonard & Crouzet, 1998) për përqendrimet “natyrore” të fosforit që mund të luhaten ndërmjet 3 dhe 25 mg/m³.

9.6. Gjendja ushqyese sipas biomasës

Willén (2000) bën një klasifikim të gjendjes ushqyese dhe cilësisë së ujit të një liqeni duke u nisur nga përmbajtja e algave fitoplanktonike, biovëllimi/biomasa mesatare e tyre (mm³/L=mg/L). Vlen të theksojmë se kjo është ndoshta mënyra më e drejtpërdrejtë për të gjykuar mbi prodhimtarinë e një liqeni, edhe pse edhe kjo metodë ka kufizimet dhe përafrimet e veta. Një prej tyre është mënyra relativisht e vështirë e matjes së biovëllimit, pasi shumë lloje mikroskopike algash kanë forma të ndërlikuara; megjithatë standarde të ndryshme japin përmasat dhe përafrimet gjeometrike për llojet më të zakonshme. Në rastin tonë biovëllimin e kemi llogaritur nisur nga vëllimi mesatar i qelizave të diatomeve rrethore (të gjinisë *Cyclotella*); algat silicore rrethore, kryesisht *C. comensis*, janë mjaft e bollshme në planktonin e Bovillës, shpesh deri 98% të sasisë së përgjithshme të algave mikroskopike (*shih* Tab. III-2, Shtojca III, tek Koni *et al.*, Nr. 3 në këtë vëllim). Duke pasur formë cilindrike, vëllimi i tyre është lehtësisht i matshëm: diametri mesatar 0.008 mm dhe lartësia 0.003 mm; vëllimi mesatar i qelizës është: $\pi \cdot h \cdot r^2 = 0.0042 \cdot 0.003 \cdot 3.14 = 1.5 \cdot 10^{-7} \text{ mm}^3$; edhe pse me një farë gabimi, mendojmë se vëllimi i tyre përfaqëson me shumë përafërsi gjithë biovëllimin fitoplanktonik. Meqë llojet fitoplanktonike pluskojnë të lira në kolonën e ujit, dendësia e tyre

është e barabartë me atë të ujit (1.0 g/cm^3) (Lohmann 1908), pra biovëllimi është i barasvlershëm me biomasën ($1 \text{ mm}^3/\text{L} = 1 \text{ cm}^3/\text{m}^3 = 1 \text{ mg/L}$ ose $1 \text{ mm}^3/\text{m}^3 = 1 \text{ } \mu\text{m}^3/\text{L} = 1 \text{ } \mu\text{g/l}$) (shih edhe Koni *et al.*, në këtë vëllim).

Sipas Willén (2000), kur biomasa është më e vogël se $0.1 \text{ mm}^3/\text{L}$ (0.1 mg/L), prodhimtaria është shumë e varfër dhe gjendja ultraoligotrofe (UO); cilësia e ujit është e parë (Ia); kjo ndodh kur përmbajtja e fosforit të përgjithshëm në ujëra është më e vogël se $6 \text{ } \mu\text{g/L}$. Kur biomasa është $0.1\text{--}0.5 \text{ mm}^3/\text{L}$ gjendja është oligotrofe (O), që i përket cilësisë Ib, dhe përqendrimit të fosforit $6\text{--}12.5 \text{ } \mu\text{g/L}$. Kur biomasa merr vlera mesatare, $0.5\text{--}1.5 \text{ mm}^3/\text{L}$, gjendja është mesotrofe (M), cilësia e ujit është e shkallës së II-të, kurse përmbajtja korresponduese e fosforit $12.5\text{--}25 \text{ } \mu\text{g/L}$; për më tepër shih tabelën 3-1 tek Koni *et al.* (Nr. 3 në këtë vëllim).




Figura 9-13. Ecuria e vlerave mesatare të fitoplanktonit (qeliza/ml) dhe biovëllimit (mm^3/L) në epilimnion (1-10 m) e Bovillës, për gjithë stacionet e studiuar, gjatë periudhës dy mujore maj 2006 – shtator 2008. Vijat e ndërprera tregojnë klasat ushqyese. / Dynamics of mean values of phytoplankton (cells/ml) and biovolume (mm^3/L) in epilimnion of Bovilla, in all sampled stations (S1, S2, S3), during the bimonthly period May 2006 – September 2008. Dashed lines show the trophic classes. OM, oligo-mesotrophic; O, oligotrophic; M, mesotrophic. E, Epilimnion (1-10 m); F, fixed with formaldehyde 4% (the rest is fixed with Lugol solution); S1, S2, S3, three stations (see the satellite map in Fig. 1 in Çullaj *et al.*, in this volume).

Si duket edhe nga të dhënat e tabelës 9-5 dhe nga histogrami i figurës 9-13, prodhimtaria e ujërave të liqenit të Bovillës është relativisht e pakët, e cila i përket gjendjes oligotrofe ose ultraoligotrofe, me cilësi shumë të mirë (I). Kjo përkon edhe me vlerat shumë të ulëta të fosforit të vrojtuar në të njëjtën periudhë (shih pasqyrën II-12, tek Shtojca II, Çullaj *et al.*, Nr. 2 në këtë vëllim).

Vetëm gjatë periudhës kulmore (maj 2007), prodhimtaria rritet, duke kaluar në gjendjen mesotrofe (cilësia e ujit II).

Nga tabela 9-5 dhe figura 9-13 vihet re se ka ndryshim thelbësor midis gjendje ushqyese (prodhimtarisë) së liqenit gjatë periudhës së vitit të parë studimor (maj 06 – maj 07), ku prodhimtaria është më e lartë, se gjatë vitit të dytë (korrik 07 – maj 08). Ky ndryshim është po kaq i dukshëm edhe për lëndët pezull në ujë (*shih* pasqyrën II-8, tek Shtojca II, Çullaj *et al.*, Nr. 2 në këtë vëllim). Kjo ndoshta vjen nga ndryshimet e dukshme klimatike midis këtyre dy periudhave (Fig. 9-14). Periudha e vitit të parë ka qenë më e lagët dhe e freskët, kurse periudha tjetër ka qenë më e nxehtë por dhe me reshje më të çrregullta (*shih* edhe Tab. 12-1, tek Mersinllari *et al.*, Nr. 12 në këtë vëllim).




Figura 9-14. Ecuria e reshjeve dhe temperaturës gjatë periudhës studimore dymujore maj 2006 – maj 2007, sipas të dhënave të fshatit Dajt (Tiranë). / Dynamics of rainfall and temperature during the bimonthly study period may 2006 – May 2008; data from the thermometric place of Dajti village (Tirana) (Murtaç, 2007).

Gjatë periudhës studimore temperatura mesatare është luhatur nga një minimum prej 3.7°C (janar 2006) deri në 24.5°C (korrik 2007); sasia e reshjeve gjatë vitit 2006 ishte rreth 2'027 mm, shumë më e lartë se në vitin 2007, gjatë të cilit ranë vetëm 1'740 mm shi; dhe më pak akoma kanë rënë gjatë vitit 2008, vetëm 1'154 mm; gjatë dy muajve të verës, korrik-gusht 2007 nuk ka rënë asnjë pikë shi në zonë. Me siguri, kjo gjendje ka pakësuar dukshëm prurjet e rrjetit hidrografik, dhe për pasojë edhe prurjet e ngurta pezull në ujë. Nga ana tjetër, kjo ka pakësuar edhe prurjet e lëndëve ushqyese (azotit dhe

fosforit) nga pellgu ujëmbledhës (shih pasqyrat II-8 dhe II-12, tek Shtojca II, Çullaj et al., në këtë vëllim), dhe për pasojë ka ndihmuar në zhvillimin e pakët të planktonit.

Tabela 9-6. Vlerat kufi të disa parametrave të standardit evropian 75/440 për ujërat sipërfaqësore që shfrytëzohen për ujë të pijshëm. / Quality values of some parameters of the EC Directive 75/440 about the quality of surface water intended for the abstraction of drinking water.

Parametrat	A1		A2		A3	
	G	I	G	I	G	I
pH	6-5-8.5		5.5-9		5.5-9	
Lëndët e ngurta pezull (TSS), mg/L	25					
Temperatura, °C	22	25 (O)	22	25 (O)	22	25 (O)
Përcjellshmëria, µS/cm (20°C)	1000		1000		1000	
Nitrate, mg/L NO ₃	25	50 (O)		50 (O)		50 (O)
Hekuri, mg/L Fe	0.1	0.3	1	2	1	
Sulfatet, mg/L SO ₄ ²⁻	150	250	150	250 (O)	150	250 (O)
Kloruret, mg/L Cl ⁻	200		200		200	
Fosfatet, mg/L P ₂ O ₅	0.4		0.7		0.7	
Ngopja me oksigjen të tretur, %O ₂	>70		>50		>30	
Kërkesa biologjike për oksigjen (BOD ₅), mg/L O ₂	<3		<5		<7	
Amoniumi, mg/L NH ₄ ⁺	0.05		1	1.5	2	4 (O)
Koliformet totale (37°C), kol./100 ml	50		5'000		50'000	
Koliformet fekale, koloni/100 ml	20		2'000		20'000	
Streptokoket fekale, koloni/100 ml	20		1'000		10'000	

**Kategoria A1, përpunim i thjeshtë - filtrim i shpejtë dhe dezinfektim; A2, përpunim i zakonshëm - paraklorim, koagulim, flokulim, dekantim, filtrim, dezinfektim përfundimtar me klorim; A3, përpunim i thellë - klorim deri në pikën kritike, koagulim, flokulim, dekantim, filtrim, përpunim me karbon aktiv, ozonim dhe klorim përfundimtar. I, detyrueshme (imperative); G, udhëzuese (guide); O, përjashtime sipas kushteve klimatike ose gjeografike.*

9.7. Cilësia e ujit sipas Standardit 75/440 të BE-së

Standardi evropian 75/440 përcakton tre kategori të cilësisë së ujërave sipërfaqësore që shfrytëzohen për ujë të pijshëm. Në Shtojcën II (Annex II) të këtij standardi jepen vlerat kufij përkatëse për 46 parametra fiziko-kimikë. Në tabelën 9-6 ne kemi dhënë vetëm ata parametra që bëjnë pjesë në këtë shtojcë dhe që janë matur prej nesh, ose maten rregullisht nga laboratorët e Impiantit të Përpunimit të Ujit të Bovillës. Sipas këtij standardi, për ujërat që i përkasin kategorisë A₁, nevojitet vetëm përpunim i thjeshtë i ujit - filtrim i shpejtë dhe dezinfektim; ujërat e kategorisë A₂, kërkojnë përpunim të zakonshëm - paraklorim, koagulim, flokulim, dekantim, filtrim, dezinfektim përfundimtar me klorim; për ujërat e kategorisë A₃, kërkohet përpunim i thellë -

klorim deri në pikën kritike, koagulim, flokulim, dekantim, filtrim, përpunim me karbon aktiv, ozonim dhe klorim përfundimtar.

Disa nga parametrat fiziko-kimikë të matur, si pH, BOD₅, përcjellshmëria, ushqyesit (nitratet, fosfatet) etj. përgjithësisht janë brenda kufijve të cilësisë A₁ të ujërave. Megjithatë, temperatura e ujërave të epilimitit (1-5 m) kalon në verë (korrik-gusht) vlerën 25°C (A₂) (shih Fig. 1-8, tek Miho *et al.*, Nr. 1 në këtë vëllim); gjithashtu, vlerat e Fe të tretur në ujë rriten gjatë periudhës së shirave (nëntor – mars) (shih Fig. 8-5, tek Çullaj & Bachofen, Nr. 8 në këtë vëllim).

Ngopja me oksigjen e ujërave të liqenit duket se është gjithmonë e mirë vetëm për shtresat e sipërme të epilimitit (1-10 m) (kategoria A₁), kurse për shtresat e thella ka prirje të përkeqësohet (A₂) sidomos gjatë periudhës së shtresimit të plotë (maj – shtator), ndonjëherë dhe dukshëm, si p.sh. në maj 2006 kur përmbajtja ulet nën 50% (kategoria A₃) (shih Fig. 1-12, tek Miho *et al.*, Nr. 1 në këtë vëllim); po kjo shoqërohet në verë edhe me vlera relativisht të larta të amoniumit (mbi 0.05 mg/L), si në figurën 9-15. Kjo Po në këtë mënyrë, vlerat e lëndëve të ngurta pezull gjatë gjithë periudhës së parë të studimit (maj 2006-maj 2007) kanë qenë mbi 25 mg/L (kategoria A₂) (shih Çullaj *et al.*, Nr. 2 në këtë vëllim); kjo është përforcuar edhe nga vlerat relativisht të ulëta të tejpamjes dhe turbullia e lartë; të gjitha këto dëshmojnë për erozion të fuqishëm në zonë.




Figura 9-15. Ecuria e amoniumit mg/L NH₄⁺ në stacionin S1 në Bovillë. / Dynamics of ammonium (mg/L NH₄⁺) in stacion S1 in Bovilla.

Nga të dhënat mikrobiologjike të paraqitura në këtë vëllim nga Hoxha *et al.*, ujërat e Bovillës përgjithësisht kanë ngarkesë bakteriale të ulët, që i

korrespondon cilësisë A₁; megjithatë, në disa raste ujërat të përkeqësohen deri në cilësinë A₂; për **koliformet fekale**, kjo është vënë re më shpesh gjatë vitit 2006 (sidomos në nëntor), kurse për **streptokoket fekale** gjatë periudhës 2007-2008 (sidomos në nëntor 2007 dhe janar 2008). Përgjithësisht vlerat e larta përkojnë me fillimin e stinës së reshjeve, të cilat ndihmojnë në shpëlarjen e jashtëqitjeve me origjinë njerëzore dhe blegtorale nga vendbanimet drejt liqenit.




Figura 9-16. Ecuria e mesatareve mujore 2006-2008 të sasisë së ujit të përpunuar nga Impianti i Përpunimit (m³) dhe e nivelit të liqenit (m). / Dynamics of monthly average values 2006-2008 of water volume (m³) treated from the Bovilla Drinking Water Treatment Plant and water level of the lake (m). (data taken from the Water Treatment Plant).

Në Bovillë duket se kanë rëndësi edhe **luhatjet e nivelit të ujit, të cilat janë relativisht të mëdha**, mesatarisht nga kuota 311 m mbi nivelin e detit deri në 318 m (Fig. 9-16), duke ndjekur një ecuri lëkundëse stinore, ku vlerat më të ulëta vihen re gjatë periudhës së verë-vjeshtës (gusht-nëntor), kurse më të lartat në dimër-pranverë. Nga ana tjetër, edhe ecuria e marrjes së ujit nga liqeni për përpunim duket se është e tillë, por me kahe të kundërt, ku gjatë niveleve të ulëta të liqenit tërhiqen sasi relativisht më të mëdha, me një korrelim negativ ($N = -3E-06V + 329.06$, $R^2 = 0.1409$, $n = 34$, shkalla e besueshmërisë për testin me dy skaje, $p = 0.05$); ku N, niveli i liqenit në metra, V, vëllimi i ujit në hyrje të Impiantit të Përpunimit, në m³. Ndërkohë, vihet re korrelim linear mjaft i besueshëm ($p=0.01$, për $n = 34$) i ecurisë mesatare mujore të nivelit të ujërave në liqen me oksigjenin e tretur (pozitiv) dhe për temperaturën (negativ) e ujërave që hyjnë në Impiantin e Përpunimit. (Fig. 9-17); kjo do të thotë që kur nivelet e ujit në liqen janë minimale, për rrjedhojë edhe vëllimi i përgjithshëm e ujërave, temperatura e ujit është relativisht e lartë dhe vlerat e oksigjenit të tretur më të ulëta; kjo përkon edhe me periudhën e shtresimit të plotë, nga e cila mund të nxiten lulëzimet e algave

ose të baktereve heterotrofe që mund të jenë shkaktare të shijes dhe erës së papëlqyeshme. Kujtojmë që Impianti i Përpunimit ve në shfrytëzim përpunimin me qymyr aktiv gjatë periudhës shtator-tetor deri në prill. Për këtë, Impianti i Përpunimit për e sasinë e ujit që shfrytëzon duhet të mbajë parasysh edhe nivelin e ujit në liqen. Nuk do të ishte e këshillueshme tërheqja e sasive maksimale të ujit kur niveli i liqenit është minimal.




Figura 9-17. Regresioni linear midis mesatareve mujore 2006-2008 të sasisë së nivelit të ujërave në liqen (m), me oksigjenin e tretur (mg/L) (*majtas*) dhe temperaturën (°C) për ujin që hyn në Impiantin e Përpunimit. / Linear regression of monthly average values 2006-2008 of the lake water level (m), with the dissolved oxygen (mg/L) (*left*) and with temperature (°C) (*right*) for the waters that are treated from the Treatment Plant.

(<http://www.gifted.uconn.edu/siegle/research/Correlation/corrchrt.htm>)

Përfundime

Nga shqyrtimi i metodave të mësipërme të vlerësimit të gjendjes ushqyese të liqenit të Bovillës mbështetur në të dhënat e përfuara gjatë tudimit monitorues të kryer gjatë viteve 2006-2008 ka rezultuar:

1) Në ujërat e liqenit vihet re prodhimtari e ulët, pra zhvillim i pakët i fitoplanktonit, që i përket gjendjes ushqyese oligotrofe (cilësisë së parë të ujit). Vetëm në pak raste, p.sh. në maj dhe shtator 2007, është vrojtuar zhvillim relativisht i madh i fitoplanktonit, që i përket një gjendje mesotrofe (cilësi e II-të e ujërave).

2) Nga treguesit e ndryshëm, duket se elementi biokufizues në ujërat e liqenit të Bovillës është fosfori. Nivelet e fosforit janë mjaft të ulëta, nën vlerat e përqendrimit natyror; kjo shpjegohet jo vetëm me shkarkimet e ujërave të zeza relativisht të ulëta, por sidomos edhe me precipitimin e fosforit në sedimente, si dhe largimin e tij me ujin që merret nga impianti i trajtimit.

3) Pavarësisht nga vlerat e ulëta të prodhimtarisë biologjike, Liqeni i Bovillës karakterizohet nga një tejpamje relativisht e kufizuar dhe turbulli e lartë, që

nuk përputhet me vlerat e ulëta të fitoplanktonit, ose vlerat e ulëta të lëndëve ushqyese (fosfor dhe azot) që nxisin zhvillimin e fitoplanktonit. Kjo është pasojë e përmbajtjes së lartë të grimcave inorganike në ujë, të cilat zënë një përqindje shumë më të lartë se grimcat biologjike planktonike. Shumë diskutime në këtë vëllim të çojnë në faktin se Bovilla grumbullon sasi të madhe lëndësh të ngurta pezull nga pellgu ujëmbledhës, si rrjedhojë e dëmtimit të theksuar të mbulesës bimore, erozionit të madh të shpateve rrethuese, e ndihmuar kjo dhe nga natyra flishore-argjilore e tyre, si dhe nga karakteri i rrëmbyer i reshjeve.

4) Krahasuar me disa nga parametrat e Standardit të BE-së 75/440, ujërat e Bovillës janë përgjithësisht të cilësisë A₁; megjithatë ka përkeqësime për lëndët e ngurta pezull, që kapërcejnë vlerën 25 mg/L, sidomos gjatë reshjeve; po në këtë periudhë vihen re përkeqësime për përmbajtjen e Fe, për koliformet dhe streptokoket fekale. Për disa parametra të tjerë, cilësia e ujërave përkeqësohet kryesisht gjatë periudhës së shtresimit të plotë, si për oksigjenin e tretur në shtresat e thella, për amoniumin etj.

5) Luhatjet e nivelit të ujit në Ujëmbledhës janë relativisht të mëdha, mesatarisht nga kuota 311 m mbi nivelin e detit deri në 318 m. Vihet re se kur nivelet janë minimale (verë-vjeshtë) sasia e ujit që shfrytëzohet është maksimale; ndërkohë, temperatura e ujit në këtë periudhë është maksimale kurse vlerat e oksigjenit të tretur zvogëlohen; në këtë periudhë rriten kushtet stresuese që mund të shkaktojnë lulëzime algash ose bakteresh heterotrofe. Nuk këshillohet shfrytëzimi sasive maksimale të ujit prej Impiantit të Përpunimit, kur nivelet e ujit në Ujëmbledhës janë minimale.

Diktimi i ecurisë së gjendjes trofike kërkon përkujdesje për mbulesën bimore, mbrojtje nga prerjet, djegiet, ripyllëzime, zhdukje të dhisë nga pellgu, punime kundër erozionit në shtretërit e lumenjve, përpunim i veçuar i mbeturinave të lëngëta dhe të ngurta nga njerëzit dhe bagëtitë e tyre, si dhe përpjekje të menjëhershme për uljen e varfërisë tek banorët që jetojnë brenda pellgut; këto janë kërkesa urgjente që duhen pasur parasysh në menaxhimin e këtij baseni në të ardhmen, për të ruajtur nivelin e ulët të ushqyesve, për të mos nxitur eutrofikimin dhe krizat distrofike që e shoqërojnë atë. Vetëm në këtë mënyrë mund të sigurohet vazhdimësia e cilësisë së mirë të ujit të pijshëm. Natyrisht, monitorimi i vazhdueshëm sidomos i parametrave kryesorë fiziko-kimikë dhe biologjikë do të ndihmonte në njohjen e vazhdueshme dhe parandalimin e dukurive të padëshiruara.

Literatura

- 2000/60/EC: The Water Framework Directive - integrated river basin management for Europe. Directive 2000/60/EC of the European Parliament and of the Council establishing a framework for the Community action in the field of water policy, adopted on 23 October 2000. (http://ec.europa.eu/environment/water/water-framework/index_en.html)
- 2006/44/EC Fish Directive: Directive 2006/44/EC of the European Parliament and of the Council of 6 September 2006 on the quality of fresh waters needing protection or improvement in order to support fish life. Official Journal of the European Union. 264/20—264/31 (<http://rod.eionet.europa.eu/show.jsv?id=626&mode=S>)
- APHA (1988): Standard Methods for the Examination of Water and Wastewater. 20th edn. American Public Health Association, Washington, DC
- Brönmark C., Hansson L. A. (2005): The Biology of Lakes and Ponds. Second Edition. Oxford University Press Inc., New York, NY: 1-285.
- Carlson R. E. (1977): A trophic state index for lakes. *Limnol. Oceanogr.*, 22: 361-369
- Carlson R. E. 1992. Expanding the trophic state concept to identify non-nutrient limited lakes and reservoirs. Proceedings of a National Conference on Enhancing the States' Lake Management Programs. Monitoring and Lake Impact Assessment. Chicago: 59-71
- Carlson R. E., Simpson J. (1996): A Coordinator's Guide to Volunteer Lake Monitoring Methods. North American Lake Management Society: 1-96 <http://dipin.kent.edu/tsi.htm>
- Council Directive 75/440/EEC of 16 June 1975 concerning the quality required of surface water intended for the abstraction of drinking water in the Member States as amended by Council Directive 79/869/EEC (further amended by Council Directive 81/855/EEC and Council Regulation 807/2003/EC) and both amended by Council Directive 91/692/EEC (further amended by Regulation 1882/2003/EC). <http://rod.eionet.europa.eu/instruments/202>
- Correll D. L. (1999): Phosphorus: a rate limiting nutrient in surface waters. *Poultry Science*, 78: 674-682
- Duka S. (2008): Studimi i kimizmit të proceseve limnologjike që ndikojnë në cilësinë e ujit të rezervuarit të Bovillës. Doktoratë. Departamenti i Kimisë, FShN, UT: 1-155
- Heinonen P., Ziglio G., van der Beken A. (2000): Hydrological and Limnological Aspects of Lake Monitoring. John Willey & Sons Ltd: 229
- Jüttner F., Watson B. S. (2007): Biochemical and Ecological Control of Geosmin and 2-Methylisoborneol in Source Waters. *Appl. Environ. Microbiol.*, 73: 4395–4406
- Koussouris T. S., Bertahas I. T., Diapoulis A. C. (1992): Background trophic state of Greek Lakes. *Fresenius Envir. Bull.*, 1: 96-101
- Leonard J., Crouzet P. (1998): Lakes and reservoirs in the EEA area. European Environment Agency. Copenhagen: 1-108
- Moore L., Thornton K. (Ed.) (1988): Lake and Reservoir Restoration Guidance Manual. USEPA. EPA 440/5-88-002. <http://www.pca.state.mn.us/water/lakeacro.html>
- Murtaj B. (2007): Vlerësime kimiko-limnologjike të liqenit të Bovillës, Mikrotezë, Departamenti i Kimisë, FShN, Universiteti i Tiranës.
- OECD (Ed.) (2006): Water Management. Research of the Organization for Economic Co-Operation and Development (OECD). Soil & Water Conservation Society of Metro Halifax (SWCSMH). <http://lakes.chebucto.org/TPMODELS/OECD/management.html>

9. Çullaj & Miho: Mbi gjendjen ushqyese të Liqenit të Bovillës

Quiros R. (2002): The nitrogen to phosphorus ratio for lakes: A cause or consequence of aquatic biology? (11-26). In A. Fernandez Cirelli & G. Chalar Marquisa (eds.) El Agua en Iberoamerica: De la Limnologia a la Gestion en Sudamerica. CYTED XVII, Centro de Estudios Transdisciplinarios del Agua, Facultad de veterinaria, Universitatd de Buenos Aires. Buenos Aires, Argentina: 1-172

Ryder A. R. (1982): The Morphoedaphic Index – Use, Abuse and Fundamental Concepts. Transactions of the American Fishery Society, 111: 154-164

SEPA (Ed.) (2002): Total Phosphorus Water Quality Standards for Scottish Freshwater, Version 1.1, Policy No 16. Scottish Environment Protection Agency (SEPA)

Vighi M., Chiaudani G. (1985): A simple method to estimate lake phosphorus concentrations resulting from natural background loading. Water Research, 19, 8: 987-991

Virginia Tech (2007): Nutrients in lakes and reservoirs – a literature review for use in nutrient criteria development. Special Report, Virginia Water Resources Research Center, Virginia Polytechnic Institute and State University, Blacksburg, Virginia

Vollenweider R. A. (1976): Advances in defining critical loading levels in lake eutrophication. Mem. Ist. Ital. Idrobiol., 33: 53-83

Vollenweider R. A., Kerekes J. (1982): Eutrophication of waters. Monitoring, assessment and control. OECD Cooperative programme on monitoring of inland waters (Eutrophication control), Environment Directorate, OECD, Paris: 1-154.

<http://lakes.chebucto.org/TPMODELS/OECD/management.html>

Willén E. (2000): Phytoplankton in Water Quality Assessment – An Indicator Concept. Në: Hydrological and Limnological Aspects of Lake Monitoring. John Wiley & Sons: 57-80

10

MBI PËRPUNIMIN E UJIT TË BOVILLËS – VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM

ABOUT BOVILLA WATER TREATMENT – OVERVIEW

A. Emiri, E. Buzo, F. Hoxha

Overview

Albania is rich in drinking water resources and the Tirana region as well. The drinking water network stretches out almost over the whole Albanian territory. Nevertheless, there exist problems related to drinking water excess due to the limited collecting capacity, the old distribution system and its scarce maintenance. After 1990s Tirana had drastic changes concerning population growth and development. The drinking water demand increased drastically and the situation could be improved since the year 1998, when the Bovilla Reservoir was constructed. More than 50 millions m³ of water are taken every year from Bovilla Lake and treated by the Treatment Plant, situated in Kodra Kuqe, Tirana. The water is processed using the normal physical treatment, chemical treatment and disinfection, e.g. pre-chlorination, coagulation, flocculation, decantation, filtration, disinfection (final chlorination). In case when unpleasant odors and smell are observed the adsorption method is added using activated carbon; this is normally the case between end of September end April. The treatment process is regularly monitored and automatically controlled. About 25 physical chemical and microbiological parameters are regularly measured daily by the two laboratories involved in the Treatment Plant. During the treatment process the quality of the drinking waters achieve the values required from the Albanian Standard for the drinking water (STASH 3904:1997; VKM 145, 1998).

10.1. Hyrje

Me zhvillimin dhe rritjen e popullsisë, rritet edhe kërkesa për ujë të një cilësie më të mirë (WFD: 2000/60). Krahas përdorimit industrial, bujqësor dhe blegtoral, energjetikë dhe termo-energjetikë, industri, peshkim dhe akuakulturë, lundrim etj., sot po rritet dukshëm kërkesa për ujë të pijshëm sa më cilësor, sidomos në drejtim të higjienës vetjake dhe në turizëm.

Në këtë punim po pasqyrojmë në mënyrë të përmbledhur sigurimin e cilësisë së ujit të pijshëm për Tiranën, duke u përqendruar kryesisht tek përpunimi i ujit të Bovillës, i cili kryhet rregullisht nga Impianti i Përpunimit, Kodra e Kuqe,

Tiranë. Ky punim plotëson, në këtë mënyrë, gjithë diskutimet që paraqiten në këtë vëllim mbi Ujëmbledhësin e Bovillës, i cili nga viti 1999 është burimi kryesor i ujit të pijshëm për gjithë qytetin e Tiranës dhe zonën e banuar rreth saj. Vlen të theksojmë se gjithë kjo është kryer në kuadrin e një studimi gjithëpërfshirës, të kryer gjatë periudhës tetor 2005 - shtator 2008, nëpërmjet projektit të përbashkët kërkimor SCOPES 2005-2008 (Nr. IB7320-111032, për vlerësimin limnologjik dhe hidrologjik të këtij Ujëmbledhësi dhe pellgut të tij, duke u përqendruar në përdorimin për ujë të pijshëm.

10.2. Sistemi i ujit të pijshëm në Shqipëri

Për shkak të kushteve klimatike, kryesisht të reshjeve të bollshme, si dhe të relievit kryesisht kodrinor-malor, Shqipëria është e pasur me ujëra (Tab. 10-1; Fig. 10-1 & 10-2); ajo renditet ndër vendet e para të Evropës për sa i përket sasisë së ujit për frymë të popullsisë, e cila arrin mbi 13'000 m³ frymë/vit (Stanners & Bordeau, 1995); rreth 44% e sasisë së ujërave buron brenda vendit (Kabo, 1990-91; Çullaj *et al.*, 2005). Këto rezerva ujore krijojnë mundësinë që pjesa më e madhe e ujit të pijshëm të merret nga burimet nëntokësore (80%), dhe vetëm 20% nga ujërat sipërfaqësore (Floqi, 2007).

Natural wetlands	Surface, km ²	Number of sites
<i>Brackish lakes</i>	24.2	2
<i>Brackish marshes</i>	8.6	2
<i>Estuaries</i>	88	9
<i>Freshwater marshes</i>	6.4	6
<i>Freshwater springs</i>	6	110
<i>Glacier lakes</i>	2.4	96
<i>Lagoons</i>	252.4	9
<i>Lakes</i>	335.7	228
<i>Rivers and streams</i>	27.1	152
<i>Salt marshes</i>	0.3	1
<i>Sea bays</i>	17.8	1
<i>Wetland forests</i>	4.8	1
Total natural wetlands	773.7	617
Man made wetlands		
<i>Aquaculture ponds</i>	6.4	3
<i>Excavations</i>	0.3	3
<i>Reservoirs</i>	178.8	700
<i>Seasonally wetlands</i>	9.1	1
Total man made wetlands	194.6	707
Total wetlands in Albania	968.3	1324

Tablela 10-1: Sipërfaqja e përgjithshme (km²) dhe numri i përgjithshëm i vendeve ujore në Shqipëri. / Total area (km²) and total number of aquatic sites in Albania (përshtatur sipas Mima *et al*, 2003)

Thuajse gjithë hapësira e territorit shqiptar mbulohet nga rrjeti i ujësjellësve. Zonat e përqendruara urbane, si qytetet e mëdha dhe shumë fshatra furnizohen rregullisht me ujë në çdo shtëpi prej sistemit publik; vetëm një pjesë e vogël në zonat rurale furnizohen nëpërmjet krojeve ose çezmave të


përbashkëta midis shtëpive. Megjithatë, duhet pohuar se pas vitit 1990, gjatë ndryshimit të sistemit (tranzicionit), edhe sistemi i ujësjellësve pësoi dëmtime të rënda; në rreth 400 fshatra ai u shkatërrua thuajse fare. Mendojmë se arsyeja kryesore ishte kalimi prej sistemit të centralizuar në një sistem të decentralizuar menaxhimi.

Figura 10-1: Hartë hidrografike e Shqipërisë. / Hydrographic map of Albania (Miho et al., 2005)

Vështirësitë financiare në sistemin e ujësjellësit vijnë edhe nga mos pagesa e rregullt prej të gjithë konsumatorëve, nga vlerat e ulëta të çmimit të ujit, nga humbjet e mëdha në rrjet dhe lidhjet e palejuara, shpesh dhe ilegale. Sipas të dhënave të Strategjisë për Sektorin e Cilësisë së Ujit të Pijshëm (WB, 2003), në Shqipëri ekzistojnë mbi 50 ndërmarrje ujësjellësisë; rreth 75% e ujit që prodhohet shkon për konsum shtëpiak dhe pjesa tjetër për qëllime të tjera. Në atë periudhë, rreth 60% e kësaj sasive ishte e pamatshme, dhe vetëm 18% paguhej; po sipas WB (2003) vetëm 8 ndërmarrje kishin një bilanc pozitiv. Gjatë këtyre viteve, edhe pse nuk kemi të dhëna, mendojmë se përmirësimi ka pasur, por gjithsesi gjendja mbetet ende larg as që duhet.



Figura 10-2: Sipërfaqja e përgjithshme (km²) sipas habitateve ujore kryesore në Shqipëri. / Total area (km²) and total number of aquatic sites in Albania (përshtatur sipas Mima *et al*, 2003)



Nga gjithë sistemi i ujësllësve në Shqipëri prodhohet për çdo person rreth 120 L/ditë. Meqë humbjet dhe shpërdorimet në rrjetin e shpërndarjes janë shumë të mëdha, vetëm 20-50 L/ditë shkojnë tek konsumatorët në shkallë vendi. Nga mungesa e mbikëqyrjes së rrjetit shpërndarës dhe e amortizimit të thellë të tij në Shqipëri humbjet e ujit luhaten në 50-70% (Floqi, 2007). Për këtë, furnizimi me ujë të pijshëm në shkallë vendi mbetet ende jo i kënaqshëm, shpesh me orar të kufizuar, e përforcuar kjo edhe nga kapaciteti grumbullues i pamjaftueshëm dhe nga ndërprerjet e vazhdueshme të energjisë elektrike.

Përgjithësisht në Shqipëri uji i nënshtrohet vetëm një filtrimi dhe disinfektimi të shpejtë me klor; vetëm në impiantet e Tiranës dhe në atë të Kavajës bëhet përpunim i mëtejshëm i ujit, si do të shohim më poshtë, me paraklorim, koagulim, flokulim, dekantim, filtrim, disinfektim përfundimtar me klorim; në Tiranë, në periudha të caktuara, edhe përpunim me karbon aktiv për ujin e Bovillës. Ndërprerjet e qarkullimit të ujit në sistemin e shpërndarjes, e shoqëruar ndonjëherë edhe me mungesën e lëndëve disinfektuese rrisin rrezikun e ndotjes së tubave nëntokësorë prej infiltrimit të agjentëve të jashtëm kimikë ose biologjikë; për shembull, gjatë ndërprerjes së ujit në tubat vjetër të shpërndarjes nëntokë mund të ndodhin infiltrime prej tubacioneve paralele të ujërave të zeza.

Në zonat rurale, banorët e fshatrave ndonjëherë hapin puse personale pa kontrollin e duhur sanitar; ndonjëherë kjo bëhet edhe në afërsi të shtretërve të lumenjve të ndotur rëndë, si përgjatë Ishmit, Semanit ose Shkumbinit (Miho *et al.*, 2005), dhe e përdorin atë pa përpunimin e duhur (filtrim dhe disinfektim).

Kujtojmë se sipas të dhënave të Qendrës Angleze të Teknologjive Alternative (Anonimous, 2005), në Angli konsumohet nga çdo njeri rreth 220 L/ditë ujë i pijshëm, ndërsa në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, rreth 500 L/ditë. Nga ana tjetër, sipas të njëjtit burim, një njeri për të mbijetuar ka nevojë për rreth 5 L/ditë, për jetën e stilit të sotëm modern rreth 40-80 L/ditë, e cila shpërdorohet sipas histogramës së figurës 10-3. Nga të dhënat e mësipërme, sasia e ujit të pijshëm që shpërndahet nga sistemi në Shqipëri nuk duket se është shumë më e pakët se ajo që konsumohet në vendet e zhvilluara; në Tiranë ajo duket se është shumë më e lartë (Tab. 10-2); në se sistemi do të mbikëqyrej si duhet, ajo do të mjaftonte për të përmbushur kërkesat në rritje të jetës së sotme.




Figura 10-3. Ku shkon gjithë uji që shpërndahet prej ujësjellësit. / Where does all the water go? (Water & Waste: [www.aber.ac.uk/enssus/studentresources/Waterandwaste\(8\).ppt](http://www.aber.ac.uk/enssus/studentresources/Waterandwaste(8).ppt))

Cilësia e ujit të pijshëm në Shqipëri kontrollohet mbështetur në standardin STASH 3904:1997, zbatimi i të cilit sigurohet nga Vendimi 145 i Këshillit të Ministrave (VKM 145, 1998); në të përcaktohen rregullat higjeno-sanitare mbi kontrollin e cilësisë, projektimin, ndërtimin dhe administrimin e sistemit të ujit të pijshëm në Shqipëri. Në këtë vendim janë përfshirë pjesërisht edhe disa nga kërkesat e standardit evropian 80/778, në lidhje me cilësinë e ujërave që konsumohen nga njeriu.

10.3. Sistemi i ujit të pijshëm në Tiranë

Pas ndryshimit të sistemit ekonomik në vitin 1991, Tirana pësoi ndryshime të mëdha; popullsia e të cilës u rrit disa herë, nga rreth 206'000 banorë në vitin 1984, deri në rreth 700'000 në vitin 2001 (INSTAT, 2004); sot (2009) mendohet se në Tiranë popullsia të ketë arritur deri në rreth 850'000 banorë, e cila është më gati sa $\frac{1}{4}$ e gjithë popullsisë së Shqipërisë. Këtu kuptohet që siguri i ujit të pijshëm është mjaft i domosdoshëm.

Zona e Tiranës ka veçori natyrore dhe gjeologjike të pasura me ujëra me cilësi të mirë. Para vitit 1988, uji i pijshëm në Tiranë përfitohej nga burime nëntokësore dhe puse nëntokësore arteziane, burimet e Selitës dhe Shënmërisë (Tab. 10-2) kanë qenë furnizuesit kryesorë të qytetit të Tiranës me ujë të pijshëm. Një tunel përmes malit të Dajtit, i ndërtuar në vitin 1951, sjell ujërat e këtyre burimeve në Tiranë, duke vënë në punë njëkohësisht edhe një hidrocentral të vogël të ndërtuar posaçërisht në rrëzë të malit të Dajtit. Një pjesë e këtyre ujërave ambalazhohen sot edhe në shishe (*shih* Tab. 12-2, tek Mersinllari *et al.*, në këtë vëllim). Nga gushti i vitit 1998 hyri në shfrytëzim Ujëmbledhësi i Bovillës (Tab. 10-2).

Tabela 10-2. Burimet e ndryshme të ujit të pijshëm për Tiranën. / Different drinking water sources in Tirana (Floqi, 2007).

Burime të ujit të pijshëm	Prurja, L/s	Burime të ujit të pijshëm	Prurja, L/s
Burime natyrore nëntokësore		Puse të mëdhenj arteziane	
Selita	300-700	Laknasi	150
Shënmëria	300-700	Bërxulla	160
Bovilla e Vjetër	140-440	Buka, Pema, Coca Cola	30 secili
Ujëra sipërfaqësore		Pishina	100
Ujëmbledhësi i Bovillës	1200 - 1800	Kroi i Shën Gjinit + Çokollata	20
		Çokollata,	20
		Yzberishti	10
Gjithsej			
Prodhimtaria, m³/vit		Litra/person/ditë	Prurja, L/s
Average	83'700'000	269.8	2'758
Minimale	78'524'640	253.1	2'490
Maksimale	100'599'840	324.3	3'190

Sasia e përgjithshme e ujit të prodhuar për Tiranën vlerësohet të luhatet rreth 83'700'000 m³/vit, me prurje mesatare ditore prej rreth 2'758 L/s (Floqi, 2007). Duke bërë një llogaritje të thjeshtë nga të dhënat e tabelës 10-2 për një popullsi prej 850'000 banorësh, në Tiranë prodhohet mesatarisht rreth 270 L/ditë/person ujë i pijshëm. Kjo sasi është jashtëzakonisht e madhe (p.sh. më e madhe se ajo që harxhon Anglia; *Anonimous*, 2005), edhe pse duhet të pohojmë se shpërndarja në qytet mbetet ende me orar të kufizuar dhe shpesh me shqetësime. Nga burimet, uji mbledhet në tre depozita kryesore me kapacitet të përgjithshëm prej rreth 67'600 m³, të vendosura në tre pika të ndryshme të qytetit; secila prej tyre mund të furnizohet nga dy ose tre burime të ndryshme.

Tabela 10-3. Sasia e përgjithshme në m³ e ujit të marrë nga liqeni i Bovillës dhe të përpunuar nga Impianti gjatë tre viteve të fundit; L/d/p, litra në ditë për person; popullsia e Tiranës, 850'000 banorë; çmimi i ujit të përpunuar, 8 lekë/m³. / Total water in m³ taken from the Bovilla Lake and treated by the Treatment Plant during the last three years; L/d/p, liters/day/person; 850'000 inhabitants for Tirana; 8 leke/m³ the price of the treated water.

Muajt	2006		2007		2008	
	Hyrje, m ³	Dalje, m ³	Hyrje, m ³	Dalje, m ³	Hyrje, m ³	Dalje, m ³
Janar	4'126'988	3'978'649	4'826'093	4'458'143	4'836'000	4'594'645
Shkurt	3'845'439	3'563'260	4'368'868	4'059'702	4'524'000	4'252'493
Mars	4'259'545	3'961'178	4'812'162	4'424'027	4'836'000	4'562'362
Prill	4'112'039	3'818'432	4'669'906	4'318'152	4'461'600	4'234'134
Maj	4'344'011	3'994'164	4'863'760	4'486'982	4'836'300	4'505'482
Qershor	4'475'568	4'064'816	4'762'588	4'407'234	4'824'000	4'427'857
Korrik	4'871'891	4'456'178	4'987'882	4'637'492	4'984'800	4'681'303
Gusht	4'857'442	4'443'707	4'931'025	4'625'660	4'984'800	4'638'287
Shtator	4'690'221	4'318'000	4'714'307	4'330'317	4'824'000	4'493'133
Tetor	4'834'076	4'454'764	4'838'537	4'401'142	4'984'800	4'675'574
Nëntor	4'679'033	4'268'876	4'596'286	4'179'972	4'699'200	4'519'776
Dhjetor	4'840'202	4'469'477	4'836'000	4'516'891	4'794'000	4'671'541
Gjithsej, m³	53'936'455	49'791'501	57'207'414	52'845'714	57'589'500	54'256'587
Çmimi, Lekë		398'332'008		422'765'712		434'052'696
Çmimi, Euro	<i>1Euro = 122 Lekë</i>	<i>3'265'016</i>		<i>3'465'293</i>		<i>3'557'809</i>
Gjithsej, L/d/p		160.5		170.3		174.9

Tirana pas viteve 1990 pësoi ndryshime rrënjësore dhe një zhvillim të pakrahasueshëm me ndonjë qytet tjetër, jo vetëm në Shqipëri, por në gjithë Rajonin. Për këtë, ndërtimi i Ujësjellësit të Bovillës ishte vepër e rëndësishme sociale dhe ekonomike, që i erdhi në ndihmë qytetit të Tiranës. Gjithë vepra ka kushtuar rreth 22 miliard lira italiane (rreth 11 milionë Euro), financuar nga një kredi e dhënë nga Ministria e Punëve të Jashtme e Republikës së Italisë. Ndërtimi u ndoq nga Shoqëria Putignano e Barit; drejtimi i punimeve u bë nga një grup teknikësh italianë në bashkëpunim me teknikë shqiptarë; gjatë zbatimit të punimeve u bë njëkohësisht edhe kualifikimi për drejtimin e punëve publike në bazë të normave italiane dhe evropiane (*sipas* Consorzio Putignano, *Fletëpalosje*).

Impianti siguron deri në 1'800 L/s ujë të pijshëm për qytetin e Tiranës. Uji merret nga Ujëmbledhësi i Bovillës, i cili gjendet në pjesën verilindore të Tiranës. Ujëmbledhësi është formuar nga prerja e lumit Tërkuza me një digë prej 81 m të lartë, në grykën e Zall Herit. Ai është mbushur përfundimisht me ujë në gusht 1998. Më shumë Ujëmbledhësin e Bovillës, për ndërtimin e digës

dhe të dhëna të tjera fiziko-gjeografike jepen nga Miho *et al.* (Nr. 1), Çullaj *et al.* (Nr. 2), etj. (në këtë vëllim). Një tubacion çeliku me diametër 90 cm dhe gjatësi 10 km sjell ujin me vetërrjedhje nga kulla e Ujëmbledhësit (kuota 275 m mbi nivelin e detit deri tek Impianti i Përpunimit në Kodrën e Kuqë, Babru (rreth 217 m). Sasia e ujit të marrë nga liqeni i Bovillës dhe të përpunuar nga Impianti gjatë tre viteve të fundit (2006-2008), së bashku me koston e përgjithshme përkatëse dhe sasinë (L/person/ditë) jepet në tabelën 10-3, duke ndjekur ecurinë e paraqitur në grafikët e figurës 10-4. Sasia e ujit të përpunuar pëson një farë ngritje nga viti 2006 në vitin 2008.




Figura 10-4. Ecuria e sasisë së përgjithshme në m³ e ujit të marrë nga liqeni i Bovillës prej Impiantit gjatë tre viteve të fundit. / Dynamics of the total water in m³ taken from the Bovilla Lake by the Treatment Plant during the last three years.

Impianti i Përpunimit është vepra më e rëndësishme e Ujësjellësit të Tiranës, në të cilin kryhen proceset e kthjellimit, filtrimit dhe disinfektimit, duke e kthyer ujin e liqenit të Bovillës tërësisht për pirje. Impianti është vënë në punë në vitin 1998, dhe qysh në fillim drejtohet nga personel shqiptar. Impianti ka një depozitë të ujit të pijshëm me vëllim prej 30'000 m³; prej këte uji shpërndahet në Tiranë me anë të dy tubacioneve prej çeliku, njëri me diametër 120 cm dhe gjatësi 2.5 km që përcjell ujin në Tiranë, kurse një tjetër me diametër 100 cm përcjell ujin tek depozita e Kino Studios (Tiranë) (*sipas* Consorzio Putignano, *Fletëpalosje*).

Sistemi i ujit të pijshëm në Tiranë monitorohet rregullisht nga Drejtoria e Shëndetit Publik (Inspektoriati Kombëtar i Shëndetësisë), i cili është organi më i lartë shtetëror që kontrollon dhe monitoron cilësinë e ujit të pijshëm, si dhe nga vetë Ndërmarrja e Ujësjellës-Kanalizimeve të Qytetit. Nga ana mikrobiologjike monitorohen treguesit e koliformëve dhe streptokokëve fekale, koliformet totale, mikroflora e përgjithshme dhe përmbajtja e klostridiumit; rastet me ndotje më të madhe janë vënë re gjatë muajve me reshje dhe gjatë verës (Floqi, 2007)

10.4. Mbi teknologjinë e pastrimit të ujit të Bovillës

Mbështetur në të dhënat laboratorike shumëvjeçare të Impiantit të Bovillës (*shih* Tab. X-1 tek Shtojca X), si dhe në të dhënat e mbledhura gjatë projektit SCOPES (Çullaj *et al.*, në këtë vëllim), duket se për shumë parametra fiziko-kimikë, uji që vjen nga liqeni i Bovillës i përket kategorisë A_1 të Standardit të Bashkimit Evropian 75/440 për ujërat sipërfaqësore që shfrytëzohen për ujë të pijshëm, sidomos për pH-in, BOD_5 , përcjellshmërinë, ushqyesit (nitratet, fosfatet) etj. Në ujërat e liqenit vihet re prodhimtari e ulët, pra zhvillim i pakët i fitoplanktonit, që i përket gjendjes ushqyese oligotrofe (cilësisë së parë të ujit). Vetëm në pak raste, p.sh. në maj-shtator 2007, është vrojtuar zhvillim relativisht i madh i fitoplanktonit, që i përket një gjendje mesotrofe (cilësi e II-të e ujërave).

Megjithatë, në ujërat e liqenit vihen re përkeqësime për lëndët e ngurta pezull (që shpesh kapërcejnë vlerën 25 mg/L, kategoria A_2) dhe turbulli e lartë, sidomos gjatë reshjeve; po në këtë periudhë vihen re përkeqësime për përmbajtjen e Fe, për koliformet dhe streptokoket fekale. Për disa parametra të tjerë, cilësia e ujërave përkeqësohet kryesisht gjatë periudhës së shtresimit të plotë (maj – shtator), si për oksigjenin e tretur në shtresat e thella (A_2 dhe A_3), për amoniumin etj. (*shih* Çullaj & Miho, në këtë vëllim). Për më tepër, prej vjeshtës së vitit 2001, në ujin e pijshëm është shfaqur herë pas here erë dhe shije e papëlqyeshme, e cila ka bërë që Impianti të shtonte përpunimin me qymyr aktiv, duke rritur më tej koston e pastrimit. Arsyeja e kësaj dukurie, që hera-herës përsëritet, ende nuk dihet qartë; përveç trajtimit me qymyr aktiv kjo ka nxitur marrjen e disa masave parandaluese në Ujëmbledhës.

Sipas standardit 75/440, ujërat që i përkasin kategorisë A_1 kërkojnë vetëm përpunim të thjeshtë - filtrim të shpejtë dhe disinfektim; ujërat e kategorisë A_2 , kërkojnë përpunim të zakonshëm - paraklorim, koagulim, flokulim, dekantim, filtrim, disinfektim përfundimtar me klorim; kjo ndiqet rregullisht nga Impianti i Përpunimit për ujërat e Bovillës. Për ujërat e kategorisë A_3 , kërkohet përpunim i thellë - klorim deri në pikën kritike, koagulim, flokulim, dekantim, filtrim, përpunim me karbon aktiv, ozonim dhe klorim përfundimtar; ky rast, për Impiantin e Përpunimit nënkupton futjen në shfrytëzim të përdorimit të Filierës së Karbonit Aktiv, e cila bëhet vetëm gjatë periudhës kur ndjehet shija dhe era e papëlqyeshme në ujë.

Nga kryerja me korrektësi e procesit teknologjik të pastrimit të ujit përftohet ujë i pijshëm sipas të gjitha normave të përcaktuara në standardin shqiptar STASH 3904:1997 (VKM 145, dt. 26/02/1998), si dhe në standardin e BE-së 80/778. Në figurën 10-5 jepet skema e përpunimit të ujit të pijshëm të Bovillës prej Impiantit të Trajtimit, Kodra e Kuqe, Tiranë.

Në figurën 10-6 jepet, gjithashtu, planimetria e Impiantit të Trajtimit, sipas asaj që është botuar në fletëpalosjen publikuar nga firma ndërtuese Consorzio Putignano (fletëpalosje), e rifreskuar me kullën e karbonit aktiv. Më poshtë po japim përmbledhtas hapat kryesore që ndiqen gjatë përpunimit të ujit; vlen të theksojmë se të dhëna plotësuese për këtë janë publikuar dhe më parë nga Emiri (2002) dhe Buzo (2008).

Fillimisht uji që vjen nga Bovilla hyn në **Partitor** (Fig. 10-6/2 dhe 10-7/b); këtu dozohen Polikloruri i Aluminit $[Al_n(OH)_m(Cl)_x(SO_4)_v]$, 10% (si koagules – flokulues), Hipokloriti i Natriumit (NaOCl), 13-15% (si oksidues – disinfektues), Acidi Klorhidrik, 30–33% (si korrektues pH-i). Në periudhën e shfaqjes së

shijes së papëlqyshme në ujë në këtë hap shtohet edhe trajtimi me **Karbon Aktiv Pluhur (CAP)** (Fig. 10-5, 10-6/22 dhe 10-8/b).

Gjatë procesit të **oksidimit** (Fig. 10-5), hipokloriti i natriumit ndihmon në oksidimin e amoniakut, hekurit, lëndëve organike, sulfureve etj. Gjithashtu, ai bën ngordhjen e pjesës më të madhe të gjallesave, përfshirë dhe ato patogjene, të pranishme në ujin e pa trajtuar natyror. Dozimi i acidit klorhidrik në Partitor shërben për korrektimin e pH-it, i cili duhet të jetë në intervalin 7.5–7.8, i përshtatshëm për të penguar tretjen e joneve Al^{3+} në ujë, si dhe për kryerjen sa më mirë të disinfektimit; në këtë pH ndodh formimi i HClO (acid hipokloror), i cili vepron më fuqishëm mbi mikroorganizmat se jonet ClO^- (hipoklorit).

Me ndihmën e tre portave ndarëse, uji i trajtuar me kimikatet e mësipërme kalon në tre **Kiariflokulesit (Pulsuesit)** (Fig. 10-6/4 dhe 10-7/c), të cilët janë me pulsime me shtrat balte, me kapacitet 600 L/s secili; fillimisht, uji hyn në një kambanë qendrore, e cila boshatiset në intervale të rregullta dhe të rregullueshme. Ngritja dhe ulja e alternuar e nivelit në kambanë komandohet nga kalimi nën vakum, e pasuar nga kalimi sërish nën presion atmosferik të hapësirës brenda saj. Shtrati i baltës i nënshtrohet lëvizjeve të alternuara në ulje gjatë ngritjes së nivelit të ujit në kambanë, për shkak të thithjes së ajrit nga aspiratori i montuar në kokë të kambanës, dhe në ngritje kur kambana vendoset nën presion atmosferik.




Figura 10-5. Skema e përpunimit të ujit të pijshëm të Ujëmbledhësit të Bovillës. / Scheme of drinking water treatment of Bovilla reservoir.




Figura 10-6. Skema e Ujësjetësimit të Bovillës, Tiranë; **1,** Pusi i matësit dhe valvula rregulluese e prurjes; **2,** Hyrja dhe shpërndarja e prurjes; **3,** Matësi në hyrje të dekantuesve; **4,** Basenet e dekantimit me pulsime; **5,** Basenet e filtrimit me gravitet; **6,** Depozitat e mbledhjes së ujit të filtruar dhe përfundimit të ujit të largës së filtrave; **7,** Zyrat e arkivit dhe të drejtorisë; **8,** Salla e makinave dhe presuesve të filtrave, kabina elektrike, gjeneratori elektrik, tharja e baltërave; **9,** Zyra dhe shërbime të ndryshme; **10,** Depozita e ushqimit të rrjetit hidrik të Tiranës; **11,** Stacionet e ngritjes së baltërave tek basenet e dendësimit; **12,** Basenet e dendësimit të baltërave; **13,** Stacioni i ngritjes së ujit të kthjelluar nga basenet e dendësimit; **14,** Depozita për përpunimin kimik të baltërave; **15,** Depozitimi dhe dozimi i lëndëve kimike; **16,** Peshore automatike; **17,** Puseta shkarkuese e ujërave të tepërta; **18,** Puseta për shkarkimin e ujërave të zeza të brendshme; **19,** Gropa septike; **20,** Puseta e ujërave të shiut; **21,** Impianti ngritës për shkarkimin e ujërave çidratues të baltërave; **22,** Kulla e karbonit aktiv. / Scheme of the Bovilla Treatment Plant, Tirana (Consorzio Putignano, Fletëpalosje).



Figura 10-7. a) Pamje nga jashtë e ndërtesës qendrore të Impiantit të Përpunimit të Ujit të Bovillës, Kodra e Kuqe, Tiranë; **b)** Partitori; **c)** Flokulatori; **d)** Dekantuesi; **e)** Filtri. / **a)** Outside view of the main buildings of the Bovilla Water Treatment Plant, Kodra e Kuqe, Tirana; **b)** Partition; **c)** Flocculation; **d)** Decantation; **e)** Filtration (Photos: Buzo & Hoxha).

Lëvizja ngjitëse e shtratit të llumrave shfrytëzohet për të larguar një pjesë të tyre me anë të derdhjes në disa gropa të vendosura në qendër të **Dekantuesit** (Fig. 10-6/11 dhe 10-7/d), të cilat pastrohen herë pas here automatikisht. Uji shpërndahet njëtrajtësisht në bazën e veprës nëpërmjet një rrjeti tubash të shpuar, të mbuluar me çati plastike, mbi të cilat formohet shtrati i llumit. Mbledhja e ujit të dekantuar bëhet në sipërfaqe me anën e ulluqeve përkatëse.


Procesi i koagulim–flokulimit ndodh në dy etapa: 1) hedhja e koaguluesit (poliklorurit të aluminit) në partitor dhe përzierja e shpejtë për të nxitur koagulimin; 2) përzierja e ngadaltë në kambanën e pulsuesit për të nxitur flokulimin.

Më pas uji kalon në **Baterinë e Filtrave** (Fig. 10-6/5-6, 10-7/e dhe 10-8/a), e cila është e përbërë nga tetë filtra të tipit të shpejtë, me gravitet, me shtrat me rërë kuarcore. Bateria e filtrave është e pajisur me një impiant automatik larje, i cili, në varësi të shkallës së mbushjes, automatikisht bën larjen e tyre me ujë të trajtuar dhe ajër. Pas procesit të koagulim–flokulimit, dekantimit, filtrimit turbullira e ujit të trajtuar paraqitet e ulët, në vlera 0.15–0.20 NTU.

Pas filtrimit, uji mblidhet në **Serbatorin e Ndërmjetëm** 5'000 m³, dhe më pas kalon në procesin **pasdisinfektimit**, proces ky që siguron shkatërrimin e plotë të mikroorganizmave dhe parandalon formimin e kolonive të reja gjatë shpërndarjes në rrjet. Përfundimisht uji i trajtuar kalon në dy **Serbatorët Kryesorë** (Fig. 10-6/10) prej 15'000 m³ secili; prej këtej uji shpërndahet në rrjet për konsum.

Që nga vjeshta e vitit 2004 ka filluar të përdoret Karboni Aktiv Pluhur për largimin e shijes së papëlqyeshme që shfaqet tek uji i patrajtuar, sidomos gjatë periudhës vjeshtë–pranverë. Karboni aktiv pluhur dozohet në hyrje të **Filierës (Partitor)** në doza rreth 10-12 mg/L, së bashku me tre kimikatet e sipërpërmendura (poliklorurin e aluminit, hipokloritin e natriumit dhe acidin klorhidrik); edhe ky largohet më pas nëpërmjet stadeve të koagulim–flokulim–dekantimit, dhe atij të filtrimit. Ky lloj trajtimi, ka filluar pas vitit 2004, si rrjedhojë e shfaqjes së një farë shije dhe ere të papëlqyeshme në ujë. Për periudhën 2006-2008, trajtimi karbon aktiv pluhur është kryer në periudhat: 6/10/2006 deri 24/04/2007 dhe 17/09/2007 deri 30/04/2008. Nga studimi limnologjik i liqenit është arritur në përfundimin se dukuria e erës dhe shijes ndodh në periudhën e prishjes së shtresëzimit të liqenit, tetor - mars; gjatë kësaj periudhe temperaturat e ujit janë relativisht të ulëta dhe sasia e reshjeve është e madhe; nga ana tjetër përmbajtja e fitoplanktonit duket se është shumë e pakët; për këtë është arritur në përfundim se burimi biologjik i lëndëve që shkaktojnë erën dhe shijen e papëlqyeshme në ujë të jenë kryesisht bakteret e tokës (actinomicetes) (Çullaj & Bachofen, në këtë vëllim).

10. Emiri & Hoxha: Mbi përpunimin e ujit të Bovillës – vështrim i përgjithshëm



◀**Figura 10-8. a)** Bateria e filtrave; **b)** kulla e karbonit aktiv; **c-e)** Gjatë vizitave me ekspertë të huaj në Ujëmbledhësin e Bovillës dhe Impiantin e Trajtimit të Ujit. / **a)** Filters units; **b)** active carbon unit; **c-e)** Meeting with foreign experts during the visit in the Bovilla Reservoir and the Treatment Plant (Photos: Shuka & Hoxha).

10.5. Mbi cilësinë e ujit të pijshëm nga Impianti i Bovillës

Cilësia e ujit të pijshëm me origjinë nga Ujëmbledhësi i Bovillës ndiqet rregullisht nga dy laboratorë, kimik dhe mikrobiologjik, të ngritur pranë Impiantit të Trajtimit (*shih* dhe Fig. 6-2, tek Hoxha *et al.*, Nr. 6 në këtë vëllim). Këta dy laboratorë kryejnë rregullisht një herë ose dy herë në ditë analiza për rreth 19 parametra fiziko-kimikë dhe 6 parametra mikrobiologjikë (Tab. 10-5). Në secilin laborator kryen analizat për ujin e pa trajtuar dhe për ujin e trajtuar; gjithashtu, maten disa herë në ditë disa nga parametrat kryesore të ujit në stadet kryesore të ecurisë së trajtimit të ujit: hyrje, partitor, flokulator, filtra dhe në dalje të Impiantit. Në të njëjtën kohë, nga aparatura monitorimi elektronike për ujë të patrajtuar dhe të trajtuar, maten në mënyrë automatike parametrat, si pH-i, temperatura, turbullia, përcjellshmëria, klori i lirë; të dhënat pasqyrohen në serverin qendror, i cili bën mbikëqyrjen automatike të gjithë procesit teknologjik të pastrimit të ujit. Theksojmë se metodat që përdoren nga ana jonë janë në përputhje me standardin evropian 80/778 dhe me Standardin shqiptar STASH 3904:1997 (VKM 145, 1998) (Tab. 10-4), për cilësinë e ujërave që konsumohen nga njeriu

Tabela 10-4. Disa nga vlerat kufi të Standardit të BE-së 80/778 (Appendix I), dhe Standardit Shqiptar (VKM 145, 1998) për ujin e pijshëm. / Guide values of EU Standard 80/778 (Appendix I), and Albanian Standard 3904:1997 (VKM 145, 1998) for drinking water.

Parametrat	EC DESIG.: 80/778		STASH 3904:1997	
	Norma	Maksimumi	Norma	Maksimumi
Përqëndrimi i joneve H ⁺ , pH	6.5-8.5	-	6.5-8.5	9.5
Turbullia, NTU	0.4	4.0	0.4	4.0
Kalciumi, mg/L Ca	100	-	75	200
Kloruret, mg/L Cl	25	-	25	200
Sulfatet, mg/L SO ₄	25	250	25	250
Amoniaku, mg/L NH ₄	0.05	0.5	<KD	0.05
Nitratet, mg/L NO ₃	25	50	25	50
Fosfatet, µg/L P ₂ O ₅	400	5'000	400	2'500
Alumini, mg/L Al	0.05	0.2	0.05	0.2
Hekuri, µg/L Fe	50	200	50	300
Koliformet totale, koloni/100ml	0.0	-	0.0	-
Streptokoket fekale, koloni/100ml	0.0	-	0.0	-
Koliformet fekale, koloni/100ml	0.0	-	0.0	-

Dy janë metodat që përdoren për përcaktimin e parametrave fiziko-kimikë: **metoda spektrofotometrike UV-VIS** dhe **metoda vëllimetrike** (APHA, 1998). Gjithashtu, prej laboratorit mikrobiologjik kryhen rregullisht çdo ditë **koliformet totale, koliformet fekale dhe streptokoku fekal, mikroflora e përgjithshme** në 22°C dhe 36°C, si dhe **klostridiumi**. Për tre analizat e para përdoret teknika e filtrimit membranor (APHA, 1998), ku filtrohen 100 ml ujë me ndihmën e një aparati filtrues me vakum, duke përdorur filtra membranorë me diametër 47-50 mm, dhe përmasa të poreve 0.45 µm. Filtrat me përmbajtjen e ujit të filtruar vendosen në pjata Petri (pjastra) me terrene të gatshme të dehidratuar, dhe sipas rastit vendosen në termostate ose në banjomari. Terrenet dhe reagentët e përdorur jepen në tabelat 6-3 dhe 6-4 tek Hoxha *et al.* (Nr. 6 në këtë vëllim) (shih dhe Fig. 6-3 dhe 6-4, po aty).

Nga të dhënat e mesatareve mujore në tabelat X-1 dhe X-2 (Shtojca X) dhe tabelën 10-5, vihet re se uji i pa trajtuar i Bovillës dallohet për cilësi të mira fiziko-kimike, shpesh në përputhje me kategorinë A₁; ato janë mesatarisht të freskëta gjatë gjithë stinëve, temperatura e të cilave luhetet nga rreth 7-14°C (Fig. 10-9), veçori e cila është shumë e pranueshme sidomos në stinën e nxehtë të verës. Kujtojmë se tek vepra e shkarkimit dhe e marrjes së ujit në Liqen (shih Fig. 1-11 tek Miho *et al.*, Nr. 1 në këtë vëllim), gjenden pesë porta të marrjes së ujit, përkatësisht në kuotat 310.8, 304.1, 297.4, 290.7, 284 m mbi nivelin e detit. Nisur nga thellësia maksimale (normale) e ujit në Liqen, 318 m mbi nivelin e detit, portat e marrjes gjenden midis thellësive nga rreth 8 m deri në 34 m.

Tabela 10-5. Të dhënat e mesatareve mujore të disa parametrave fiziko-kimikë dhe mikrobiologjikë që maten rregullisht nga Impianti i Përpunimit të Ujit të Bovillës, para dhe pas trajtimit të ujit, gjatë tre viteve të fundit (2006-2008). / Monthly data (average, minimum, maximum) of some physico-chemical and microbiological parameters, before and after treatment, during the last three years (2006-2008), measured regularly by the Bovilla Drinking Water Treatment Plant.

Parametrat	Para trajtimit			Pas trajtimit		
	Minimale	Mesatare	Maksimale	Minimale	Mesatare	Maksimale
Temperatura ajrit, °C	4.60	14.75	25.40	4.64	14.76	25.40
Temperatura ujit, °C	6.80	11.13	14.28	6.80	10.94	14.14
Përqendrimi i joneve H ⁺ , pH	7.80	8.06	8.28	7.75	7.83	7.92
Turbullia, NTU	0.93	4.31	15.45	0.08	0.18	0.28
Kalciumi, mg/L Ca	36.28	38.20	39.30	36.28	38.16	39.30
Fortësia e përgjithshme, °Gjermane	7.58	7.84	8.24	7.57	7.84	8.24
Alkaliniteti, mg/L CaCO ₃	127.50	141.13	150.60	127.50	141.14	150.60
Hidrogjensulfuret, µg/L H ₂ S	10.29	12.56	16.70	<KD	<KD	<KD
Oksigjeni i tretur, mg/L O ₂	8.10	9.84	12.70	9.54	10.58	11.80
Lëndë organike (KMnO ₄ , mg/L)	0.87	1.07	1.74	0.52	0.59	0.84
Kloruret, mg/L Cl	5.99	6.30	7.00	12.50	13.31	14.00

Parametrat	Para trajtimit			Pas trajtimit		
	Minimale	Mesatare	Maksimale	Minimale	Mesatare	Maksimale
Sulfatet, mg/L SO_4^{2-}	20.13	23.46	27.30	20.10	23.52	26.54
Amoniaku, mg/L NH_4^+	0.02	0.03	0.05	<KD	<KD	<KD
Nitritet, mg/L NO_2^-	0.00	0.01	0.02	<KD	<KD	<KD
Nitratet, mg/L NO_3^-	0.74	0.94	1.20	0.81	0.99	1.23
Fosfatet, μ g/L P_2O_5	33.00	50.90	77.50	13.80	20.60	28.40
Klori i lirë, mg/L	-	-	-	0.74	0.96	1.52
Alumini, mg/L Al^{3+}	0.02	0.02	0.02	0.04	0.05	0.05
Hekuri, μ g/L Fe	23.40	130.50	397.50	<KD	0.08	1.36
Koliformet totale, koloni/100ml	2.00	17.36	63.00	0.00	0.00	0.00
Streptokoket fekale, koloni/100ml	4.00	30.06	159.00	0.00	0.00	0.00
Koliformet fekale, koloni/100ml	1.00	15.00	49.00	0.00	0.00	0.00
Mikroflora e përgjithshme (36 °C), koloni/ml	3.00	14.06	33.00	0.00	0.61	14.00
Mikroflora e përgjithshme (22 °C), koloni/ml	0.00	18.86	47.00	0.00	0.42	2.00
Klostridium, koloni/20 ml	0.00	0.03	1.00	0.00	0.00	0.00




Figura 10-9. Ecuria mesatares mujore të temperaturës së ajrit dhe ujit që ka hyrë në Impiantin e Përpunimit gjatë periudhës 2006-2008. / Dynamics of monthly average values of air and water temperature during years 2006-2008.




Figura 10-10. Ecuria mesatares mujore të oksigjenit të tretur në ujë (mg/L) për periudhën 2006-2008, para dhe pas trajtimit të ujit. / Dynamics of monthly average values of dissolved oxygen (mg/L) during years 2006-2008, before and after water treatment.




Figura 10-11. Ecuria e mesatares mujore të turbullisë për periudhën 2006-2008 para dhe pas trajtimit. Vija e ndërprere është norma, N=0.4 NTU, sipas STASH 3904:1997; max, vlera maksimale e lejuar e këtij Standardi. / Dynamics of monthly average values of turbidity during years 2006-2008; N, norm (guide), 0.4 NTU after Albanian Standard 3904:1997; M, maximal value (imperative) of this Standard.




Figura 12. Ecuria mesatares mujore të koliformeve të përgjithshme, koliformeve fekale dhe streptokokeve fekale (koloni/100 ml) në ujin e patrajtuar të Bovillës gjatë periudhës 2006-2008. / Dynamics of monthly average values of total Coli, fecal Coli and fecal Streptococci (colonies/100 ml) in Bovilla untreated waters during 2006-2008.

Kujtojmë, gjithashtu, se ujërat në liqen luhaten ndjeshëm gjatë vitit, nga 311 deri në 318 m mbi nivelin e detit (*shih* Fig. 1-9 tek Miho *et al.*, në këtë vëllim). Nga sa më sipër, portat e marrjes ndryshojnë në përputhje me kushtet e mësipërme, duke u prirë të marrin ujë nga shtresat e termokliniit, nga 10-15 m thellësi duke filluar nga pasqyra e ujit; këto shtresa kapen nëpërmjet portës së dytë (kuota 304.1 m) gjatë niveleve maksimale, dhe portës së tretë (kuota 297.4 m) gjatë niveleve minimale të ujit në Liqen. Gjithashtu, ujërat që vijnë në Impiant janë të oksigjenuara mirë (Fig. 10-11). Fortësia e përgjithshme e ujit 7.5 deri 8.2 °Gjermane e klasifikon atë si ujë të butë (http://en.wikipedia.org/wiki/Hard_water), me sasi jo shumë të madhe të kripërave minerale, kryesisht karbonateve ose sulfateve të kalciumit ose magnezit.

Megjithatë, si shumë ujëra sipërfaqësore që përdoren për ujë të pijshëm, edhe uji i Bovillës përmban sasi relativisht të mëdha lëndësh pezull, me origjinë biologjike ose inorganike, si mund të vihen re edhe nga ecuria e turbullisë në figurën 10-11. Po kjo gjë mund të thuhet për përmbajtjen e hekurit, ose të ngarkesës mikrobike (Fig. 10-12), për të cilën është diskutuar edhe nga Hocha & Emiri (Nr. 6 në këtë vëllim).

Gjatë përpunimit të ujit, ndodh largimi i gjithë pezullive dhe përmbajtjes bakteriale deri në kufijtë e kërkuar nga Standardi Shqiptar 3904:1997. Në këtë

mënyrë, gjatë përpunimit ulen ndjeshëm vlerat e turbullisë, nitritet, amoniumi, hidrogjensulfuret dhe hekuri thuajse shkojnë drejt zeros; po, në këtë mënyrë, shkatërrohen edhe bakteret koliforme dhe streptokoket (Tab X-2, tek Shtojca X).

Gjatë pranisë së erës së papëlqyeshme në ujë vihet në shfrytëzim përthithja me karbon aktiv pluhur. Vlen të theksojmë se kjo dukuri vihet re gjatë periudhës, vjeshtë – pranverë, në të cilën niveli i ujërave në liqen është maksimal, kur përmbajtja e lëndëve pezull (turbullia) në ujëra, por edhe e përbërsave të tjerë, si e hekurit e azotit, e baktereve etj. janë maksimale.

Përmbledhje

Shqipëria është e pasur me burime ujore për ujë të pijshëm, përfshirë këtu dhe zonën e Tiranës. Rrjeti i ujit të pijshëm shtrihet thuajse në gjithë territorin shqiptar. Megjithatë, shqetësime në lidhje me ujin e pijshëm ekzistojnë ende për shkak të kapacitetit të ulët grumbullues, sistemit të vjetruar dhe mirëmbajtjes jo të mirë. Pas viteve 1990-të Tirana pësoi ndryshime të mëdha në lidhje me rritjen e popullsisë dhe të zhvillimin; kërkesa për ujë të pijshëm u rrit dukshëm. Gjendja u përmirësua duke filluar nga viti 1998 kur përfundoi ndërtimi i ujëmbledhësit të Bovillës. Mbi 50 milionë m³ ujë merret çdo vit nga Bovilla dhe përpunohet nga Impianti i Përpunimit tek Kodra e Kuqe, Tiranë. Përpunimi bëhet duke ndjekur trajtimin e zakonshëm fizik, trajtimin kimik dhe dezinfektimin, konkretisht, paraklorim, koagulim, flokulim, dekantim, filtrim, dezinfektim (klorim përfundimtar). Në rastet kur ndjehet erë e papëlqyeshme në ujë, vihet në shfrytëzim përthithja me karbon aktiv pluhur; kjo ndodh gjatë periudhës shtator – prill. Procesi i trajtimit ndiqet rregullisht dhe kontrollon në mënyrë automatike. Mbi 25 parametra fiziko-kimikë dhe bakteriologjikë maten rregullisht çdo ditë, përkatësisht, nga dy laboratorë të Impiantit. Gjatë procesit të trajtimit cilësia e ujit të pijshëm arrin gjithmonë kufijtë e dëshiruara nga Standardi shqiptar për ujin e pijshëm (STASH 3904:1997; VKM 145, 1998).

Literatura

Anonymous (2005): Environmental Sustainability. Water and Waste (Lecture 8). Aberystwyth University, United Kingdom. <http://www.aber.ac.uk/ensus/studentresources/>

Anonymous (1996): Impianti Hidroteknik i Bovillës / Impianto Idrotecnico di Bovilla. Ministria e Ndërtimit dhe Turizmit, Tirana. 1-24

APHA (Ed.) (1998): Standard Methods for the Examination of Water and Wastewater. 20th Edition. American Public Health Association, Washington, DC.

Bachofen R. (2008): Solving environmental problems by transdisciplinary research. Proceedings of International Conference on Biological and Environmental Sciences. University of Tirana, Faculty of Natural Sciences: 708-712

Buzo E. (2008): Paraqitje e shkurtër e procesit teknologjik të trajtimit të ujit të pijshëm dhe studimi i disa parametrevë fiziko-kimikë në impiantin Bovillë. Proceedings of International Conference on Biological and Environmental Sciences. University of Tirana, Faculty of Natural Sciences: 540-546

Consorzio Putignano - Bari, *Fletëpalosje*: Acquedotto di Bovilla. Fase 2. Condotta di Adduzione dalla Diga di Bovilla, Impianto di Potabilizzazione, Serbatoio, Condotta di Avvicinamento alla Rete Idrica di Tirana. Repubblica di Albania, Ministero delle Costruzione e Turismo.

Council Directive 75/440/EEC of 16 June 1975 concerning the quality required of surface water intended for the abstraction of drinking water in the Member States as amended by Council Directive 79/869/EEC (further amended by Council Directive 81/855/EEC and Council Regulation 807/2003/EC) and both amended by Council Directive 91/692/EEC (further amended by Regulation 1882/2003/EC). <http://rod.eionet.europa.eu/instruments/202>

Council Directive 80/778/EEC of 15 July 1980 relating to the quality of water intended for human consumption as amended by Council Directives 81/858/EEC and 91/692/EEC (further amended by Council Regulation 1882/2003/EC).

Çullaj A., Hasko A., Miho A., Schanz F., Brandl H., Bachofen R. (2005): The quality of Albanian natural waters and the human impact (Review article). *Environment International* 31: 133-146 (www.sciencedirect.com)

Emiri A. (2002): Teknikat, analizat dhe kimikatet që përdoren në trajtimin e ujit në Impiantin Bovillë. Ne dhe Mjedisori, 22. ShRMNSh. Tiranë: 9-13

Floqi T. (2007): Water quality and health - Albanian case. PPT. za ucesnike Godisnjeg savetovanja sudija Srbije 2007, Vrnjacka Banja, Serbia, 8-10.10.2007. <http://water-environment.vin.bg.ac.yu/proceedings/>

INSTAT (Ed.) (2004): Population and Housing Census of Albania, 2001. Shqipëria 2001 - Regjistrimi në Harta. Seria e Studimeve. Tirana: 11. <http://www.instat.gov.al/>

Miho A., Cullaj A., Hasko A., Lazo P., Kupe L., Schanz F., Brandl H., Bachofen R., Baraj B. (2005): Gjendja mjedisore e disa lumenjve të Ultësirës Adriatike Shqiptare. SCOPES program (Swiss National Science Foundation - SNSF), Tirana (In Albanian with a summary in English): 1-235 (<http://www.fshn.edu.al/biologjia/SCOPES/007-008-Pasqyra-Content.htm>)

Mima M., Fitoka N. E., Bego F. (Eds.) (2003): Inventarizimi i ligatinave shqiptare. ECAT Tirana & EKBY. Themi, Greece: 1-130 + 75 pp. Annexes. (In Albanian, Greek and English)

Murtaj B., Çullaj A. (2008): Limnological assessment of Bovilla basin. Proceedings of International Conference on Biological and Environmental Sciences. University of Tirana, Faculty of Natural Sciences: 688-692

Stanners D., Bourdeau Ph. (eds.) (1995): Rivers, reservoirs and lakes. Europe's environment. Copenhagen. European Environment Agency: 73– 108

STASH 3904 (1997): Standardi Shqiptar i Ujit të Pijshëm; ICS 13.060

UNEP (Ed.) (2000): Post-Conflict Environmental Assessment – Albania. United Nations Environment Programme, Nairobi, Kenya 1-80. <http://enrin.grida.no/htmls/albania/reports/postcon/eng/7.htm>

VKM 145 (1998): VKM Nr. 145, datë 26.02.1998 «Për miratimin e rregullores Higjieno-Shëndetësore për kontrollin e cilësisë së ujit të pijshëm, projektimin, ndërtimin dhe mbikqyrjen e sistemeve të furnizimit me ujë të pijshëm».

WB (Ed) (2003): Water Supply and Sanitation Sector Strategy (Final draft): The World Bank: 1-135 ([siteresources.worldbank.org/INTALBANIA/ Resources/NWSFinal29June04.pdf](http://siteresources.worldbank.org/INTALBANIA/Resources/NWSFinal29June04.pdf))

WFD 2000/60/EC: The Water Framework Directive - integrated river basin management for Europe. Directive 2000/60/EC of the European Parliament and of the Council establishing a framework for the Community action in the field of water policy, adopted on 23 October 2000. (http://ec.europa.eu/environment/water/water-framework/index_en.html)

SHTOJCA X / ANNEX X

Tabela X-1. Të dhëna mesatare mujore (2006-2008) për ujin e patrajtuar të Bovillës. / Monthly average values (years 2006 – 2008) of Bovilla water.

Parametrat / Muajt	I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII
2006 – Para trajtimit												
Temperatura ajrit, °C	4.60	6.50	9.40	12.86	18.45	21.90	25.38	22.80	20.70	16.90	11.00	7.70
Temperatura ujit, °C	8.00	6.80	7.30	9.40	10.44	11.55	12.40	12.57	12.60	12.60	13.00	10.80
Përqëndrimi i joneve H ⁺ , pH	8.20	8.28	8.28	8.23	8.09	8.00	7.97	7.90	7.86	7.83	8.00	8.04
Turbullia, NTU	8.25	3.50	11.80	4.83	2.22	3.94	1.89	2.30	1.92	2.34	5.00	5.06
Kalciumi, mg/L Ca	38.00	38.00	38.50	38.10	37.60	37.80	37.70	37.80	38.00	37.90	39.00	38.00
Fortësia e përgjithshme, °Gjermane	7.70	7.70	7.96	7.86	7.77	7.80	7.77	7.80	7.73	7.74	8.00	7.58
Alkaliniteti, mg/L CaCO ₃	131.00	129.00	130.00	130.00	129.40	127.50	128.00	129.00	130.00	133.00	140.00	139.00
Hidrogjensulfuret, µg/L	11.80	10.30	11.00	11.94	12.96	14.48	13.36	15.14	14.90	15.43	14.89	12.34
Oksigjeni i tretur, mg/L O ₂	12.00	12.50	12.70	12.59	12.32	11.50	10.77	9.78	9.07	8.47	9.00	9.46
Lëndë organike (KMnO ₄ , mg/L)	1.10	0.90	0.97	0.91	0.91	0.91	0.87	0.96	0.99	1.01	1.00	1.03
Kloruret, mg/L Cl ⁻	6.20	6.20	6.50	6.40	6.03	6.10	6.25	6.40	6.03	6.21	7.00	6.22
Sulfatet, mg/L SO ₄ ²⁻	23.50	23.50	23.70	22.97	22.30	21.54	20.93	20.71	20.80	20.13	22.00	23.03
Amoniak, mg/L NH ₄ ⁺	0.035	0.040	0.047	0.030	0.028	0.034	0.024	0.030	0.025	0.033	0.045	0.030
Nitritet, mg/L NO ₂ ⁻	0.006	0.006	0.013	0.006	0.000	0.003	0.003	0.007	0.006	0.008	0.011	0.009
Nitratet, mg/L NO ₃ ⁻	1.20	1.10	1.14	1.15	1.04	0.90	1.03	1.02	0.95	0.93	0.92	0.95
Fosfatet, µg/L P ₂ O ₅	44.20	36.80	48.30	39.90	33.00	35.00	38.70	39.50	46.00	62.40	60.70	49.60
Klori i lirë, mg/L												
Alumini, mg/L Al ³⁺	0.020	0.018	0.022	0.020	0.019	0.020	0.019	0.019	0.019	0.020	0.020	0.020
Hekuri, µg/L Fe ³⁺	308.00	95.00	369.00	112.00	48.90	37.63	43.75	81.38	60.42	88.75	144.70	204.00
Koliformet totale, koloni/100ml	26.00	12.00	22.00	22.00	17.00	19.00	4.00	5.00	10.00	10.00	17.00	20.00

Parametrat / Muajt	I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII
Streptokoket fekale, koloni/100ml	48.00	12.00	32.00	32.00	11.00	29.00	12.00	13.00	18.00	14.00	17.00	21.00
Koliformet fekale, koloni/100ml	43.00	24.00	48.00	48.00	21.00	27.00	5.00	5.00	13.00	17.00	17.00	18.00
Mikroflora e përgjithshme (36°C), koloni/ml	26.00	17.00	33.00	33.00	18.00	29.00	31.00	15.00	15.00	18.00	29.00	25.00
Mikroflora e përgjithshme (22°C), koloni/ml	27.00	21.00	37.00	26.00	19.00	22.00	47.00	31.00	27.00	29.00	38.00	31.00
Klostridium, koloni/20 ml	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
2007 – Para trajtimit												
Temperatura ajërit, °C	6.45	5.80	10.60	12.80	17.90	22.90	25.40	23.70	18.23	15.32	10.07	6.65
Temperatura ujit, °C	8.90	8.47	9.10	9.95	10.88	11.88	12.49	12.90	13.21	14.28	12.87	10.19
Përqëndrimi i joneve H ⁺ , pH	8.13	8.16	8.10	8.13	8.11	8.06	7.95	7.91	7.80	7.93	8.04	8.20
Turbullia, NTU	7.18	5.50	3.20	2.34	1.14	2.37	0.97	0.93	2.45	2.47	12.30	8.99
Kalciumi, mg/L Ca	38.05	37.90	37.60	37.99	38.06	37.95	36.28	37.10	38.95	38.68	38.64	38.46
Fortësia e përgjithshme, °Gjermane	7.67	7.69	7.70	7.76	7.72	7.75	7.75	7.79	7.94	7.79	7.82	7.78
Alkaliniteti, mg/L CaCO ₃	140.00	140.00	139.40	144.30	147.60	146.60	146.80	144.00	148.70	150.60	146.10	143.50
Hidrogjensulfuret, µg/L	12.20	10.70	11.20	12.30	12.20	12.40	16.70	13.50	14.10	11.60	12.10	11.70
Oksigjeni i tretur, mg/L O ₂	10.20	10.30	10.80	11.60	10.10	9.20	8.60	8.50	8.50	8.20	8.10	8.10
Lëndë organike (KMnO ₄ , mg/L)	1.13	0.99	1.00	1.00	0.98	1.03	1.00	1.01	1.03	1.29	1.38	1.27
Kloruret, mg/L Cl ⁻	6.17	6.19	6.07	6.23	6.19	6.03	5.99	6.13	6.50	6.31	6.53	6.57
Sulfatet, mg/L SO ₄ ²⁻	23.70	23.36	23.70	23.58	21.67	22.54	20.80	22.80	22.55	20.82	23.77	24.41
Amoniaku, mg/L NH ₄ ⁺	0.040	0.030	0.040	0.040	0.020	0.040	0.020	0.020	0.030	0.030	0.050	0.040
Nitritet, mg/L NO ₂ ⁻	0.010	0.009	0.010	0.007	0.003	0.006	0.004	0.006	0.010	0.010	0.007	0.012
Nitratet, mg/L NO ₃ ⁻	0.98	0.95	0.90	0.84	0.83	0.85	0.79	0.83	0.80	0.74	0.78	0.84
Fosfatet, µg/L P ₂ O ₅	54.10	53.00	52.70	47.50	38.40	38.30	35.80	37.80	44.40	55.70	77.50	64.30
Klori i lirë, mg/L												

10. Emiri & Hoxha: Mbi përpunimin e ujit të Bovillës – vështrim i përgjithshëm

Parametrat / Muajt	I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII
Alumini, mg/L Al ³⁺	0.019	0.020	0.019	0.019	0.018	0.018	0.018	0.018	0.020	0.020	0.020	0.020
Hekuri, µg/L Fe ³⁺	161.00	132.00	87.20	74.90	36.80	99.50	27.00	23.40	76.30	89.90	393.10	331.70
Koliformet totale, koloni/100ml	15.00	12.00	11.00	8.00	5.00	6.00	2.00	4.00	6.00	9.00	63.00	23.00
Streptokoket fekale, koloni/100ml	17.00	18.00	21.00	16.00	12.00	12.00	4.00	5.00	22.00	33.00	159.00	75.00
Koliformet fekale, koloni/100ml	12.00	9.00	6.00	5.00	2.00	4.00	1.00	1.00	4.00	8.00	49.00	15.00
Mikroflora e përgjithshme (36°C), koloni/ml	20.00	22.00	17.00	15.00	7.00	7.00	3.00	3.00	9.00	11.00	14.00	7.00
Mikroflora e përgjithshme (22°C), koloni/ml	23.00	29.00	22.00	20.00	12.00	12.00	3.00	6.00	13.00	16.00	18.00	10.00
Klostridium, koloni/20 ml	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
2008 – Para trajtimit												
Temperatura ajërit, °C	6.71	5.07	8.80	12.00	17.55	24.53	23.90	24.23	18.63	14.58	13.33	7.77
Temperatura ujit, °C	8.58	8.00	8.40	9.39	10.73	12.20	13.62	14.18	13.96	13.96	13.61	11.44
Përqëndrimi i joneve H ⁺ , pH	8.26	8.25	8.26	8.22	8.16	8.07	8.07	8.00	7.90	7.88	7.84	8.18
Turbullia, NTU	7.55	3.34	3.61	2.36	2.03	5.03	1.58	1.82	1.75	2.85	5.01	15.45
Kalciumi, mg/L Ca	38.20	38.60	39.20	39.20	39.30	39.00	38.30	38.10	38.20	38.20	38.40	38.30
Fortësia e përgjithshme, °Gjermane	7.82	7.84	7.92	7.91	7.97	8.24	7.95	7.99	8.03	8.04	7.98	8.01
Alkaliniteti, mg/L CaCO ₃	145.00	145.00	148.00	149.00	148.00	150.00	147.00	148.00	148.00	149.00	146.00	144.00
Hidrogjensulfuret, µg/L	11.20	10.72	10.74	11.69	10.29	15.36	10.59	12.15	11.26	12.58	12.57	13.76
Oksigjeni i tretur, mg/L O ₂	8.13	8.69	9.85	11.19	9.66	10.20	8.94	8.67	8.96	9.68	9.23	8.65
Lëndë organike (KMnO ₄ , mg/L)	1.08	1.07	1.06	1.11	1.02	1.12	1.00	1.07	1.14	1.21	1.30	1.74
Kloruret, mg/L Cl ⁻	6.38	6.30	6.50	6.60	6.30	6.70	6.10	6.00	6.10	6.40	6.40	6.60
Sulfatet, mg/L SO ₄ ²⁻	24.60	24.30	24.70	25.40	26.40	27.30	25.20	25.10	25.30	25.70	25.90	25.80
Amoniaku, mg/L NH ₄ ⁺	0.040	0.030	0.030	0.030	0.020	0.050	0.030	0.030	0.030	0.030	0.030	0.040
Nitritet, mg/L NO ₂ ⁻	0.010	0.008	0.007	0.005	0.004	0.011	0.007	0.008	0.009	0.009	0.007	0.016

Parametrat / Muajt	I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII
Nitratet, mg/L NO ₃ ⁻	0.88	0.90	0.90	0.89	0.91	0.97	0.95	1.02	1.05	1.03	0.96	0.99
Fosfatet, µg/L P ₂ O ₅	56.88	55.64	58.37	56.41	61.88	70.74	51.52	49.85	52.06	60.30	58.04	67.14
Klori i lirë, mg/L												
Alumini, mg/L Al ³⁺	0.018	0.018	0.018	0.018	0.019	0.019	0.017	0.017	0.018	0.019	0.019	0.020
Hekuri, µg/L Fe ³⁺	247.41	116.08	122.80	127.43	51.29	397.50	56.59	52.70	73.30	91.00	82.90	152.50
Koliformet totale, koloni/100ml	18.00	19.00	22.00	24.00	21.00	34.00	21.00	16.00	12.00	25.00	26.00	39.00
Streptokoket fekale, koloni/100ml	78.00	66.00	34.00	26.00	20.00	53.00	22.00	18.00	18.00	34.00	37.00	23.00
Koliformet fekale, koloni/100ml	10.00	8.00	6.00	6.00	7.00	24.00	7.00	8.00	6.00	17.00	9.00	30.00
Mikroflora e përgjithshme (36°C), koloni/ml	5.00	5.00	6.00	5.00	6.00	13.00	7.00	9.00	6.00	7.00	6.00	7.00
Mikroflora e përgjithshme (22°C), koloni/ml	10.00	9.00	10.00	10.00	11.00	20.00	12.00	14.00	11.00	11.00	11.00	11.00
Klostridium, koloni/20 ml	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	1.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00

Tabela X-2. Të dhëna mesatare mujore (2006-2008) për ujin e trajtuar të Bovillës. / Monthly average values (years 2006 – 2008) of Bovilla water.

Parametrat / muajt	I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII
2006 – Pas trajtimit												
Temperatura ajrit, °C	4.64	6.50	9.40	12.90	18.50	21.90	25.40	22.80	20.70	16.90	11.00	7.70
Temperatura ujit, °C	7.94	6.80	7.90	9.20	9.90	10.80	11.80	12.29	12.30	12.40	12.40	10.90
Përqëndrimi i joneve H ⁺ , pH	7.78	7.85	7.85	7.84	7.79	7.83	7.76	7.78	7.76	7.82	7.85	7.83
Turbullia, NTU	0.27	0.28	0.14	0.15	0.19	0.22	0.20	0.19	0.17	0.17	0.23	0.20
Kalciumi, mg/L Ca	38.10	38.00	38.40	38.00	37.60	37.78	37.60	37.80	37.90	37.90	38.17	38.00
Fortësia e përgjithshme, °Gjermane	7.74	7.71	7.96	7.86	7.77	7.80	7.77	7.79	7.73	7.73	7.74	7.57
Alkaliniteti, mg/L CaCO ₃	131.20	129.00	130.00	130.00	129.40	127.50	128.00	128.80	130.00	133.00	140.00	139.10

10. Emiri & Hoxha: Mbi përpunimin e ujit të Bovillës – vështrim i përgjithshëm

Parmetrat / muajt	I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII
Hidrogjensulfuret, µg/L	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
Lëndë organike (KMnO ₄ , mg/L)	0.68	0.62	0.60	0.60	0.61	0.62	0.59	0.59	0.57	0.53	0.55	0.52
Kloruret, mg/L Cl ⁻	13.48	13.94	14.00	13.69	13.37	13.31	13.54	13.49	13.18	12.50	12.67	13.06
Sulfatet, mg/L SO ₄ ²⁻	23.70	23.80	23.70	23.00	22.30	21.50	20.90	20.70	20.80	20.10	21.40	22.93
Amoniaku, mg/L NH ₄ ⁺	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000
Nitritet, mg/L NO ₂ ⁻	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000
Nitratet, mg/L NO ₃ ⁻	1.23	1.13	1.20	1.20	1.10	1.00	1.07	1.07	1.05	1.03	1.03	0.97
Fosfatet, µg/L P ₂ O ₅	23.00	18.75	20.79	20.50	15.90	15.23	20.18	20.18	24.12	27.12	24.12	22.82
Klori i lirë, mg/L	0.74	0.78	0.77	0.81	0.86	0.87	1.24	1.52	1.43	1.22	1.02	0.96
Alumini, mg/L Al ³⁺	0.042	0.039	0.039	0.040	0.040	0.050	0.050	0.050	0.050	0.053	0.050	0.050
Hekuri, µg/L Fe ³⁺	0.00	0.00	1.36	0.00	0.00	0.00	0.00	0.68	0.00	0.00	0.00	0.00
Koliformet totale, koloni/100ml	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
Streptokoket fekale, koloni/100ml	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
Koliformet fekale, koloni/100ml	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
Mikroflora e përgjithshme (36°C), koloni/ml	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	1.00	1.00	1.00	1.00	1.00	14.00
Mikroflora e përgjithshme (22°C), koloni/ml	1.00	1.00	1.00	0.00	0.00	1.00	1.00	2.00	1.00	1.00	1.00	1.00
Klostridium, koloni/20 ml	0.00	0.00	0.00	-	-	-	-	-	-	0.00	0.00	0.00
2007 - Pas trajtimit												
Temperatura ajrit, °C	6.45	5.80	10.60	12.80	17.90	22.93	25.40	23.70	18.23	15.30	10.10	6.65
Temperatura ujit, °C	8.94	8.46	8.90	9.65	10.50	11.28	12.19	12.90	13.22	14.14	12.97	10.40
Përqëndrimi i joneve H ⁺ , pH	7.84	7.85	7.84	7.85	7.92	7.85	7.83	7.83	7.75	7.86	7.85	7.87
Turbullia, NTU	0.22	0.21	0.20	0.21	0.15	0.12	0.10	0.08	0.11	0.12	0.21	0.19
Kalciumi, mg/L Ca	38.05	37.90	37.65	37.99	38.06	37.95	36.28	37.11	38.95	38.66	38.64	38.46

Parmetrat / muajt	I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII
Fortësia e përgjithshme, °Gjermane	7.67	7.69	7.74	7.76	7.72	7.75	7.75	7.79	7.94	7.79	7.82	7.78
Alkaliniteti, mg/L CaCO ₃	140.00	140.00	140.00	144.30	147.60	146.60	146.80	144.00	148.70	150.60	146.10	143.50
Hidrogjensulfuret, µg/L	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
Oksigjeni i tretur, mg/L O ₂	11.60	11.20	11.60	11.80	11.10	10.60	10.10	10.20	10.10	10.00	9.80	9.60
Lëndë organike (KMnO ₄ , mg/L)	0.56	0.53	0.54	0.55	0.54	0.55	0.55	0.55	0.55	0.53	0.63	0.65
Kloruret, mg/L Cl ⁻	13.10	13.20	13.20	13.20	13.60	13.40	13.10	13.00	13.20	12.90	13.40	13.40
Sulfatet, mg/L SO ₄ ²⁻	23.70	23.40	23.80	23.60	21.80	22.90	21.00	23.70	22.90	21.40	24.50	24.70
Amoniaku, mg/L NH ₄ ⁺	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000
Nitritet, mg/L NO ₂ ⁻	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000
Nitratet, mg/L NO ₃ ⁻	1.01	1.02	0.97	0.92	0.91	0.94	0.90	0.87	0.87	0.81	0.82	0.87
Fosfatet, µg/L P ₂ O ₅	23.70	23.50	23.40	18.40	16.80	13.80	15.70	17.20	18.80	21.10	27.70	28.40
Klori i lirë, mg/L	0.90	0.91	0.87	0.84	0.91	0.87	0.85	0.87	0.86	0.96	0.89	0.90
Alumini, mg/L Al ³⁺	0.044	0.045	0.042	0.047	0.045	0.047	0.050	0.046	0.046	0.047	0.046	0.046
Hekuri, µg/L Fe ³⁺	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.90	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
Koliformet totale, koloni/100ml	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
Streptokoket fekale, koloni/100ml	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
Koliformet fekale, koloni/100ml	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
Mikroflora e përgjithshme (36°C), koloni/ml	1.00	1.00	0.00	1.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
Mikroflora e përgjithshme (22°C), koloni/ml	1.00	1.00	1.00	0.00	0.00	1.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
Klostridium, koloni/20 ml	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
2008 - Pas trajtimit												
Temperatura ajrit, °C	6.70	5.07	8.80	12.10	17.50	24.53	23.90	24.23	18.63	14.58	13.33	7.77
Temperatura ujit, °C	8.60	8.06	8.40	9.27	10.20	11.71	13.10	13.52	13.78	13.96	13.65	11.53

10. Emiri & Hoxha: Mbi përpunimin e ujit të Bovillës – vështrim i përgjithshëm

Parmetrat / muajt	I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII
Përqëndrimi i joneve H ⁺ , pH	7.86	7.86	7.88	7.85	7.86	7.84	7.85	7.82	7.78	7.81	7.77	7.87
Turbullia, NTU	0.12	0.18	0.18	0.18	0.19	0.15	0.20	0.15	0.11	0.12	0.20	0.21
Kalciumi, mg/L Ca	38.20	38.60	39.20	39.20	39.30	38.80	38.30	38.10	38.20	38.20	38.40	38.30
Fortësia e përgjithshme, °Gjermane	7.82	7.84	7.92	7.91	7.97	8.24	7.95	7.99	8.03	8.04	7.98	8.01
Alkaliniteti, mg/L CaCO ₃	145.00	145.00	148.00	149.00	148.00	150.00	147.00	148.00	148.00	149.00	146.00	144.00
Hidrogjensulfuret, µg/L	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
Oksigjeni i tretur, mg/L O ₂	9.54	10.37	10.92	11.74	10.82	10.69	10.10	10.28	10.53	10.53	10.33	10.36
Lëndë organike (KMnO ₄ , mg/L)	0.61	0.58	0.57	0.56	0.55	0.58	0.57	0.64	0.71	0.63	0.62	0.84
Kloruret, mg/L Cl ⁻	13.24	13.30	13.50	13.48	13.25	13.11	13.37	13.25	13.37	13.04	13.94	13.42
Sulfatet, mg/L SO ₄ ²⁻	24.71	24.50	24.81	25.51	26.54	26.33	25.22	25.21	25.42	25.70	25.32	25.36
Amoniaku, mg/L NH ₄ ⁺	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000
Nitritet, mg/L NO ₂ ⁻	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000
Nitratet, mg/L NO ₃ ⁻	0.91	0.93	0.93	0.92	0.94	0.96	0.98	1.05	1.10	1.06	0.99	1.03
Fosfatet, µg/L P ₂ O ₅	24.05	21.20	19.83	17.41	20.97	20.95	15.54	15.10	18.86	21.50	19.86	25.27
Klori i lirë, mg/L	0.93	0.94	0.93	0.87	0.96	0.89	0.97	1.03	1.08	1.00	0.95	1.01
Alumini, mg/L Al ³⁺	0.044	0.043	0.045	0.047	0.047	0.047	0.044	0.045	0.046	0.044	0.045	0.046
Hekuri, µg/L Fe ³⁺	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
Koliformet totale, koloni/100ml	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
Streptokoket fekale, koloni/100ml	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
Koliformet fekale, koloni/100ml	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
Mikroflora e përgjithshme (36°C), koloni/ml	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
Mikroflora e përgjithshme (22°C), koloni/ml	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
Klostridium, koloni/20 ml	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00

11

SURFACE WATER TREATMENT IN ZURICH (SWITZERLAND)

PËRPUNIMI I UJËRAVE SIPËRFAQËSORE NË ZYRI (ZVICËR)*

H. P. Kaiser**

Përmbledhje

Ujësjellësi i Zyriut (WSZ) siguron ujë të pijshëm për rreth 800'000 banorë të qytetit të Zyriut dhe 67 bashkive në zonën e Zyriut. 70% e ujit të pijshëm të Zyriut merret nga uji i liqenit i përpunuar. Këtu është zbatuar parimi i pengesave të shumfishta për të furnizuar me ujë të pijshëm, të sigurt, në çdo kohë. Mbrojtja e mirë e vendburimeve të pellgut ujëmbledhës përbën masën e parë; dy ozonime dhe tre filtrime të mëtejshme janë masat e mëtejshme për mbrojtjen e cilësisë së ujit të pijshëm. Masat e kontrollit mbështeten në konceptin HACCP (*Hazard Analysis and Critical Control Points* / Analiza e Lëndëve të Dëmshme dhe Kontrolli i Pikave Kritike). Mbështetur në analizën e lëndëve të dëmshme në cilësinë e ujit të liqenit ndiqet aftësia e largimit të këtyre lëndëve gjatë hapave përpunues. Ndjekja e dy hapave të ozonimit mbështetet në një kod kompiuterik të bashkërenduar me një reaktor hidraulik me reaksion kimik dhe kinetikë disinfectuese, që llogarisin çaktivizimin e mikroorganizmave dhe shpërbërjen e ndotësve kimikë. Për t'u siguruar në veprimin e dëshiruar përpunues, në çdo kohë bëhet kontrolli gjatë pikave kritike. Për parametra kritike janë vendosur kufij të përshtatshëm. Kur një nga parametrat është jashtë kufirit, një seri e paracaktuar veprimesh korrektuese siguron që procesi kontrollues të jetë nën kontroll në çdo kohë.

Abstract

Water Supply Zurich (WSZ) supplies drinking water to about 800'000 inhabitants in the City of Zurich and in 67 communities in the Zurich area. 70 % of Zurich's drinking water is treated lake water. The multiple barrier principle is applied to ensure safe drinking water at any time. Effective resource protection of the catchment area provides the first barrier, two ozonations and three filtrations further barriers for protection of drinking water quality. Control measures are based on the HACCP-concept (Hazard Analysis and Critical Control Points). Based on hazard analysis for lake water quality the effectiveness for eliminating those hazards in the treatment steps was validated. The validation of the two ozonations steps was based on a computer code combining reactor hydraulics with chemical reaction and disinfection kinetics to calculate the inactivation of microorganism and the degradation of chemical contaminants. To assure the desired effect of the treatment at any time critical control points were defined. Appropriate limits for critical parameters are set. When a critical parameter is out of limit, a predefined catalogue of corrective actions assures the treatment process is under control at any time.

Keywords: Degradation, HACCP, Inactivation, Microorganisms, Micropollutants, Lake Zurich, Surface Water Treatment, Zurich-Lengg, Zurich Water Supply

* Translation parts in Albanian language by prof. A. Miho, Tirana University

** Water Supply Zurich, Hardhof 9, CH-8023 Zürich, Switzerland,
e-mail: hans-peter.kaiser@zuerich.ch

11.1. Introduction

12. Mersinllari et al.: Bimësia dhe përdorimi i tokës në pellgun e Bovillës

Tabela 12-1. Të dhëna meteorologjike: reshjet, mm; temperatura (°C) mesatare (*aver*), minimale (*min*) dhe maksimale (*max*), nga stacioni termometrik i fshatit të Dajtit (Tiranë) *wl*, m a.s.l., vlera mesatare e nivelit të ujit të liqenit në metra mbi nivelin e detit. / Meteorological data: rain, mm; temperature (average, minimal and maximal) (°C), taken from the thermometric place in Dajti village (Tirana), which is the nearest station to Bovilla watershed; *wl*, m a.s.l., mean value in meters of lake water level (meters above sea level) (Murtaj, 2007; Murtaj & Çullaj, 2008).

2006	I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII	Annual
Rain/Reshje, mm	166	394.2	272.3	169.4	55.7	113.8	51.3	70.3	105.4	62.0	399	167.5	2026.9
<i>t</i> _{aver/mes} , °C.	3.7	6.0	6.4	11.7	15.9	18.0	22.5	20.5	19.0	14.7	8.9	7.3	12.88
<i>t</i> _{max} , °C.	7.3	9.5	10.4	16.6	22.3	23.8	28.7	26.6	25.6	20.5	14.8	12.2	18.19
<i>t</i> _{min} , °C.	0.1	2.5	2.5	6.7	9.6	12.2	16.2	14.4	12.4	8.8	3	2.4	7.57
<i>wl</i> , m a.s.l.	317.03	317.89	318.36	318.06	318.09	318.05	317.22	316.15	315.06	313.93	313.16	313.09	317.03
2007													
Rain/Reshje, mm	243.1	200.9	20	29.9	333.7	88.7	0	0	105.7	74.5	408.2	236.8	1741.5
<i>t</i> _{aver/mes} , °C.	6.1	6.6	9	12.9	16.2	20.4	24.5	23.5	17.3	13.4	7.9	4.4	13.52
<i>t</i> _{max} , °C.	11	11.1	14	19.5	22	26.6	32.3	30.6	23.8	18.8	12.7	8.8	19.27
<i>t</i> _{min} , °C.	1.3	2.1	4	6.2	10.3	14.2	16.8	16.3	10.8	7.9	3.2	0	7.76
<i>wl</i> , m a.s.l.	313.83	315.33	316.45	317.66	317.18	316.57	315.27	313.67	312.34	310.96	311.51	314.29	313.83
2008													
Rain/Reshje, mm	307.1	125.7	169.0	58.4	28.4	44.4	12	0	47.5	70.5	92.2	199.1	1154.3
<i>t</i> _{aver/mes} , °C.	5.3	5.4	8.0	10.5	15.5	18.8	21.7	22.8	16.5	14.4	10.5	5.8	12.93
<i>t</i> _{max} , °C.	9.9	10.6	13.0	16.0	21.8	25	28.4	30.2	22.8	20.3	16	10.3	18.69
<i>t</i> _{min} , °C.	0.6	0.3	3.0	5.1	9.1	12.7	15	15.4	10.2	8.5	5	1.2	7.18
<i>wl</i> , m a.s.l.	316.19	316.54	316.84	318.20	317.88	317.94	317.40	316.03	314.7	314.03	312.9	316.4	

Territori përshkohet dhe nga një rrjet i dendur hidrografik, kryesisht përrëska dhe përrrenj, degë të lumit Tërkuzë (Fig. 12-1), burime të vogla dhe disa ujëmbledhës. Përrrenjtë më kryesorë janë ai i Zall Bastarit dhe i Bruzit, të cilët bëjnë dhe transportin kryesor të materialeve inerte për në pjesët e ulëta. Në figurën 12-4 jepet ecuria e mesatares shumëvjeçare (1975-1992) të prurjes ujore të lumit të Tërkuzës matur në stacionin e Zall Herit, i cili përfaqëson gjithë sasinë e ujërave që mbliidhet nga gjithë pellgu ujëmbledhës i Bovillës. Pas vitit 1998, me përfundimin e digës dhe shfrytëzimin për ujë të pijshëm një pjesë e madhe e kësaj sasive (1.2 – 1.8 m³/s) shkon në Impiantin e Trajtimit të Ujit të Bovillës (Kodra e Kuqe, Tiranë) (*shih* Tab. 10-3, Emiri et al., Nr. 10 në këtë vëllim).

Nisur nga fakti që prej vitit 2006, gjithë hapësira e pellgut ujëmbledhës të Bovillës është përfshirë në Parkun Kombëtar të Dajtit (të zgjeruar) (Fig. 12-6) e vlen të nisin përshkrimin tonë mbi florën dhe bimësinë e pellgut, si dhe mbi aktivitetin dhe ndikimin e njeriut në këtë zonë, duke folur më parë përmbledhtas se çfarë përfaqëson kjo zonë e mbrojtur dhe zonat e tjera të mbrojtura përreth (VKM 402, 2006; VKM 49, 2007).





Figura 12-5. Struktura e përbërjes së bimësisë brenda hapësirës së PK të Dajtit (të zgjeruar) në hektarë. / Composition of vegetation in hectares of Dajti NP (extended) (VKM 402, 2006).

12.4. Parku Kombëtar i Dajtit (i zgjeruar)

Prej vitit 2006, me VKM nr. 402, dt. 21.06.2006, Parku Kombëtar egzistues i Dajtit zgjerohet nga rreth 102.7 km² (Anonymous, 1996?) në 293.8 km², duke përfshirë këtu dhe gjithë pellgun ujëmbledhës të Bovillës (Fig. 12-6). Në figurën 12-5 jepet struktura e përbërjes së hapësirës së PK të Dajtit (të zgjeruar) në hektarë, në figurën 12-6 harta përkatëse e zonave, bashkëngjitur me vendimin në fjalë, kurse në figurën 12-7 përbërja e zonave të mbrojtjes.



◀ **Figura 12-6.** Harta e zonimit e Parkut Kombëtar të Zgjeruar të Dajtit; ZQ1, zonë qendrore në ruajtje të veçantë; ZQ2, zonë qendrore mjedisore natyrore; ZR1, zonë rekreative aktive; ZR2, zonë rekreative natyrore; ZPQ, zonë e përdorimit të qëndrueshëm; ZPT, zonë e përdorimit tradicional; ZU, zonë ushtarake. / Zone map of Dajti National Park (extended); ZQ2, natural environmental zone; ZR1, active recreational zone; ZR2, natural recreational zone; ZPQ, sustainable use zone; ZPT, traditional use zone; ZU, military zone (sipas VKM 402, 2006).




Figura 12-7. Përbërja e zonave të mbrojtjes së PK të Dajtit (të zgjeruar) në hektarë. / Different zones in hectares of Dajti NP (extended) (sipas VKM 402, 2006).

PK i Dajtit (i zgjeruar) shtrihet: **a) në Veri** - kufiri administrativ, ndërmjet rrethëve të Krujës dhe Tiranës, nga maja e Fraveshit (794 m), vijon me kuotat 1'090 m, 1'227 m (mj. Zithit) deri tek kuota 1'627 m; **b) në Lindje** - kuota 1'627 m, ndjek kurrizin e vargmalit Xibër-Mali me Gropa, me kuotat 1'473 m (mj. Rjepës), 1'388, 1'295, 1'613 m (mj. Popatit), 1'455 m (mj. Strevecit), 1'594, 1'700, 1'827 m (mj. M. Shemërisë), 1'712, 1'498 m, deri tek ndërprerja me rrugën automobilistike Tiranë-Bizë, në afërsi të fshatit Burimas dhe rrjedhjen e Erzenit (Fig. 12-6).

c) Në Jug kufizohet nga rrjedhja e Erzenit, rezervuari i Skoranës deri tek Gryka e Skoranës; **d) në Perëndim** - Gryka e Skoranës, dhe vijon me kuotat 890 m (mj. Kurorës), pranë fshatit Përcëllesh, në Priskën e Madhe, vazhdon me rrugën automobilistike Priskë-Surrel, ndjek rrugën Surrel-Tiranë, deri në afërsi të komunës së Dajtit, më pas në kuotat 573 m (mj. Qytezës), 445 m (mj. Shpatës), në afërsi të fshatit Brar dhe Priskë e Vogël, ndërpret lumin e Tërkuzës, kuotat 1268 m (mj. Gamtit) deri tek kuota 794 m (mj. Fraveshit).

Në këtë mënyrë, hapësira e PK të Dajtit (të zgjeruar), në ndryshim nga struktura e mëparshme, relativisht më homogjene (*Anonymous*, 1996?), tani bëhet më e ndërlukuar dhe më e larmishme (Fig. 12-7), ku përfshihen pyje e

shkurre, kullota, livadhe, sipërfaqe bujqësore, pemishte, ullishta e vreshta, sipërfaqe joproduhuese, shkëmbore, gurishtore të zhveshura, miniera, sipërfaqe të banuara, troje të përzier me tokë bujqësore, si dhe sipërfaqe ujore, ku mbizotëron ujëmbledhësi i Bovillës (Fig. 12-6).

PK ndahet në zona ruajtje dhe administrimi, si në hartën e figurës 6, vlerat numerike të të cilave dhe përqindjet përkatëse jepen në tortën e figurës 12-7. **Zona qendrore** përfaqëson territor të pashqetësuar (kategoria II e mbrojtjes), ku bëjnë pjesë habitate me ruajtje të veçantë (ZQ1), me mjedise natyrore (ZQ2) dhe me monumente natyrore (ZQ3); këtu përfshihen habitate me vlera natyrore dhe biodiversitet të lartë nga malet e Dajtit, Priskës, Brarit dhe Fekenit.

Zona çlodhëse (rekreative; IV) përfshin hapësira aktive (ZR1) dhe natyrore (ZR2), që ofrojnë mundësi çlodhëse në natyrë të hapur, por duke respektuar gjithmonë funksionet e parkut, vlerat ekologjike, të peizazhit natyror dhe vlerat turistike e kulturore. **Zona e përdorimit tradicional** (ZPT) është më e shtrira (mbi 58%; Fig. 12-7); në këto hapësira vazhdon aktiviteti tradicional i njeriut, por në përputhje me kategorinë IV të mbrojtjes së natyrës dhe biodiversitetit. Në **zonën e përdorimit të qëndrueshëm** (ZPQ; V) lejohen veprimtaritë ekonomike ekzistuese, si dhe mund të hapen veprimtari të reja, vetëm pasi të pajisen me lejet mjedisore përkatëse.

Vendimi i Qeverisë ngarkon Ministrinë e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, Ministrinë e Turizmit, Rinisë dhe Sporteve, në bashkëpunim me njësitë e qeverisjes vendore, me institucionet kërkimore-shkencore dhe me përfaqësuesit e biznesit dhe të pronarëve privatë, të marrin masa për të siguruar zbatimin e planit të menaxhimit të Parkut, si dhe të rishikojnë lejet që kanë dhënë për veprimtari, ekonomike e shoqërore, brenda sipërfaqes së PK.

PK i Dajtit (i zgjeruar) dallohet për vlera të larta të biodiversitetit (florë, bimësi dhe faunë), për veçoritë natyrore dhe të peizazhit. Këtu dallohen disa monumente natyrore (Qiriazit & Sala, 2006), si **Tarraca e vjetër detare** në malin e Dajtit, e formuar nga valët e detit Helvecian (16-11 milionë vjet më parë), **Shkalla e Tujanit** në luginën e lumit të Tiranës, kanion 1.2 km të gjatë, 20-50 m të gjerë dhe 200-300 m të thellë, me **guva** dhe **shpella karstike**, si Shpella e Zezë (Shpella e Pëllumbasit) në grykën e Skoranës, Shpella e Shutresë, Gryka e Skoranës (lumi Erzen), Gryka e Murdhrit (Kërrabë) etj. Përgjatë shkallës së Tujanit kalonte dikur rruga Tiranë-Dibër e Madhe (Fig. 12-8d); e ngjashme me Shkallën e Tujanit është edhe **gryka e Zall-Herrit** ose e Bovillës (Fig. 12-8a) mbi lumin e Tërkuçës, ku është ndërtuar diga e Ujëmbledhësit përkatës.

Zona e Zall Dajtit dhe e Malit me Gropa është e njohur për ujërat natyrore oligominerale, të varfra me kripëra të kalciumit dhe magnezit (Tab. 12-2), me veti të mira kuruese. Dy prej këtyre burimeve, Selita dhe Shemëria, prej vitit 1951 kanë qenë furnizuesi kryesor i qytetit të Tiranës me ujë të pijshëm; secili

burim ka një prurje që luhetet nga 300-700 L/s (*shih* Tab. 10-2, Emiri et al., Nr. 10 në këtë vëllim). Përmes malit të Dajtit kalon një tunel, i ndërtuar në vitin 1951, që sjell ujërat e këtyre burimeve në Tiranë, duke vënë në punë njëkohësisht edhe një hidrocentral të ndërtuar posaçërisht në rrëzë të malit të Dajtit. Një pjesë e këtyre ujërave ambalazhohen sot edhe në shishe (Tab. 12-2).

Tabela 12-2. Të dhëna mbi cilësinë e ujërave të burimeve Selitë-Shemëri dhe Kroj i Nënës Mbretëreshë (Qafështamë)*. / Data on water quality of the springs Selita-Shemëri and Mother Queen Fountain (Qafështama).

Të dhëna fiziko-kimike	Selitë - Shemëri	Qafështamë	Lëndë të tretura në mg/L (20°C)	Selitë - Shemëri	Qafështamë
Temperatura e ujit, °C	11	8.5	Kalcium, Ca ²⁺	40.6	1.6
Përcjellshmëria elektrike specifike (20°C), µS/cm	107	164	Magnezi, Mg ²⁺	2.28	23.3
pH	7.81	7.2	Natriumi, Na ⁺	3.71	1.3
Mbetja e thatë, mg/L (180°C)	128	99	Kaliumi, K ⁺	1.16	-
Fortësia, °Gjermane	-	5.59	Cl ⁻	-	7.1
Lënda organike (sipas Kubel), mg/L	0.39	-	Bikarbonat, HCO ₃ ⁻	142.2	129.62
Kripëra amoni, nitrite, nitrate, klorure të lira	s'ka	-	Arsenik, Plumb, Bakër, H ₂ S	s'ka	-

12.5. Zona të mbrojtura rrethuese

Parku Kombëtar i Qafështamës (rrethi i Krujës): Zona e mbrojtur ka sipërfaqe prej rreth 20 km², e shpallur si e tillë prej vitit 1966. Ajo gjendet rreth 25 km në verilindje të qytetit të Krujës, duke kaluar nëpërmjet komunës së Cullit. Qafa (1'230 m) shërben si urë lidhëse midis zonës së Krujës dhe luginës së Matit në veri. Zona kufizohet me pellgun e Bovillës nga jugu i saj, dhe është ekologjikisht e lidhur ngushtë me të. Gjithë zona dallohet për vlerat natyrore dhe pyjet e virgjër.

Gjithashtu, burimet e saj janë të njohura për vlerat kuruese, ku dallohet Kroj i 'Nënës Mbretëreshë', pranë Qafështamës, rreth 1'100 m mbi nivelin e detit, midis pyllit të pishës së Parkut Kombëtar. Emrin e ka marrë në vitet 1930-të sepse këtu merrte ujin e pijshëm familja mbretërore; një kamion bënte çdo ditë

* Të dhënat janë marrë përkatësisht nga etiketat e ujit Kristal (Selitë-Shëmëri; analiza nr. 78/1, dt. 15.05.1998) dhe Qafështama (analiza nr. 378, dt. 23.06.2006), të dyja analizat janë prej Institutit të Kërkimeve të Ushqimit, Tiranë.

rrugën Tiranë-Qafështamë. Uji i burimeve të Qafështamës vlerësohet si i lehtë, i varfër në kripëra, por i pasur me magnez (Tab. 12-2). Kroi bën pjesë në listën e monumenteve të natyrës shqiptare (hidomonumenteve) (Qiriazzi & Sala, 2006). Aty sot është ngritur një qendër kuruese për sëmundjet e mushkërive dhe një impiant për ambalazhimin e ujit të pijshëm.

Edhe pse rruga për të shkuar është shumë e vështirë, dhe kërkon mjet të fortë, kjo zonë tërheq shumë vizitorë. Qeveria shqiptare synon që të zgjerojë këtë zonë të mbrojtur në të ardhmen e afërt, duke përfshirë në të edhe malin e Skënderbeut (1'724 m).

Peizazhi i Mbrojtur Mali me Gropa-Bizë-Martanesh: Është ndër zonat më të reja të shpallura në mbrojtje nga Qeveria Shqiptare (VKM 49, 2007). Kjo zonë kufizohet ngushtë me Parkun Kombëtar të Dajtit (të zgjeruar), nga veriperëndimi i saj, dhe është, gjithashtu, ekologjikisht e lidhur ngushtë edhe me pellgun e Bovillës dhe Parkun Kombëtar të Qafështamës, që ndodhen më në veriperëndim, duke qenë vazhdim natyror i njëri-tjetrit.

Kufijtë e peizazhit të mbrojtur shtrihen: nga **veriu** kufiri kalon nga Qafa e Murrizës, vijon me rrugën automobilistike për tek Guri i Bardhë, Kroi i Ftohtë (1'198 m), Qafa e Qershisë, maja e Zabelit të Madh, tek Ura e Thanës, ndjek rrugën automobilistike Guri i Bardhë-Tiranë, përroin dhe grykën e Shehut, vazhdon përgjatë lumit të Matit, deri tek bashkimi me përroin e Lenës, vazhdon përgjatë këtij përroi dhe atij të Lajthisë, deri tek kryqëzimi i rrugëve për këmbësorë (kuota 1'870.6 m); nga **lindja** kalon nga kryqëzimi i rrugëve për këmbësorë tek Qafa e Drerit, livadhet e Kolgrekut, vijon drejt qafës së Prevallit, tek Ujëvara e Zallit të Vardarit, fushat e Palemit, Rrahi i Hasramës, Maja e Sadokut, shpati i Skorës, ndjek Rrugën e Rinisë, deri tek Guri i Muzhaqit (1'661.7 m).

Nga **jugu** kufiri kalon nga Guri i Muzhaqit, ndjek rrugën për këmbësorë, kurrizin ujëndarës deri në majën e Sukës (1'542 m), kalon në Qafën e Rinasit (1'538 m), në majën e Kësulës (1'622 m), ndjek rrugën automobilistike për në Kollogjesh (1'422 m), në qafën e Shpellzës (1'213 m), Malin e Kol Gjergjit, qafën e Shëngjinit (1'187 m), deri te maja e Fagut (1'443.8 m); nga **perëndimi**: nga Maja e Fagut ndjek Përroin e Vavilës, pranë Shëngjinit të Madh, deri tek ndërprerja me lumin e Erzenit, në afërsi të fshatit Burimas, dhe më pas ndjek kufirin e PK të Dajtit deri në Qafën e Murrizës.

Peizazhi i Mbrojtur i Malit me Gropa-Bizë-Martanesh ka sipërfaqe prej rreth 252.7 km², ku përfshihen 182.9 km² pyje, ripyllëzime, pyje të rrallë ose tokë me bimësi pyjore, 14.5 km² sipërfaqe bujqësore dhe pemëtore, rreth 54.7 km² kullota, livadhe me bimësi të rrallë dhe 0.4 km² troje urbane, e përzier me tokë bujqësore, pemishte e pyje. Zona e mbrojtur është e ndarë nga një sistem zonimi për ruajtjen dhe administrimin: **Zona qendrore** (137.53 km²) përfshin habitatet pyjore natyrore të Brozh-Bardhetit, Snoit të Madh e të Vogël, Bizës,

Ballenjës, Martaneshit, Panjetit dhe pjesë të pyjeve të Kostenjës; këto konsiderohen me vlera të larta natyrore dhe biologjike (kategoria IV e mbrojtjes) dhe ruhen të pashqetësuara dhe në përputhje me kriteret e administrimit të zonave të mbrojtura në nivel kombëtar.

Në **zonën e përdorimit të qëndrueshëm** (rreth 30 km²) lejohen veprimtaritë ekonomike, si dhe mund të ushtrohen veprimtari të reja, vetëm pasi të pajisen me lejet përkatëse (IV). Këtu përfshihen pyjet e Fagut, ato rreth Shëngjinit të Madh, të Vërrisë, të Linosit dhe të Peshk-Lenës. Në **zonën e përdorimit tradicional** (rreth 76.9 km²) mundësohet vazhdimi i veprimtarive tradicionale dhe ekonomike (V); këtu përfshihen territoret bujqësore, pyjore e kullimore, si dhe ato rreth qendrave të banuara, të Malit me Gropa, Bizës dhe pjesë të Martaneshit. **Zona rekreative** (çlodhëse) (8.3 km²) përfshin zonën me mundësi çlodhëse në natyrë të hapur, në përputhje me funksionet e zonës së mbrojtur, vlerat ekologjike, të peizazhit natyror dhe vlerat turistike e kulturore (IV); këtu përfshihen Lugina e Valit, pjesë të Malit me Gropa dhe rajoni rreth teqesë së Martaneshit.

Mali me Gropa karakterizohet nga peizazhi më tipik i karstit në Shqipëri; kurrizi i tij është i mbushur gropa, hinka dhe puse të shumta karstike (Fig. 12-8b), nga ku edhe merr emrin, që shpesh vishen me livadhe dhe kullota malore me florë dhe bimësi të pasur. Si tillë ky peizazh bën pjesë lë listën e monumenteve natyrore shqiptare (gjeomonumenteve) (Qiriazzi & Sala, 2006).

12.6. Konsiderata floristike mbi pellgun e Bovillës

Nga vrojtimit tona në pellgun ujëmbledhës të Bovillës, dhe nga hulumtimet e bëra më parë në hapësirën e zonës së Dajtit – Malit me Gropa (*Anonymous*, 1996?; 1997; 2004; Dring *et al.*, 2002; Dumishllari, 2006; Dumishllari & Buzo, 2008; Kalajnxhiu, 2006; Kalajnxhiu *et al.*, 2004; Krutaj *et al.*, 2006; Shuka *et al.*, 2007, etj.), aktualisht hapësira të Parkut Kombëtar të Dajtit (të zgjeruar) (VKM 402, 2006) mund të pohohet se zona është potencialisht mjaft e pasur me lloje dhe formacione bimore, pavarësisht nga ndikimi i dukshëm i njeriut, dhe degradimi i dukshëm i mbulesës bimore. Për gjithë këtë hapësirë, në tabelën XII-1 (Shtojca XII) janë listuar mbi 860 lloje bimësh të larta, të shpërndara në rreth 90 familje (Tab. 12-3), ku familjet më të bollshme në lloje janë: *Fabaceae* (99 lloje), *Asteraceae* (87), *Poaceae* (76) dhe *Lamiaceae* (55). Ndër grupet kryesore mbizotërojnë dikotiledonet me rreth 670 lloje, pasuar nga monokotiledonet me mbi 170 lloje; jepen, gjithashtu, dhe 8 gjimnosperme dhe 19 lloje fiernash.

Format jetësore (Fig. 12-12) mbizotërohen nga hemikriptofitet (37%), terofitet (28%) dhe gjeofitet (17%), e cila është dëshmi e hapësirave të hapura (çeltirave) dhe dendësinë relativisht të ulët të kurorës së bimëve drunore,

shkallës së madhe të rrëgjimit të kateve shkurre dhe drunore. Edhe sasia e pakët e fanerofiteve (13%) është tregues jo vetëm i përfaqësimit jo të lartë të llojeve drusore, por edhe i shfrytëzimit të madh të tyre për qëllime ekonomike, e cila ka sjellë edhe proceset degraduese të bimësisë në zonë (Anonymous, 2004).



Figura 12-8. a) Pamje e Grykës së Zall Herrit nga Diga; b) një gropë karstike me dëborë në Malin me Gropa; c) pamje nga bokërimat e Mnerit (Bovillë); d) urë e vjetër mbi lumin e Tiranës në Shkallën e Tujanit, e përdorur për të lidhur pellgun e Tiranës me Dibrën (rruga njihet edhe sot në Tiranë si rruga e Dibrës). / View from the Dam of Zall Herri Gorge; b) a karstic hole with snow in Mali me Gropa; c) view on Mneri eroded slopes (Bovilla); d) old bridge over the Tirana river in Shkalla Tujani, used to connect Tirana lowland with the Dibra region (the road in Tirana is known even today as Dibra road) (Photos: Shuka).

Spektri korologjik mbizotërohet dukshëm nga format eumesdhetare (Tab. 12-4), e lidhur ngushtë kjo me klimën e pellgut, të ndikuar edhe nga zona bregdetare (stenomesdhetare); megjithatë, kjo duket se është e lidhur ngushtë edhe me proceset degraduese të bimësisë në zonë; në zonë gjenden shumë lloje evropiane, euqendrore, euaziatike etj., të cilat tregojnë se kjo bimësi është e lidhur me llojet bimore me origjinë veriore dhe verilindore (Anonymous, 2004).

Tabela 12-3: Lista e familje dhe llojet përkatëse bimore për secilën të gjetura në zonën Dajt-Mali me Gropa-Bovillë (PK i Dajtit - i zgjeruar). / Checklist of families and the related number of species found in Dajti-Mali me Gropa-Bovilla zone (Dajti NP - extended).

<i>Fabaceae</i>	89	<i>Aspidaceae, Asplenaceae,</i>	
<i>Asteraceae</i>	87	<i>Cistaceae, Corylaceae, Violaceae</i>	5
<i>Poaceae</i>	76	<i>Aristolochiaceae, Equisetaceae,</i>	
<i>Lamiaceae</i>	55	<i>Ericaceae, Malvaceae,</i>	4
<i>Rosaceae</i>	41	<i>Rhamnaceae, Valeraniaceae</i>	
<i>Liliaceae</i>	39	<i>Amaryllidaceae, Anacardiaceae,</i>	
<i>Cruceferae</i>	32	<i>Apocynaceae, Gentianaceae,</i>	3
<i>Scrophulariaceae</i>	31	<i>Polygalaceae, Thymelaeaceae,</i>	
<i>Caryophyllaceae</i>	29	<i>Ulmaceae</i>	
<i>Orchidaceae</i>	29	<i>Araceae, Asclepidaceae,</i>	
<i>Boraginaceae</i>	25	<i>Athyriaceae, Cornaceae,</i>	
<i>Umbelliferae</i>	23	<i>Cupressaceae, Moraceae,</i>	2
<i>Ranunculaceae</i>	21	<i>Hypolepidiaceae, Loranthaceae,</i>	
<i>Campanulaceae</i>	18	<i>Lythraceae, Orobanchaceae,</i>	
<i>Rubiaceae</i>	15	<i>Solanaceae</i>	
<i>Euphorbiaceae</i>	13	<i>Acanthaceae, Adoxaceae,</i>	
<i>Geraniaceae</i>	12	<i>Aquifoliaceae, Berberidaceae,</i>	
<i>Crassulaceae, Cyperaceae,</i>	11	<i>Celastraceae, Chenopodiaceae,</i>	
<i>Primulaceae</i>		<i>Dioscoreaceae, Gesneriaceae,</i>	
<i>Iridaceae, Juncaceae</i>	10	<i>Globulariaceae, Juglandaceae,</i>	
<i>Fagaceae</i>	9	<i>Lauraceae, Lentibulariaceae,</i>	
<i>Salicaceae</i>	8	<i>Myrtaceae, Ophioglossaceae,</i>	1
<i>Aceraceae, Caprifoliaceae,</i>	7	<i>Oxalidaceae, Parnassiaceae,</i>	
<i>Convolvulaceae, Polygonaceae,</i>		<i>Platanaceae, Polypodiaceae,</i>	
<i>Saxifragaceae</i>		<i>Raflessiaceae, Rutaceae,</i>	
<i>Dipsacaceae, Gutifferae,</i>		<i>Santalaceae, Tiliaceae,</i>	
<i>Oleaceae, Onagraceae,</i>	6	<i>Urticaceae, Vernenaceae,</i>	
<i>Papaveraceae, Pinaceae,</i>		<i>Vitaceae</i>	
<i>Plantaginaceae</i>			




Figure 12-9: Bimë të rralla dhe të rrezikuara nga Parku Kombëtar i Dajtit (zgjeruar) e Bovillës. / Rare and endangered plant species from Dajti National Park (extended): **A)** *Ramonda serbica*; **B)** *Halascya sendtneri*; **C-D)** *Pinguicula hirtiflora* var. *louisii* (Photo: Shuka).




Figure 12-10: Bimë të rralla dhe të rrezikuara nga zona e Bovillës. / Rare and endangered plant species from Bovilla region: **A)** *Salvia officinalis*; **B)** *Iberis umbellata*; **C)** livadh me *Orchis morio* ssp. *morio* në Zall Bastar (Photo: Shuka).



Figure 12-11: Bimë të rralla dhe të rrezikuara nga zona e Bovillës. / Rare and endangered plant species from Bovilla region: **A)** *Fritillaria macedonica*; **B)** *Crocus dalmaticus* (Photo: Shuka).




Figure 12-12: Format jetësore (%) të specieve bimore që njihen për zonën Dajt-Mali me Gropa-Bovillë. / Life forms (%) of plant species known for the Dajti-Mali me Gropa-Bovilla area.

Tabela 12-4. Spektri korologjik i llojeve bimore të pranishme në zonë / Chorological spectrum of plant species recorded in the Bovilla zone.

Format Korologjike	Nr. i llojeve	Format Korologjike	Nr. i llojeve
Eu-Mesdhetare	124	Eu-Kaukasiane	25
Mesdhetare	68	Sub-Balkanike	22
Evropiane	66	Eu-Siberiane	17
Eu-Asiatike	53	Mesdhetare-Malore	10
Eu-Jugore	52	Pontike	9
Steno-Mesdhetare	43	Mesdhetare-Atlantike	9
Paleo-Temperate	40	Endemike-Subendemike	9
Balkanike	33	Paleo-Subtropikale	5
Boreale	26	Illirike	4
Kosmopolite	26	Mesdhetare-Turke	4

Tabela 12-5. Lloje të rralla dhe të kërcënuara, të gjetura ose potencialisht të mundshme për zonën e Bovillës, të cilat përmenden në Librin e Kuq të Florës Shqiptare (*Anonymous*, 2008). / Rare and endangered species found or potentially present in the Bovilla area, mentioned in the Red Book of the Albanian Flora (*Anonymous*, 2008); En, endemics; sEn, sub-endemics.

Emri latin	Emri shqip	Vendi ku jepet
<i>Achillea frasio</i>	Barpezmi i Frasit	Mali i Snoit, M. me Gropa
<i>Adiantum capillus-veneris</i>	Fieri i krojeve	Mullet, Vorë, Brar, Priskë e Madhe
<i>Agrimonia eupatoria</i>	Eupatoria	pellgu i Bovillës
<i>Alyssum bertolonii</i>	Serica e Bertolonit	Qafa Shtamë, M. Skënderbeut
<i>Asperula scutellaris</i>	Njëgjire shqytake	Shëngjergj
<i>Atropa bella-dona</i>	Helmarina	Mali i Dajtit
<i>Athamanta macedonica</i>	Atamanta maqedonase	
<i>Aster albanicus</i> (En)	Ylli shqiptar	Qafështamë
<i>Berberis vulgaris</i>	Mërqinja	Mali i Snoit
<i>Caltha palustris</i>	Lëpushtër	Bizë
<i>Campanula albanica</i>	Lulekambana shqiptare	Liqeni i Germanit
<i>Carduus micropterus</i>	Freshkulli flatravogël	Dajt, M. Me Gropa
<i>Cerastium grandiflorum</i> (sEn)	Cerasti lulemadh	
<i>Chamaecytisus tommasinii</i> (sEn)	Kamecitiza e Tomazinit	M. Krujës, Mushqeta, Kryemadh, Shkozë, Dajt, Tufinë etj.
<i>Cistus albanicus</i>	Mënishtja shqiptare	Bizë, Teqeja e Balin sulltanit
<i>Colchicum autumnale</i>	Xhërrokulli	pellgu i Bovillës, Shkalla e keqe, Bizë, Mali me Gropa etj.
<i>Colchicum lingulatum</i> (sEn)	Xhërrokulli me gjuhëz	Dajt
<i>Colchicum pieperanum</i> (En)	Xhërrokulli i piperit	Dajt
<i>Crepis baldaccii</i>	Shmanga e Baldaçit	Mali me Gropa
<i>Crocus dalmaticus</i>	Shafrani i Dalmacisë	Kisha e Shën Prokopit, Tufinë, M. Skënderbeut
<i>Dictamnus albus</i>	Baruzo	Linzë, Qaf Shtamë, Pellgu i Bovillës

12. Mersinllari et al. Bimësia dhe përdorimi i tokës në pellgun e Bovillës

Emri latin	Emri shqip	Vendi ku jepet
<i>Digitalis lanata</i>	Luletogzi leshtak	Linzë, Mali i Skënderbeut, Bovillë etj.
<i>Dryopteris filix-mas</i>	Fiermashkulli	Bizë, Shkalla e keqe
<i>Forsythia europaea</i> (En)	Boshtra	M. Skënderbeut
<i>Fraxinus excelsior</i>	Frashëri i zi	Liqeni i Germanit
<i>Fritillaria macedonica</i>	Fritilarja e Maqedonisë	M. me Gropa
<i>Gentiana lutea</i>	Sanza	Qafë Shtamë, Qafa e Belegut, Mali me Gropa
<i>Geranium dalmaticum</i>	Kamarosha e Dalmacisë	Martanesh
<i>Gladiolus palustris</i>	Gladiola kënetore	
<i>Gymnospermum shqipetarum</i> (En)	Lulehelmi	Mali i Skënderbeut
<i>Halascya sendtneri</i>	Halaçi i Dendtnerit	Qafështamë
<i>Hypericum perforatum</i>	Lulebasani	Malqinet, Ibë, Petrelë etj.
<i>Juniperus communis</i>	Dëllinja e zezë	Valias, Qaf Mollë, Bovillë
<i>Laurus nobilis</i>	Dafina	Mali i Brarit, Surrel, Shkalla e Cullinit
<i>Marrubium alternidens</i>	Marrubë dhëmbëkëmbyer	Teqeja e Sarisalltituk
<i>Minuartia baldaccii</i>	Minuartia e Baldaçit	Mali me Gropa, M. Snoit, M. Skënderbeut
<i>Orchis albanica</i> (sEn)	Salepi shqiptar	Pylli i Calcabanit, Bathore, Dajt
<i>Orchis provincialis</i>	Salepi krahinor	
<i>Origanum vulgare</i>	Rigoni i kuq	Shkalla e Keqe, Bizë, Dajt etj.
<i>Oxytropis purpurea</i>	Oksitropi pupuror	Mali me Gropa
<i>Pedicularis brachyodonata</i>	Pedikulari dhëmbëshkurtër	Dajt
<i>Pinguicula hirtiflora</i> var. <i>louisii</i> (En)	Pinguikula lulekreshtë	Shkalla e Tujanit, Linzë
<i>Pinus sylvestris</i>	Hartina	Dajt
<i>Quercus ilex</i>	Ilqe	Priskë e Vogël, Dajt, Vilëz etj.
<i>Ramonda serbica</i>	Ramonda e Sërbisë	Tufinë, Petrelë, Dajt, Qafë Priskë, Krujë etj.
<i>Salvia officinalis</i>	Sherbela	Dajt, Mali i Brarit etj.
<i>Sambucus racemosa</i>	Shtogu i kuq	Shkalla e Keqe
<i>Satureja Montana</i>	Trumza	Dajt, M. Skënderbeut, Petrelë, Snoi etj.
<i>Saxifraga grisebachii</i> (sensu Hayek)	Iriqëza e Grisebakut	Dajt, Qafështamë, Mali me Gropa
<i>Sesleria robusta</i> ssp. <i>scanderbeggii</i> (sEn)	Pirrëgjaksja e shëndoshë	Mali me Gropa
<i>Solenanthes scardicus</i> (sEn)	Solenanta e Sharrit	Dajt, Bizë, Sharrë
<i>Taxus baccata</i>	Tisi	Shkalla e Keqe, Berdhet
<i>Teucrium arduini</i> (sEn)	Arrësi i Arduinit	Dajt
<i>Tilia platyphyllos</i>	Bliri gjethegjërë	Mali Beshit, Skënderbeut
<i>Trifolium pilczii</i>	Trifili i Pilcit	Martanesh
<i>Valeriana officinalis</i>	Haraqina mjekësore	livadhet e Selitës, Kaptinë Martanesh
<i>Viburnum tinus</i>	Indës	Brar, Surrel, Priskë e Vogël
<i>Viscum album</i>	Vjeshtulla	M. Skënderbeut
<i>Vincetoximum huteri</i> (sEn)	Qenmbytësja e Huterit	

Pellgu i Bovillës është i pasur në lloje të rralla (Fig. 12-9 deri 12-11), të kërcënuara ose në rrezik zhdukje, ku më të rëndësishmet jepen në tabelën 12-5. Për këtë jemi mbështetur në të dhënat e mbledhura gjatë ekspeditave tona në zonë, si dhe në botimet e ndryshme për zonën e Dajtit ose të Malit me Gropa, të cilat janë ekologjikisht të lidhura me të, kryesisht në listën e kuqe të Urdhrit 146 (Shtojca I; *Anonymous*, 2007), në Shtojcën I (Tab. 2.20 in *Anonymous*, 2004) të Planit të Menaxhimit të Parkut Kombëtar të Dajtit, në listat e kuqe ekzistuese të florës shqiptare (*Anonymous*, 2008; REC, 1997; Vangjeli et al., 1995), në botime të tjera, si Dumishllari (2006), Dumishllari & Buzo (2008), Kalajnxihi (2006), Kalajnxihi et al. (2004), Krutaj et al. (2006), Shuka et al. (2007) etj., si dhe duke krahasuar edhe me listat ekzistuese të llojeve të kërcënuara të IUCN-së (Valter & Gillet, 1998), të Bernës (*Anonymous*, 1979) etj.

Pellgu ka rëndësi dhe për nga larmia e bimëve mjekësore dhe etero-vajore të pranishme, si *Ceterach officinarum*, *Juniperus communis*, *J. oxycedrus*, *Crataegus monogyna*, *Digitalis lanata*, *Hypericum perforatum.*, *Rosa canina*, *Orchis spp.*, *Origanum vulgare*, *Salvia officinalis*, *Satureja montana*, *Teucrium chamaedrys* etj.

12.7. Bimësia e pellgut të Bovillës

Sipas Florës së Shqipërisë (1988-2000), bimësia e pellgut të Bovillës përfshihet në katër zona fitoklimatike: **të shkurreve dhe pyjeve mesdhetare, të dushqeve, të ahut, dhe të kullotave malore**. Duke filluar nga kurrizi mbi Zall Dajt e deri në faqet e Bastarit, Vilezë, Vilezë (Liqe), Mneri i Sipërm (Pjeç, Dedaj) e poshtë tek Rrëzë Dushje, shtrihen një grumbull kodrash (Fig. 12-2, 12-13 deri 12-16), të cilat mbulohen në pjesët e sipërme me bimësi të zonës së dushkut; pjesët më të ulëta të këtyre kodrave formojnë kryesisht shoqërime te zonës së shkurretave mesdhetare me elemente të makjes. Ndërsa majat e larta të maleve mbulohen me atë të zonës së ahut dhe të kullotave paramalore ose malore. Vendet më të sheshta e më të përshtatshme janë zënë nga bimësia e kulturave bujqësore: drithëra, foragjere, frutikulturë etj.

Zona e pyjeve dhe e shkurreve mesdhetare shtrihet në lartësitë 300-600 m mbi nivelin e detit. Këto janë shoqërime bimore të tipit të makies, përherëtëblerta, si mare (*Arbutus unedo*), shqopë (*Erica arborea*), mërsinë (*Myrtus communis*), mrete (*Phyllirea latifolia*), shkozë e zezë (*Carpinus orientalis*), lajthi (*Coryllus avellana*), dëllinjë e kuqe dhe e zezë (*Juniperus oxycedrus*, *J. communis*), thanë (*Cornus mas*), fshikëkarthë (*Colutea arborescens*), dafinë (*Laurus nobilis*) etj.

Zona e dushkajave shtrihet në lartësitë 500 (600)-1'000 (1'300) m (Fig. 12-15), me përzierje drurësh, si shparth (*Quercus frainetto*), qarr (*Q. cerris*), bungë (*Q. petraea*), bungëbutë (*Q. pubescens*), frashër (*Fraxinus excelsior*),

shkozë (*Carpinus orientalis*), mëllezë (*Ostrya carpinifolia*), gështenjë (*Casatanea sativa*), lajthi (*Coryllus avellana*), thanë (*Cornus mas*), gorrice (*Pyrus amygdaliformis*), rrallë ilqe (*Q. ilex*) etj.

Zona e ahut shtrihet në lartësitë 1'000-1'600 m dhe kryesohet nga ahu (*Fagus sylvatica*). Ahu gjendet në kufirin më perëndimor të arealit të tij, në grumbuj të thjeshtë, deri në lartësinë 1'570 m, si dhe me përzjerje llojesh: panjë fletëgjërë (*Acer obtusatum*), mëllezë (*Ostrya carpinifolia*), bungë (*Q. petraea*), frashër (*Fraxinus excelsior*), pishë e zezë (*Pinus nigra*), robull (*P. heldreichii*), hartinë (*P. sylvestris*), plep i egër (*Populus alba*), bli (*Tilia platyphyllos*) etj. Në disa maja mbi 1'000 m, pylli i ahut është i paprekur, i virgjër, pothuajse natyror.

Zona e kullotave malore është tepër e kufizuar, në lartësitë mbi 1'500 m. Sipas Dumishllari & Buzo (2008), sipërfaqe të mëdha dhe më vlerë zënë **livadhet eumesofile** të vendosur në toka relativisht të thella të murrme pyjore, me *Poa* sp. diverse, *Festuca panciciana*, *Cynosurus cristatus*, *Trifolium pratense*, *Phleum alpinum*, *Koeleria splendens*, *Asphodelus albus*, *Narcissus poeticus*. Çeltirat pyjore dhe sipërfaqet zhveshura gurishtore, në pjesën më të madhe përfaqësohen nga kullota të thata me *Festuca* sp. diverse (*F. bosniaca*), *Bromus* sp. diverse (p.sh. *B. erectus*), *Teucrium montanum*, *Stipa pennata*, *Thymus cherlerioides*, *Th. striatus*. Zënë vend të rëndësishëm **livadhet gjysmë të thata (meso-kserofite)**, me *Agrostis capillaris*, fier (*Pteridium aquilinum*), *Thymus striatus* etj. Në shpatet e sheshta dhe gropat, kryesisht me kundrejtim verior të Malit me Gropa, relativisht më të ftohta, mbulohen nga **livadhe mesofile të ftohta**, me *Poa* sp. diverse dhe *Nardus stricta* (Dumishllari, 2006; Dumishllari & Buzo, 2008).

Në vijim po bëjmë një përshkrim përmbledhës të **shoqërimeve bimore kryesore të pellgut të Bovillës**, duke u mbështetur në të dhënat e mbledhura gjatë ekspeditave tona në zonë, si dhe në botimet e ndryshme për zonën e Dajtit ose të Malit me Gropa, ekologjikisht të lidhura me të, kryesisht në Planin e Menaxhimit të Parkut Kombëtar të Dajtit (Anonymous, 2004) dhe në botime të tjera, si Dumishllari (2006), Dumishllari & Buzo (2008), Kalajnxihi (2006), Kalajnxihi et al. (2004), Krutaj et al. (2006) etj. Në tabelën 6 jepen tipat kryesore të bimësisë që mbizotërojnë brenda zonës dhe masat e mundshme për ruajtjen ose ripërtëritjen e tyre.

Platanetum orientalis-balkanicum: Gjendet kryesisht në shtretërit e lumenjve dhe të përrenjve, ose në shpatet afër nivelit të ujërave freatike, vendosur mbi toka primitive. Duke pasur parasysh vendet ku zhvillohet, shoqërimi ka rol të rëndësishëm mbrojtës. Nga pikëpamja fitosociologjike shumica e llojeve u përkasin rendeve *Populetalia*, *Fagetalia* dhe *Quercetalia pubescentis*. Speciet e dy rendeve të fundit duhen konsideruar si prirje drejt bimësisë potenciale, që është në gjendje të vendoset vetë me lehtësi si bimësi post-pioniere në toka të varfra dhe skeletike. Speciet karakteristike të shoqërimit janë: *Platanus orientalis*, *Juglans regia* (vlerësuar për prodhimin e

fryteve), *Tamarix parviflora*, *Crataegus monogyna* (vlerësuar si bimë mjekësore). Pasuria llojore është e lartë, mbi 50 lloje të pranishme. Ky shoqërim është mjaft i rëndësishëm si habitat për gjitarë të ndryshëm, shpendë dhe zvarranikë (disa mjaft të rrallë e kërcënuar) (*Anonymous*, 2004). Mjaft e rëndësishme është, gjithashtu, aftësia për mbrojtjen e tokës nga erozioni.

Gjendja e këtij shoqërimi nuk është fort e mirë për shkak të aktiviteteve të njeriut në shtretërit e lumenjve. Ai rrezikon të zhduket nga shfrytëzimi për dru zjarri ose marrja e inerteve. Ndalimi i prerjeve, mbjellja e fidanëve dhe kontrolli marrjes së inerteve do të ishin masat më të mira menaxhuese për përmirësimin e gjendjes.

Carpinus orientalis-Quercus cerris: Ky shoqërim i përket grupimit fitosociologjik të **pyjeve termofile gjethegjera** (Tab. 12-6). Shoqërimi vendoset në toka të thata ose gjysmë të thata, me pjellori mesatare ose të lartë, në lartësi nga 400 deri 900 m, e karakterizuar nga klimë sub-mesdhetare tipike (jo më shumë se dy muaj thatësirë gjatë verës). Nga pikëpamja evolutive, ai mund të konsiderohet si stad i tretë dinamik i *Quercion frainetto-cerris* (stadi klimaks), i formuar prej prerjeve intensive, kullotjes dhe krasitjes për gjedh. Ky përbën shoqërimin më të zakonshëm në hapësirën e Dajtit, veçanërisht në lindje të tij. Speciet me karakteristike janë *Carpinus orientalis*, *Quercus cerris*, *Q. frainetto*, *Melitis melisophyllum* etj. Ky shoqërim strehon gjithsej rreth 45 lloje bimësh. Vëllimi drusor është, gjithashtu, i ndryshueshëm, nga 30 – 100 m³/ha (*Anonymous*, 2004).

Nga ana dinamike, shoqërimi ka pamje heterogjene, shpesh i degraduar në trungishte ose cungishte, si rrjedhojë e shqetësimeve të përhershme periodike në shpatet e pjerrtë (shpyllëzimet dhe erozioni), veçanërisht në ato vendosur mbi flishe e shiste. Stadi të tilla degradimi karakterizohen nga prania e *Juniperus oxycedrus*, *Dorycnium hirsutum*, *Psoralea bituminosa*, *Putoria calabrica*, *Stachelina uniflosculosa*, *Saponaria calabrica*, *Fraxinus ornus*, *Carpinus orientalis*. Duke qenë afër qendrave të banuara, shoqërimi është shfrytëzuar vazhdimisht për dru zjarri dhe kullotje, kryesisht prej dhive; dhitë janë kafshë shtëpiake tradicionale të kësaj zone. Megjithatë, vende-vende vihet re ripërtëritje e mirë e bimësisë; grumbuj dushku mjaft të vjetër, të përdorur tradicionalisht për gjedh; gjenden në shpatet lindore të malit të Dajtit, pranë ujëmbledhësit të Bovillës dhe shkallës së Tujanit.

Si masë më e rëndësishme menaxhuese për përmirësimin e gjendjes, do të rekomandohej **ulja e pranisë së njeriut**, si dhe **zbatimi i sistemeve të qëndrueshme silvo-pastorale**. Kjo përforcohet nga evolucioni progresiv i bimësisë vende-vende drejt stadeve më të stabilizuara dinamike, si rrjedhojë e uljes së ndikimit të njeriut (Fig. 12-17). **Prirja ripërtëritëse natyrore duhet nxitur përmes masave teknike dhe silviokulturore**, përfshi këtu edhe **rimbjelljen e llojeve gjethegjera**. *Quercus frainetto*, *Q. cerris*, *Fraxinus ornus* do të ishin llojet më të përshtatshme për ripërtëritje (ripyllëzime).

Tabela 12-6. Tipat kryesore të bimësisë brenda zonës Dajt-Mali me Gropa-Bovillë dhe masat më të mira menaxhuese për ruajtjen ose ripërtëitjen e tyre. / Principal vegetation types within the Dajti-Bovilla zone and the best management practices suggested for its preservation or restoration..


Formacioni bimor	Llojet karakteristike	Vendet ku gjenden	Masat më të mira menaxhuese
Makje tipike mesdhetare ose shkurreta përherë të blerta (<i>Myrto-Quercetum ilicis</i> dhe <i>Arbuto-Quercetum ilicis</i>)	<i>Myrtus communis</i> , <i>Arbutus unedo</i> , <i>Erica arborea</i> , <i>Phyllirea latifolia</i> , <i>Fraxinus ornus</i> , <i>Cistus spp.</i>	Kryesisht në dy grykat, të Bovillës (Zall Herrit) dhe Tujanit, dhe në shpatet e ulëta të kodrave (300-500 m)	Ripërtëitja përmes zbatimit të sistemeve të qëndrueshme silvo-pastorale, mbrojtja nga zjarret, kullotja e dhive, mbjellja e llojeve indigjene gjethgjera
Pyje dhe shkurreta gjetherënëse mesdhetare (<i>Carpino-Pistacatum terebinthii</i>)	<i>Carpinus orientalis</i> , <i>Ostria carpinifolia</i> , <i>Pistacia terebinthii</i>	Ndërmjet brezit të shkurreve mesdhetare (makjes) dhe brezit të pyjeve të dushkut (Mali i Brarit, i Gamthit, i Dajtit).	
Dushkaja të degraduara (<i>Pruno-Crataegetum</i> dhe <i>Pruno-Juniperetum</i>)	<i>Prunus spinosa</i> , <i>Crataegus monogyna</i> , <i>Dorycnium hirsutum</i> , <i>Teucrium pollium</i> , <i>Paliurus spina-christi</i> etj.	Tokat bujqësore të braktisura, djerrina (600-800 m)	Nxitja e drejtimit evolutiv nëpërmjet pyllëzimit me bimë gjethgjera autoktone
Rrapishte (<i>Platanetum orientalis-balkanicum</i>)	<i>Platanus orientalis</i> , <i>Juglans regia</i> , <i>Tamarix parviflora</i> , <i>Crataegus monogyna</i>	Kryesisht në shtretërit e lumenjve dhe të përrenjve, ose në shpatet afër ujërave freatike, mbi toka primitive (200-400 m)	Ndalimi i prerjeve, mbjellja e fidanëve dhe kontrolli marrjes së inerteve.
Pyje termofile gjethgjera (<i>Quercu-Carpinetum submediterraneum</i> dhe <i>Quercetum frainetto-cerris</i>)	<i>Carpinus orientalis</i> , <i>Quercus cerris</i> , <i>Q. frainetto</i> , <i>Melitis melisophyllum</i> , <i>Lathyrus niger</i> , <i>Potentilla micrantha</i> , <i>Galium lucidum</i> etj.	Shumë i zakonshëm në formë trungishtesh dhe cungishtash në shpatet lindore të Dajtit; grumbuj natyrorë të veçuar pranë ujëmbledhësit të Bovillës dhe shkallës së Tujanit (400-900 m) Përgjithësisht në brezin paramalor	Ulja e ndikimit të njeriut, ripërtëitje natyrore, duke e shoqëruar me masa teknike dhe silviokulturore, përfshi edhe rimbjelljen e llojeve gjethgjera Nuk rekomandohen prerjet

Formacioni bimor	Llojet karakteristike	Vendet ku gjenden	Masat më të mira menaxhuese
		dhe malor. Grumbuj të vjetër tek qafa e Tujanit, gryka e Bovillës, Qafë Mollë.	masive, por vetëm ato përzgjedhëse dhe shumë të kujdesem, dhe jo gjatë shirave.
Pyje gjethegjërë paramalorë të veçuar (<i>Quercus-Castanetum submediterraneum</i>)	<i>Castanea sativa</i> , <i>Quercus petraea</i> <i>Juniperus communis</i>	Duke filluar nga 700 m, në brezin malor mesdhetar deri në kontakt me ahun. Në shpatet lindore të Dajtit, në afërsi të qendrave të banuara	I jep peizazhit aspekt tradicional, me vlera çlodhëse; rimbjellje e llojeve gjethegjera
Pyje mesofile mesdhetare malore (<i>Luzulo-Fagetum</i> dhe <i>Ostryo-Fagetum</i>)	<i>Ostrya carpinifolia</i> , <i>Fagus sylvatica</i> , <i>Fraxinus ornus</i> , <i>Carpinus betulus</i> , <i>Acer</i> spp. etj.	Mbi 900 m, në zonën e takimit midis brezit të dushqeve dhe ahut. Në skajin lindor të rajonit, afër Malit me Gropa, M. Priskës etj. Brezi i ahut, më i sipërmi i bimësisë pyjore në rajon, në brezin e klimës mesdhetare malore (1000-1500 m).	Zbatimi i sistemeve silvo-pastorale, ruajtja dhe shfrytëzimi të qëndrueshëm
Grumbuj halorësh të veçuar (<i>Fago-Pinetum heldreichii</i>)	<i>Fagus sylvatica</i> , <i>Pinus heldreichii</i> dhe <i>Abies alba</i>	Në shpatet më të pjerrtë të Dajtit, në lartësitë më të mëdha të pyjeve të ahut, i rrethuar edhe nga kullotat malore (rreth 1'600 m).	Mbrojtje të vazhdueshme për praninë e llojeve të rralla dhe ndjeshmëri ndaj ndikimit të njeriut.
Kullota malore (<i>Festuco-Brometum</i> , <i>Pteridio-Agristietum capillaries</i> , <i>Poa media-Festucetum panciciana</i> , <i>Poa media-Nardetum</i>)	<i>Agrostis capillaris</i> , <i>Bromus erectus</i> , <i>Cynosurus cristatus</i> , <i>Festuca</i> sp. <i>diverse</i> , <i>Thymus</i> sp. <i>diverse</i> , <i>Trifolium</i> spp., <i>Phleum alpinum</i> , <i>Poa</i> sp. <i>diverse</i> , <i>Koeleria splendens</i> , <i>Asphodelus albus</i> , <i>Narcissus poeticus</i> , <i>Nardus stricta</i>	Shpatet dhe majat mbi 1500 m lartësi. Kullotat e thata gurishtore dhe gjysmë të thata, livadhet eumesofile dhe mesofile të vendosur në toka relativisht të thella të murrme pyjore	Kullotje e kujdesme, shfrytëzim i kujdesëm i bimëve mjekësore, mbrojtje nga zjarret

Figure 12-13. Pamje i pellgut të Bovillës nga Vileza. / Overview on the Bovilla watershed from Vileza. / (Photo: Hoxha).



Figure 12-14. Pamje e lumit të Bruz-Malit dhe liqenit të Bovillës nga Qafështama, ku duket bimësia shumë e rrëgjuar. / View of on the Bruz-Mali river and on the Bovilla Reservoir from Qafështama; the degradation of the vegetation is evident (Photo: Shuka; Maj 2006).



Nga ky shoqërim mund të përfitohen të ardhura të mira edhe **nga grumbullimi i bimëve mjekësore**, si *Juniperus oxycedrus*, *Crataegus monogyna*, *Origanum vulgare*, të cilat gjenden bollshëm në të.

Quercetum frainetto-cerris: Nga ana dinamike përfaqëson stadin klimaks të **pyjeve gjethegjera termofile** ose **dushkajave gjetherënëse**, pra në ekuilibër me kushtet natyrore, të përbëra veçanërisht nga *Quercus cerris* dhe *Q. frainetto*. Gjendet në toka me lagështi ose mesatarisht të lagëta, veçanërisht në thellësi, në toka pjellore me reaksion bazik/neutral. Quercetum frainetto-cerris përgjithësisht vendoset në toka të kafenja tipike, mbi gëlqerorë, shiste ranore dhe argjilore. Përhapet përgjithësisht në brezin paramalor dhe malor. Speciet më karakteristike të këtij shoqërimit janë *Quercus cerris*, *Q. frainetto*, *Lathyrus niger*, *Lychnis coronaria*, *Potentilla micrantha*, *Galium lucidum*. Është ndër shoqërimet më të pasura në lloje (mbi 50 lloje).

Sot ai gjendet kryesisht si cungishte dhe trungishte dushqesh, për arsye se tradicionalisht këto pyje janë përdorur si cungishte për dru zjarri, krasitje për ushqim bagëtish dhe kullotje. Fillimi i degradimit të pyllit dëshmohej edhe nga prania e llojeve të tilla si *Juniperus oxycedrus*, *Pyrus amygdaliformis*, *Paliurus spins-christi*. Në rajon kanë mbetur akoma grumbuj të vjetër, relativisht të ruajtur, të cilët duhen konsideruar si të rëndësishëm për qëllime historike dhe shkencore (Gryka e Tujanit, Gryka e Bovillës – Zall-Bastarit, Qafë Mollë) pjesërisht të përdorura për krasitje. Grumbujt më të vjetër mund të arrijnë një fond prodhimi prej 700 m³/ha (*Anonymous*, 2004)

Ky shoqërim shpesh ndodhet në toka ranore dhe për rrjedhojë është shumë i ndjeshëm nga përdorimi pa kujdes, nga prerjet e vazhdueshme dhe nga bagëtia; kjo ka çuar në degradimin e tij duke nxitur dhe erozionin e tokës. Për këtë, **nuk rekomandohen prerjet masive; vetëm prerjet përzgjedhëse të kujdesme** mund të mbrojnë tokën dhe ripërtëritjen e pyllit. Asnjë aktivitet shfrytëzimi nuk rekomandohet në periudhën e shirave.

Castaneo-Quercetum cerris: Ky shoqërim përfaqëson **pyje gjethegjere paramalorë të veçar**, që ndeshet zakonisht në shpatet me kundrejtime lindore të malit të Dajtit, në afërsi të qendrave të banuara. Rritet përgjithësisht në tokat më pjellore dhe më të thella, acidofile dhe ranore. Vendoset në lartësitë duke filluar nga 700 m, në brezin malor mesdhetar, në kontakt me brezin e ahut në lartësi më të mëdha. Është grup që përfshin specie gjethegjera, ku më karakteristiket janë *Castanea sativa*, *Quercus petraea*, *Juniperus communis*, *Luzula forsteri*, *Hieracium sylvaticum*, *Melitis melisophyllum*, *Calamintha grandiflora*. Përbërja llojore konsiderohet e lartë (rreth 53 specie).

Shoqërimi paraqet stadin klimaks dhe shpesh formon pyje të përziera me *Corylus avellana*, *Quercus petraea*, *Q. frainetto*, *Ostrya carpinifolia*, *Acer pseudoplatanus* etj. Shfrytëzohet tradicionalisht për prodhim frutash (gështenja), të cilat përbëjnë burim të ardhurash dhe më pak edhe për lëndë

druri (mobiliери). Disa nga grumbujt përbëhen nga drurë të vjetër, të tharë në majë dhe që shpesh vuajnë nga sëmundjet dhe dëmtues. Kombinimi i këtij shoqërimi me tokat bujqësore, vendbanimet e vogla, ujëmbledhësit dhe kullotat i jep peizazhit aspekt tradicional, me vlera çlodhëse, që mund të jetë shumë i rëndësishëm për zhvillimin e eko-turizmit. Ky shoqërim njihet edhe si mjaft i rëndësishëm edhe për strehimin e kafshëve të egra (*Anonymous*, 2004).

Luzulo-Fagetum: Përfaqëson stadin më të qëndrueshëm të **pyjeve mesofile të ahut**; ky përbën një pjesë të mirë të pyjeve të ahut në zonë, dhe është relativisht i mbrojtur mirë, sidomos në Dajt. Nga pikëpamja fitosociologjike ngjan me shoqërimin *Castaneo-Quercetum cerris* të ahut; është i vendosur mbi shkëmb amnor gëlqeror, në toka të cekëta dhe mesatarisht të thata. Llojet karakteristike kryesore janë *Fagus sylvatica*, *Acer pseudoplatanus*, *A. platanoides*, *Ilex aquifolium*, *Luzula sylvatica*, *Mycelis muralis*, *Dentaria bulbifera*, *Geranium robertianum*, *Doronicum columnae*, *Prenanthes purpurea*, *Lamiastrum galeobdolon*, *Galium odoratum*, *Asperula taurina*.

Fago-Pinetum heldreichii: Ky është shoqërim bimor i rëndësishëm, por i veçuar i llojeve halore, i cili konsiderohet si stad klimaks i tyre. Ai shumë interesant nga ana shkencore, meqenëse është mjaft i rrallë dhe përfaqëson skajin më perëndimor të përhapjes së këtyre llojeve në Shqipëri. Vendoset në shpatet më të pjerrëta të malit të Dajtit, në lartësitë më të mëdha të pyjeve të ahut (rreth 1'600 m), i rrethuar edhe nga kullotat malore. Përgjithësisht ndodhet në toka të thata dhe mbi gëlqerorë. Llojet më të rëndësishme që e shoqërojnë janë ato që rriten në shkëmbinj dhe në toka shumë të cekëta. Llojet karakteristike të shoqërimit dhe të aleancës janë *Fagus sylvatica*, *Pinus heldreichii* dhe *Abies alba*. Ndonjëherë përzihet me *Pinus nigra* dhe *P. sylvestris*, e cila së bashku me *P. heldreichii* janë specie të rralla, të përfshira në librin e kuq të Shqipërisë (Vangjeli et al., 1995; *Anonymous*, 2008).

Gjendja natyrore e këtij shoqërimi është relativisht e mirë, kjo për shkak të mjedisit të përshtatshëm dhe shfrytëzimit të i pakët, për shkak të pjerrësisë së madhe të shpateve dhe terrenit të vështirë. Ky shoqërim meriton **mbrojtje të vazhdueshme për shkak të pranisë së llojeve të rralla, shumë të ndjeshme ndaj ndikimit të njeriut**.

Colurno-Fagetum: Është shoqërim i veçantë, dhe i rrallë, në sipërfaqe të kufizuara në qafën e Qershisë, ndërmjet dy majave të Dajtit (1'613 m) dhe Tujanit (1'531 m). Speciet më karakteristike janë *Corylus colurna*, *Fritellaria macedonica*, *Orchis* sp., *Festuca gigantea*, *Lilium martagon*, *Scutellaria columnae*, *Asplenium trichomanes*, *Sedum album* etj. Përgjithësisht gjendet në vende të hapura ose me drurë të rrallë të vendosura mbi gëlqerore masivë. Lloje të tjera i përkasin spektrit florik të ahut, përzierë me lloje të kullotave malore. Shoqërimi ndodhet kryesisht në toka me lagështi mesatare dhe lehtësisht acide.

Carpino–Pistacetum terebinthii: Përfaqëson shoqërim të veçantë që vendoset ndërmjet **brezit të shkurreve mesdhetare (makjes) dhe brezit të pyjeve të dushkut**, në lugina që rrihen nga rryma të freskëta. Parapëlqen gëlqerorët dhe toleron tokat e cekëta dhe jo pjellore, me klimë të ngrohtë dhe të thatë në verë, por të freskët dhe të ftohtë në dimër. Nga pikëpamja dinamike i përket stadi të tretë të degradimit të *Quercetum trojanae*, prej të cilit ka shumë lloje. Tradicionalisht është përdorur për kullotje dhish dhe dru zjarri, dhe përgjithësisht vuan nga shfrytëzimi intensiv dhe degradimi, e dëshmuar dhe nga prania e madhe e hemikriptofiteve dhe kamefiteve. Speciet më karakteristike janë: *Carpinus orientalis*, *Pistacia terebinthus*, *Quercus trojanae*, *Arbutus unedo*, *Erica arborea*, *Fraxinus ornus*, *Crataegus monogyna*. Numri llojeve të sjella për këtë shoqërim është rreth 70. **Ulja e ndikimit të njeriut tek bimësia, ndalimi i prerjeve dhe kullotjes së dhive, si dhe mbrojtja nga zjarret** janë masat më të rëndësishme për përmirësimin e gjendjes bimore dhe ndryshimin e kahes së evolucionit (*Anonymous*, 2004).

Myrto–Quercetum ilicis: Ky shoqërim përfaqëson një bimësi të copëzuar, **makje tipike mesdhetare** me mbizotërim të llojeve përherëtëblerta. Vendoset kryesisht në dy grykat, e Bovillës (Zall Herri) dhe e Tujanit. Nodohen në toka të cekëta dhe të varfra mbi gëlqerorë e shpate me pjerrësi të lartë. Klima karakterizohet nga një periudhë e gjatë bimësie (rreth 9 muaj) dhe një periudhë thatësire verore (mbi 2 muaj) (*Anonymous*, 2004). Ndër speciet kryesore mund të përmenden *Myrtus communis*, *Arbutus unedo*, *Erica arborea*, *Phyllirea latifolia*, *Fraxinus ornus*, *Cistus salvifolius*, *C. incanus*, *Psoralea bituminosa*, *Rosa sempervirens*. Pasuria llojore numëron rreth 45 specie bimore.

Nga pikëpamja dinamike shoqërimi duket se është stad i përparuar i degradimit të pyjeve me ilqe, si rrjedhojë e zjarreve dhe shfrytëzimit për dru zjarri. Duhet pohuar se zjarret e pakontrolluara bien shpesh në rajon. **Ripërtëritja përmes zbatimit të sistemeve të qëndrueshme silvo-pastorale, mbrojtja nga zjarret, kullotja e dhive dhe mbjellja e llojeve indigjene gjethegjera**, janë mundësitë më të mira menaxhuese që mund të këshillohen për përmirësimin e gjendjes.

Pruno-Crataegum: Përfaqëson stad mjaft të përparuar (stadi i parafundit) të degradimit të formacioneve të **dushkajave termofile gjetherënëse** (*Quercus-Carpinetum cerris*), si pasojë e ndërhyrjeve të pa kujdesme dhe shfrytëzimit intensiv (Fig. 12-14). Shpeshherë, ky shoqërim vjen si rrjedhojë e evolucionit progresiv të bimësisë tek tokat bujqësore të braktisura, të lëna djerr. Larmia bimore e tyre është mjaft e vogël, e përbërë kryesisht nga **lloje gjembore dhe durues të thatësirës**. Llojet karakteristike të shoqërimin dhe aleancës janë *Prunus spinosa*, *Crataegus monogyna*, *Dorycnium hirsutum*, *Teucrium pollium*, *Paliurus spina-christi*, *Aegilops ovata*, *Cynosurus cristatus*, *Potentilla reptans*. **Nxjtja e drejtimit evolutiv nëpërmjet mbjelljes/pyllëzimit me bimë gjethegjera autoktone** do të ishte praktika menaxhuese më e mirë

për rivendosjen e gjendjes. Krahas mbrojtjes nga erozioni dhe përmirësimit të cilësisë së ujërave, kjo do të ishte një mundësi për rritjen dhe përmirësimin e fondit pyjor, si dhe të vlerave eko-turistike e ekonomike të rajonit.

Pruno-Juniperetum: Ky shoqërim bimor është i kudo ndodhur në këtë zonë, sidomos në afërsi të qendrave të banuara. Përfaqëson stad mjaft të përparuar të formacioneve me **dushkaja termofile gjetherënëse** (*Quercetum frainetto-cerris*), si pasojë e prerjeve dhe sidomos kullotjes. Parapëlqen kushte klimatike relativisht të buta, me thatësirë verore që zgjat 1.5 muaj dhe me periudhë të bimësisë jo më të gjatë se 9 muaj. Tokat mbi të cilat haset janë toka të kafenjta, kryesisht me karakter skeletik. Shkëmbi amnor është gëlqeror dhe shume rrallë flish. Bimësia e këtij shoqërimi është mjaft e dëmtuar, sa mund të thuhet se ripërtërija është e pakthyeshme në kushte natyrore. Për rrjedhojë edhe erozioni në këto hapësira është i fuqishëm.

Prania e llojeve gjembore, si *Crataegus monogyna*, *Rubus ulmifolium*, *Rosa semperivensis*, *Pyrus amygdaliformis*, *Ononis spinosa*, *Paliurus spina-christi* etj. tregojnë ndikimin e theksuar të njeriut dhe prirjen degraduese, kryesisht për shkak të kullotjes dhe të gërryerjes. *Prunus spinosa* dhe *Juniperus oxycedrus* janë llojet fizionomike të shoqërimit, ku përveç tyre mund të përmendim *Ononis spinosa*, *Scabiosa atropurpurea*, *Euphorbia cyparissias*, *Pyracantha coccinea*, *Colutea arborescens* etj. Ndër speciet karakteristike të aleancës dhe të rendit, të cilat përfaqësojnë dhe bimësinë potenciale, mund të përmenden *Quercus cerris*, *Q. trojana*, *Crataegus monogyna*, *Carpinus orientalis*, *Clinopodium vulgare*, *Helleborus odoratus*, *Brachypodium sylvaticum* etj. Në katin barishtor takohen edhe specie të tilla, si *Dactylis glomerata*, *Geranium dissectum*, *Poa nemoralis*, *Trifolium arvense*, të cilat e bëjnë shoqërimin të pëlqyer për kullotje (kryesisht nga dhentë). Prania e disa llojeve me vlera ushqyese dhe mjekësore, si *Crataegus monogyna*, *Hypericum perforatum*, *Rosa canina*, *Coryllus avellana*, *Pyrus amygdaliformes*, *Plantago lanceolata* etj., rrisin më tej vlerat ekonomike të hapësirave që zë ky shoqërim. Vlen të theksojmë, se deri më sot ky aspekt nuk është vlerësuar në mënyrë të qëndrueshme.

Arbuto-Quercetum ilicis: Përhapet në pjesën e poshtme të shpateve perëndimore të Dajtit, përballë qytetit të Tiranës (rreth 300–500 m). Përfaqëson stadin e dytë të degradimit të pyjeve të ilqes, përgjithësisht nga zjarret e përsëritura, të cilën e dëshmon dhe prania e madhe e kamefiteve dhe hemikriptofiteve. Shoqërimi rritet në pjerrësi të ngrohta e të thata, duke duruar një periudhë thatësire verore mbi 2 muaj (Anonymous, 2004). Tokat janë përgjithësisht të thella, pjellore e të vendosura mbi ranorë dhe konglomerate. Speciet karakteristike janë *Arbutus unedo*, *Erica arborea*, *Pistacia terebinthus*, *Pistacia lentiscus*, *Myrtus communis*, *Laurus nobilis*, *Phillyrea latifolia*, *Cistus incanus*, *Rosa sempervirens*, *Coronilla emerus*, *Colutea arborescens*. Larmia bimore është mjaft e pasur me mbi 70 lloje.

Bimësia barishtore është e përhapur në gjithë hapësirat e zhveshura midis pyjeve dhe shkurreve (çeltirat) dhe në zonën e kullotave malore mbi 1'500 m lartësi, sipas Krutaj et al. (2006) dhe Dumishllari & Buzo (2008), pjesa më e madhe e bimësisë barishtore përfaqësohet nga **kullotat e thata gurishtore malore (kserofile)**, me mbulesë bimore deri 50-65%, të përfaqësuara nga shoqërimet *Festuco-Brometum*, *Teucrium montanum-Stipetum pengata*, *Festucetum bosniaca-Thymus cherlerioides*, *Saturetum montona* etj. Vend të rëndësishëm zënë dhe **livadhet gjysmë të thata (mesokserofile)** me *Pteridio-Agristietum capillaries* dhe *Thymus striatus-Agrostietum capillaries*, në shpatet pak të pjerrëta dhe toka të murrme pyjore, mesatarisht të thella dhe gjysmë të thata. Në toka të murrme pyjore, mesatarisht të thella, gjenden edhe **livadhe të vërteta (eumesofile)**, me *Poa media-Festucetum panciana*, *Cynosuro-Trifolietum pratense*, *Phleum alpinum-Koeleretum splendens*, *Asphodelus albus-Narcissus poeticus*. **Livadhet mesofile të ftohta** përhapen vende-vende në shpatet dhe gropat më të freskëta, me kundrejtim verior, të përfaqësuara me *Poa media-Nardetum*.

Sipas Plantit të Menaxhimit të Parkut Kombëtar të Dajtit (*Anonymous*, 2004) shoqërimi barishtor ***Ceteracho-Ramondetum serbicae*** është mjaft i rrallë në këtë zonë dhe i rëndësishëm nga pikëpamja shkencore. Ky gjendet vetëm mbi shkëmbinj masivë dhe thujse vertikale, dhe mendohet të përbëjë stadin primar të **bimësisë tipike mbi shkëmbinj gëlqerorë**. Tek ky shoqërim *Ramonda serbica* shoqërohet zakonisht me *Ceterach officinarum*, *Asplenium trichomanes*, *A. viridis*, *Doronicum austriacum*, *Poa nemoralis*, *P. alpina*, *Saxifraga paniculata*, *Scrophularia scopoli*, *Polygonatum multiflora*, *Thlaspi perfoliata*, *Rhamnus alpinus*, *Sedum ochroleuca*, *Festuca gigantea*, *Alyssum saxatile*, *Micromeria cristata*, *Silene pusila*, *Draba aizoides*, *Sesleria rigida*, *Campanula rotundifolia*. Rekomandohet fort që habitatet ku ai gjendet të mbrohen rreptë.

12.8. Brezi Mbrojtës rreth liqenit të Bovillës

Brezi i steresë me rreth 100 m lartësi përreth Liqenit, duke filluar nga kuota 318 m mbi nivelin e detit, që është lartësia maksimale normale e pasqyrës së ujit, përbën **Brezin Ekologjik Mbrojtës**, i njohur dhe si **Brezi Sanitar** (Tab. 12-7; si dhe 12-15). Për më tepër mbi shtrirjen e këtij brezi rreth liqenit *shih* hartën topografike të ujëmbledhësit në figurën 1-4 tek Miho et al. (në këtë vëllim). Në vitin 2000 rreth liqenit janë listuar 278 lloje bimësh, që u përkisnin rreth 59 familjeve; spektri biologjik i tyre përfaqësohesh nga 35% lloje bimësh barishtore me cikël jetësor të shkurtër (terofite), 32% lloje barishtore shumëvjeçare (hemikriptofite), dhe 23% lloje bimësh shumëvjeçare (fanerofite).



Figura 12-15. Pamje të kodrave rreth liqenit të veshura me shkurre mesdhetare / View on the surrounding hills covered with mediterranean shrubs (Photos: Miho, May 2006)

Prej vitit 2006, pellgu i Bovillës është përfshirë në Parkun Kombëtar të Dajtit (të zgjeruar; VKM 402, 2006), kjo është shenjë e mirë, por nuk mjafton; për më tepër që në asnjë fjalë në zonimin që jepet në këtë akt ligjor nuk përmendet cilësia e ujërave dhe vetë Bovilla (!). Ajo që të habit më tej në këtë vendim është se në zonimin e zonës së mbrojtur, pjesa rrethliqenore, që në të

vërtetë i përket gjithë Brezit Mbrojtës (320 – 420 m mbi nivelin e detit), është caktuar si zonë çlodhëse natyrore (ZR2 në hartën e Fig. 12-6); ky brez duhet të jetë rreptësisht i mbrojtur; në zonimin e parkut duhet të jetë zonë e tipit ZQ, **zonë qendrore me ruajtje të veçantë** (*shih* hartën e figurës 12-6). Këshillojmë fort që kjo mangësi të riparohet me akte të tjera nga institucioni përkatës. Theksojmë se biodiversiteti është i rëndësishëm, por në rastin në fjalë, kjo hapësirë ka një vlerë tjetër shumë më madhore që mbivendoset me biodiversitetin, atë të sigurimit të ujit të pijshëm për rreth 850'000 banorë, e cila duket se është harruar nga institucioni më i lartë i mbrojtjes së natyrës dhe shëndetit të njeriut në Shqipëri. Dhe si në shumë akte të ngjashme të kësaj natyre, asnjëherë nuk saktësohet vlera financiare dhe si do të mbulohet ajo, për të siguruar mbrojtjen e natyrës dhe kufizimet që rrjedhin prej saj.

Tabela 12-7. Të dhëna mbi Brezin Ekologjik Mbrojtës (i njohur si Brezi Sanitar) rreth liqenit të Bovillës. / Data on the Ecological Protected Belt (known as the Sanitary Belt) around the Bovilla Lake.

Tipari	Vlera
Shtrirja e Brezit Ekologjik Mbrojtës	320 deri 400 m lartësi
Gjatësia e vijës së Brezit Mbrojtës	67.5 km
Sipërfaqja e Brezit Mbrojtës	1'354 ha
-Veshur me lisa	323 ha
-Veshur me pisha	92 ha
-Veshur me shkurre	180 ha
-E zhveshur dhe joproduhëse	177 ha

12.9. Mbulesa bimore dhe ndikimi i njeriut

Zona është banuar qysh herët (shek. VI pas Krishtit) dhe vazhdon edhe sot. Pjesa më e madhe e pellgut është e banuar nga rreth 9 fshatra (Tab. 12-8), me rreth 1'600 familje dhe 5'600 banorë, përjashto dhe disa familje që janë larguar nga përmbytja fillestare e Ujëmbledhësit. Tre fshatra janë në rrethin e Krujës (komuna e Cullit) dhe të tjerët në komunën e Zall Bastarit (Tiranë).

Baza e veprimtarisë ekonomike në zonë e përbën **blegtoaria** (me të imta dhe gjedh), **bujqësia** me drithëra dhe pak biznese në fushën e tregtisë, transportit dhe shërbimeve. Gjithashtu, **prerja e druve** duket se është aktivitete kryesore për mbijetesën e banorëve të zonës. Prerja e druve është mbizotëruese kryesisht për shkak të kërkesës së madhe prej qendrave të mëdha të banuara, në Tiranë dhe Krujë. Është e kuptueshme se kjo bëhet në kurriz të shkurreve dhe pyjeve të zonës. Aktivitet tjetër është dhe **mbledhja në natyrë e bimëve mjekësore**, si *Salvia officinalis*, *Origanum vulgare*, *Thymus* sp., *Hypericum perforatum*, *Crataegus monogyna*, *Rosa canina* etj., me të cilat duket se zona është e pasur. Territori përshkohet nga disa rrugë

automobilistike të pashtuara, që lidhin fshatrat, me ato që lidhin komunat e afërta të Zall Bastarit dhe të Zall Herrit, në rrethin e Tiranës, dhe të Cullit në rrethin e Krujës (Fig. 12-16).

Tabela 12-8. Përbërja e fshatrave brenda pellgut ujëmbledhës të Bovillës / Composition of the villages within Bovilla watershed.

Fshati	Rrethi	Nr. familjeve	Nr. banorëve
Mneri Sipërm	Tiranë, Komuna Zall Bastar	300	973
Vileza, Mal Vileza		330	1246
Zall Bastari, Sheqyrk		305	1028
Bastari i Mesëm		250	850
Zall Mneri (Lucë, Rrëzë, Dushje, Lamej, Kodra Bërdhenit)		<i>shpërngulur</i>	-
Bulcesh		<i>shpërngulur</i>	-
Bruz Mali	Krujë, Komuna Culli	194	694
Bruz Zalli		118	430
Rranzë, Kumardhë		97	289

Ndikimi i njeriut në gjithë pellgun e Bovillës është i madh dhe shumë i dukshëm, sidomos në shpatet veriore dhe lindore. Kur viziton zonën të krijohet bindja e një vendi të braktisur, të harruar, edhe pse është pak kilometra në largësi nga zona më e zhvilluar e vendit. Nuk mungojnë rastet të shohësh kamionë të ngarkuar me trupa (trungje) që vijnë nga pyjet, të cilët i transportojnë në Tiranë. Janë të zakonshme kopetë me dhi që nuk lenë filiz të zgjatet, dhe të pashtetësuar shuajnë etjen në liqen; gjithashtu, në verë zjarret plotësojnë më tej masakrën e mbulesës bimore në këtë zonë strategjike për gjithë vendin.

Pjesët e ulëta, deri në 700-800 m lartësi, janë ndër më të shfrytëzuarat, të cilat kanë shkaktuar ndryshime në biocenozat bimore natyrore; më të degraduarat duket se janë dushkajat, sidomos ato afër zonave të banuara. Prania e madhe e *Juniperus oxycedrus*, *Crataegus monogyna*, *Dorycnium hirsutum*, *Putoria calabrica*, *Stachelina uniflosculosa*, *Saponaria calabrica*, *Rubus ulmifolius*, *Rosa sempervirens*, *Pyrus amygdaliformis*, *Pteridium aquilinum*, *Ononis spinosa*, *Paliurus spina-christi* është dëshmi e proceseve degraduese, shkaktuar kryesisht nga prerjet pa kriter, nga kullotja dhe zjarret (Fig. 17, 23). Gjendja e bimësisë duket më mirë në pjesët e sipërme, në brezin e ahut dhe kullotat malore, por edhe atje nuk mungon shfrytëzimi i tepruar.

Gjendja e bimësisë duket më mirë në lartësitë e mëdha, në brezin e ahut dhe livadhet malore; megjithatë edhe këtu vihet re shfrytëzim i madh i bimësisë. Duke krahasuar hartat topografike (1981), pamjet satelitore dhe fotografite aktuale në terren (2006-2008), vihet re që mbulesa **bimore e formacioneve pyjore në zonën e ahut dhe atë të kullotave malore është e pakësuar me 12-14%**.




Figura 12-16. Vija e pellgut ujëmbledhës të Bovillës me fshatrat. / Watershed line of the Bovilla territory with its villages (Image © Terremetrics, Europe Technologies and Digital Globe, Google Earth 2008).

Në zonën e ulët të shkurretave mesdhetare dhe dushkajave mbulesa bimore duket se është degraduar edhe më tepër (sidomos shpatet verilindore të pellgut ujëmbledhës), nga 18% deri në 22%; nuk janë të pakta zonat e zhveshura plotësisht, pa bimësi (Fig. 12-16 dhe 12-17). Kjo do të thotë se dukuria e gërryerjes është shumë e fortë. Nga ana tjetër, edhe aftësia ujëmbajtëse e dheut në pjesët e zhveshura është shumë e vogël. Sipas Michael & Mayer (2001) nga zhveshja sipërfaqes së tokës me 10-20%, rrjedhjet sipërfaqësore rriten dy herë; ato trefishohen kur zhveshja arrin deri në 35-40%. Kjo shkakton ndryshime në karakteristikat e përrrenjve që ushqejnë Ujëmbledhësin, duke shkaktuar ndryshime të mëdha të nivelit të ujit, rritje të shpejtë gjatë shirave dhe pakësim të dukshëm gjatë stinës së thatë. Formacionet e gërryeshme lehtësisht, zhveshja nga bimësia për hir të

prerjeve dhe reshjet vullshme, kanë nxitur dhe forcojnë vatrat e erozionit, gërryerjen e shpateve dhe rrëshqitjet, veçanërisht gjatë dimrit (Fig. 12-17). Rrëshqitjet më të mëdha takohen në J dhe JL të fshatit Mner.



Figure 12-17. Pamje e pellgut të Bovillës nga Murriza, ku duken sipërfaqe me gërryerje të fuqishme. / View from the Murriza on the hilly landscape of the Bovilla watershed showing the numerous erosion areas (Photos: Shuka).





Figura 12-18. Gjarpërime të lumit të Zall Bastarit në hyrje të Liqenit (*sipër*), me sedimentim të fuqishëm (*poshtë*). / Meanders of the Zall Bastari River (former Terkuza River) approaching the Reservoir (*above*), showing the massive sedimentation (*below*) (Photos: Shuka; September 2006).

Shtrati i Tërkuzës është i mbushur me zallishte që priret të zgjerohet çdo herë e më tepër (Fig. 12-18). Prurjet e tyre natyrisht arrijnë të grumbullohen në ujëmbledhësin e Bovillës. Kjo ndihmohet edhe nga struktura e paqëndrueshme e tokës së këtyre kodrave. Mendohet se **shpejtësia e**

sedimentimit është shumë e lartë, 1-1.3 m/vit, e cila duket edhe nga vlerat shumë të larta të mesatares mujore shumëvjeçare të lëndëve të ngurta pezull në lumin e Tërkuzës, të matura në stacionin e Zall Herrit (Fig. 12-19).

Ndryshimet në mbulesën bimore dhe në përdorimin e tokës ndikojnë në funksionet ekologjike të pellgut (Papastergiadou *et al.*, 2007). Nga gërryerjet masive janë formuar shtrete zallorë përgjatë përrrenjve, ku bimësia është e zëvendësuar nga bimë pak të rëndësishme, si *Pyrocantha coccinea*, *Sparthium junceum* etj. Për të ngadalësuar erozionin, **ka rëndësi prania e disa llojeve tipike të luginave lumore, si *Platanus*, *Salix* etj.**, të cilat duhen mbrojtur dhe mbarështuar.




Figure 12-19. Vlerat mesatare mujore të lëndëve të ngurta pezull (mg/L) për një periudhë shumëvjeçare (1975-1992) në stacionin e Tërkuzës në Zall Herr / Pluriannual average values (mg/L) of total suspended solids (TSS) in the Terkuza river, station in Zall Herri (Murtaç, 2007).

Pellgu i Bovillës i përket ekonomive pyjore të Mner-Bastarit dhe Bruz-Rranxës, përkatësisht, drejtorive të shërbimit pyjor të Tiranës dhe Krujës. Para viteve 90-të janë bërë ripyllëzime me lloje halore (*Pinus halepensis*), si dhe janë ndërtuar edhe prita në përrrenj për të penguar gërryerjen. Murati (2002) pohon se pas viteve 1990 në Brezin Mbrojtës të zonës së Tiranës janë kryer pyllëzime kryesisht me akacie (*Robina pseudoacacia*); masa të tilla ripërtëritëse janë vërejtur prej nesh edhe në ndonjë pjesë tjetër të pellgut, megjithëse, mund të pohojmë se ndikimi është shumë pak ose thujtë aspak i dukshëm në parandalimin e erozionit brenda pellgut. Nga ana tjetër, pyllëzimi me këto lloje nuk është më e përshtatshme mënyrë, po qe se mbahet parasysh struktura flishore dhe argjilore e tokës, si dhe peizazhi; llojet e përdorura varfërojnë larminë bimore natyrore, duke ulur më tej vlerat natyrore të basenit. Për këtë, **nevoja për ripërtëritjen e shkurreve dhe pyjeve dhe për masa të tjera meanxhuese mbetet përsëri mjaft e madhe.**




Figura 12-20. Mesatarja e lëndëve të ngurta pezull (TSS, mg/L) në gjithë kolonën e ujit prej 45 dhe tejpamja (m), në stacionin pranë digës (S1) gjatë periudhës së studimit (korrik 2006 – maj 2008). / Average value of total suspended solids (mg/L) in whole water column (0-45 m of depth) and Secchi disk transparency (m), close to the dam (station S1), during the period of July 06 to May 08.




Figura 12-21. Mesatarja mujore e reshjeve (mm) dhe e temperaturës (°C), në stacionin termometrik të Zall Dajtit, gjatë periudhës së studimit (maj 2006 – maj 2008). / Monthly average rainfall (mm) and temperature (°C) at the Zall Dajti morphometric station, during the study period of May 06 to May 08 (Çullaj et al., Nr. 2 in this volume).

Grimcimi i dheut ndikon në shpejtësinë infiltruese dhe aftësinë ujëmbajtëse (Greenberg *et al.*, 2003). Grimcimi ranor-argjilor prej flishi dhe shisti tek tokat kodrinore që mbizotërojnë në pellg ndikon në zvogëlimin e shpejtësisë depërtuese dhe të aftësisë ujëmbajtëse të tokës, kjo më e theksuar në hapësirat e zhveshura, ku shpëlarja e tyre bëhet më lehtë. Kjo është shumë e dukshme në shpatet e ulëta, deri në 400-900 m, sidomos gjatë dimrit (Fig. 12-17).




Figura 12-22. Mesatarja e fitoplanktonit (qeliza/ml) dhe e klorofilit a (mg/m^3), në gjithë kolonën e ujit prej 45, në stacionin pranë digës (S1), gjatë periudhës së studimit (maj 2006 – maj 2008). / Average values of phytoplankton (cells/ml) and chlorophyll a (mg/m^3), in the whole water column (0-45 m of depth), close to the dam (station S1), during the study period July 06 to May 08 (Çullaj *et al.*, and Koni *et al.*, in this volume).

Erozioni i fuqishëm duket edhe në sasinë e madhe të lëndëve të ngurta që transportohen nga ujërat. Kjo duket edhe nga vlera e lartë e lëndëve të ngurta pezull në ujë, shpesh mbi normën e lejuar të BE-së prej 25 mg/l për ujërat sipërfaqësore natyrore që përdoren për pirje (Council Directive 75/440) ose për peshkim (Council Fish Directive 2006/44) (Fig. 12-19 dhe 12-20). Kjo është shumë me ecurinë e klimës në zonë, sidomos me reshjet (Fig. 12-21).

Gjithashtu, edhe tejpamja e ujërave të Ujëmbledhësit e matur për dy vjet rresht, ishte gjithnjë relativisht e ulët (Fig. 12-20), dhe nuk përputhej gjithmonë me vlerat e klorofileve dhe të fitoplanktonit të matur paralelisht (Çullaj *et al.* dhe Koni *et al.*, në këtë vëllim), të cilat përgjithësisht kanë qenë të ulëta (Fig. 12-22).

Erozioni dhe shtimi i lëndëve të ngurta në ujëra, nga dëmtimi i bimësisë, i ndihmuar edhe nga kushtet fiziko-gjeografike (toka, klima etj.), është vënë re edhe gjetkë në Shqipëri dhe më gjerë, p.sh. në lumenjtë shqiptarë të Ultësirës

Adriatike Perëndimore (Miho et al., 2005), në liqenet e Ohrit dhe të Prespës (Shuka et al., 2005; Löffler et al., 1998; Spirkovski et al., 2001; etj.).

Bujqësia në pellgun e Bovillës është relativisht tradicionale (Fig. 12-24), pa përdorim të madh lëndësh kimike, plehrash dhe herbicidesh. Megjithatë, nga të dhënat duket se ka rreth 12'000 kafshë shtëpiake, shumica e tyre bagëti e imët (dhen dhe dhi), të cilat mbahen të lira në pellg. Cilësia e ujërave të liqenit duket se është e ndikuar nga ndotjet e plehrave dhe jashtëqitjet nga vendbanimet dhe kafshët e tyre, të cilat shpëlahen në ujëra, sidomos gjatë stinës së reshjeve. Kjo është vënë re nga sasia relativisht e lartë e nitrateve dhe amoniumit (Çullaj et al., Nr. 2 në këtë vëllim), si dhe e përmbajtjes relativisht të lartë të ndotjes bakteriale (Emiri et al., Nr. 10 në këtë vëllim). Krahasuar me ujërat e liqenit të Zyriut, Zvicër, ku mbi 800'000 banorë jetojnë rreth tij dhe përdorin ujërat e këtij liqeni po për pirje (*shih* Kaiser, Nr. 7 po në këtë vëllim), ujërat e ujëmbledhësit të Bovillës duket se janë shumë më pak cilësore, për sa i përket lëndëve pezull, nitrateve, amoniumit, dhe përmbajtjes bakteriale. Theksojmë se shtimi i lëndëve ushqyese (fosforit dhe azotit) mund të nxisë eutrofikimin dhe zhvillimin e vrullshëm të algave; kjo krijon vështirësi në pastrimin e ujit, por ndonjëherë lloje të caktuara lëshojnë në ujë lëndë që shkaktojnë erë dhe shije të keqe (Juettner & Watson, 2007), ose dhe me natyrë helmuese (Moestrup, 2004).

Erozioni dhe shkalla e sedimentimit mund të parandalohen duke **ndihmuar shtimin e mbulesës bimore përgjatë përrrenjve dhe tek sipërfaqet e zhveshura**. Së pari, kjo ndihmohet duke kufizuar dhe kontrolluar prerjet, zjarret dhe strukturën e blegtorisë në rajon. **Shumë formacione bimore, shkurresh ose cungishte dushkajash, po qe se lihen të lira mund të ripërtërihen vetë**. Këtu ka shumë rëndësi ndalimi i rreptë i biznesit të drurit me Tiranën dhe Krujën. Nga ana tjetër, është më se domosdoshme që **të ndalohet mbajtja e dhive në gjithë pellgun**. Masa të rëndësishme janë edhe **kontrolli i shpejtësisë së rrjedhjes duke ndërtuar vepra sado të thjeshta hidroteknike**, si prita nëpër përrrenj, ujëmbledhës të vegjël etj.

Masa më e parë e domosdoshme do të ishte **nxitja e pyllëzimit në hapësirën e pellgut**, sidomos në pjesët më të zhveshura, përgjatë përrrenjve, në tokat e braktisura. Kjo do të pengonte edhe shpëlarjet e lëndëve organike, ndotjet bakteriale nga vendbanimet dhe bagëtitë, si dhe gjithë lëndët ndotëse të mundshme nga aktivitete të ndryshme në zonë (Rosenmeier et al., 2002; Austin & Sala, 2002; Zhou et al., 2002). Tipi i bimësisë që duhet mbjellë varet nga karakteristikat e tokës, por këtu **mund të kombinohen nga përzierje bimësh barishtore, shkurresh dhe drurësh nga flora spontane e pellgut**. Për shembull, pyllëzimi mund të bëhet duke mbjellë drurë autoktone natyrorë, si *Quercus frainetto*, *Q. cerris*, *Platanus orientalis*, *Pyracantha coccinea*, *Salix* sp. etj. **Pyllëzimi i Brezit Mbrojtës**, të caktuar tashmë midis kuotave 318 m (niveli normal i ujërave në liqen) dhe 418 m lartësi, do të ishte kërkesa më e shpejtë për të parandaluar prurjet e ngurta dhe mbajtjen e tyre rrugës.



Figure 12-23. a) Turrë me dru në Vilezë; **b)** bagëti (dhi) duke kullotur; **c)** zjarr në shkurretat e Bjeshtit. / **a)** Firewood stocks in Vileza; **b)** Livestock (goats) grazing; **c)** fire in the shrubby forest of Bjeshti (Photos: Shuka & Miho).



Figura 12-24. Peizazh me toka bujqësore në zonën e Bovillës (Zall Herri dhe Vileza). / Agricultural fields in the Bovilla watershed (Zall Herri and Vileza) (Photo: Shuka; September 2006).





Figura 12-25. Gjatë vizitave në pellgun e Bovillës. / During the field trips in the Bovilla watershed (Photos: Shuka).

Kjo gjendje e cilësisë së ujërave është dëshmi edhe e **varfërisë së madhe që mbretëron në zonë**. Që masat e mësipërme të kenë sukses duhet të mbështeten nga një **program serioz ndihme në drejtim të aktiviteteve të tjera të qëndrueshme në zonë**, si **kredi të buta** për pyllëzime, për sistemimin e vendbanimeve, shtëpive, për rrugë të mira për të nxitur lëvizjen e shpejtë të banorëve dhe turizmin natyror në zonë etj. Disa nga familjet janë shumë afër Brezit Mbrojtës të Ujëmbledhësit. Të paktën për këto familje do të ishte e dobishme të gjendesh mundësia e zhvendosjes.

Zona është me shumë vlera natyrore dhe biologjike, dhe për fat të mirë vetëm 20 km larg nga qendra kryesore e banuar në vend, Tirana. Kjo mund të tërhiqte shumë vizitorë që duan natyrën malore, larminë bimore dhe shtazore, ujin e pastër, peizazhin rural, karstin etj., por rruga për t'i shijuar këto është mjaft e papërshtatshme; po kaq e vështirë është për të ndihmuar lëvizjen e banorëve vendas për të kërkuar më shumë mirëqenie për familjet e tyre. **Nxitja e turizmit natyror do të ishte me interes të ndërsjellët** për të dyja palët e interesuara për mbrojtjen e cilësisë së ujit të pijshëm në rajon.

Si kudo gjetkë në Shqipëri, kjo gjendje vjen nga shkalla e ulët e ndërgjegjësimit nga banorët dhe pushteti vendor brenda pellgut (Komunat e Zall Bastarit dhe të Cullit), për përgjegjësinë që kanë për mbrojtjen e cilësisë së ujit të pijshëm; por ndërgjegjësimi i tyre i ka këmbët e lidhura nga varfëria dhe përpjekjet për të mbijetuar, nga harresa dhe mungesa e mbështetjes financiare. Nga ana tjetër, **ndërgjegjësim dhe përgjegjësi akoma më e ulët duket se është nga vetë Kryeqyteti**, nga ministritë përgjegjëse, Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit etj., dhe organizmat e pushtetit vendor në Tiranë, Bashkia, Prefektura, nga instancat e tjera përgjegjëse, si Ndërmarrja e Ujësjellësit etj. Të pretendosh të ruash cilësinë e ujërave vetëm duke hedhur herë pas here rasat ballëgjëri, për zhdukjen e '*algave të bardha*' (!) (Bardhi, 2007), duket më shumë aventurë fantastike-shkencore se e besueshme nga ana praktike.

Kemi bindjen se **zona i ka të gjitha mundësitë të bëhet zonë model për sa i përket ruajtjes së cilësisë së ujërave dhe zhvillimit**, po qe se të dyja palët e interesuara, Kryeqyteti dhe popullsia vendore do të ndërgjegjësohen për rëndësinë që ajo ka; banorët vendas janë përgjegjës për këtë 'minierë floriri', për ruajtjen dhe kujdesin e saj; nga ana tjetër vetë Tirana duhet të nxisë dhe mbështesë sa më shumë të jetë e mundur, çdo lloj aktiviteti në drejtim të ruajtjes dhe menaxhimit të cilësisë së ujërave. Vetëm në këtë mënyrë, Tirana do të jetë e sigurt për cilësinë e ujit që i vjen përditë në rubinet.

Përmbledhje

Pellgu i Bovillës përfshihet kryesisht në dy nënzona klimatike: **mesdhetare kodrinore** (deri në lartësitë 500-600 m) dhe **mesdhetare paramalore** (në lartësitë më të mëdha); megjithatë, në majat e larta duket se është e pranishme edhe **zona klimatike mesdhetare malore**. Në zonën kodrinore mbizotërojnë reshjet e shiut, të shpërndara kryesisht në dy kulme, vjeshtë dhe dimër, kurse majat e maleve mbulohen shpesh me dëborë gjatë dimrit.

Pellgun ujëmbledhës i Bovillës është i pasur me lloje dhe formacione bimore, pavarësisht nga ndikimi i dukshëm i njeriut, dhe degradimi i dukshëm i mbulesës bimore. Gjithsej janë listuar mbi 860 lloje bimësh të larta, rreth 670

dikotiledone, 170 monokotiledone, 8 gjimnosperme dhe 19 lloje fiernash. Tre familjet më të bollshme në lloje janë *Fabaceae* (99 taxa) *Asteraceae* (87), *Poaceae* (76) dhe *Lamiaceae* (55). Format jetësore mbizotërohen nga hemikriptofitet (37%), terofitet (28%) dhe gjeofitet (17%), e cila është dëshmi e hapësirave të hapura (çeltirave) dhe shkallës së madhe të rrëgjimit të kateve shkurre dhe drunore. Edhe spektri korologjik mbizotërohet dukshëm nga format eumesdhetare, e lidhur ngushtë jo vetëm me klimën mesdhetare, por edhe me proceset degraduese të bimësisë në zone. Rreth 18 lloje i përkasin listës së kuqe (2007) të llojeve të kërcënuar, të rralla ose në rrezik zhdukje, *Pinus sylvestris* dhe *Taxus bacata* (gjimnosperme), dhe angjosperme, si *Halascya sendtneri*, *Orchis provincialis*, *Oxytropis purpurea*, *Saxifraga grisebachii* (sensu Hayek), *Cerastium grandiflorum*, *Fritillaria macedonica* dhe *Ramonda serbica*. Pesë lloje përmenden si endemike, si *Aster albanicus* (*Asteraceae*), *Colchicum pieperanum* (*Liliaceae*), *Forsythia europaea* (*Oleaceae*), *Gymnospermium shqipetarum* (*Berberidaceae*) dhe *Pinguicula hirtiflora* var. *louisii* (*Lentibulariaceae*); kurse 8 të tjera si subendemike: *Orchis albanica* (*Orchidaceae*), *Cerastium grandiflorum* (*Caryophyllaceae*), *Chamaecytisus tommasinii* (*Leguminosae*), *Colchicum lingulatum* (*Liliaceae*), *Sesleria robusta* ssp. *scanderbeggii* (*Gramineae*), *Solenanthus scardicus* (*Boraginaceae*), *Teucrium arduini* (*Labiatae*) dhe *Vincetoximum huteri* (*Asclepidaceae*).

Bimësia e pellgut përfshin zonat fitoklimatike të shkurreve dhe pyjeve mesdhetare, të dushqeve, të ahut, dhe të kullotave malore. Shoqërimet më të bollshme janë pyjet dhe shkurretat gjetherënëse (*Carpino-Pistacetum terebinthii*), makja tipike mesdhetare (*Myrto-Quercetum ilicis*), shkurretat përherë të blerta (*Myrto-Quercetum ilicis* dhe *Arbuto-Quercetum ilicis*), pyjet termofile gjethegjera ose dushkajat (*Quercu-Carpinetum submediterraneum* dhe *Quercetum frainetto-cerris*), pyjet mesofile mesdhetare malore të ahut (*Ostryo-Fagetum* dhe *Luzulo-Fagetum*). Janë me interes edhe formacionet e veçuara, si rrepishtet (*Platanetum orientalis-balkanicum*) buzë lumenjve dhe përrenjve, ndonjëherë shumë të rralla të pyjeve gjethegjere paramalorë (*Quercu-Castanetum submediterraneum*), pyjeve halorë (*Fago-Pinetum heldreichii*) etj. Hapësira të bollshme janë pushtuar nga formacione që përfaqësojnë dushkaja të degraduara (*Pruno-Crataegetum* dhe *Pruno-Juniperetum*), sidomos pranë zonave të banuara dhe në toka të braktisura, disa prej të cilëve janë në gjendje të pakthyeshme. Bimësia barishtore është e përhapur në gjithë hapësirat e zhveshura midis pyjeve dhe shkurreve (çeltirat) dhe në zonën e kullotave malore mbi 1'500 m lartësi; ajo përfaqësohet nga kullotat e thata gurishtore malore, me *Festuco-Brometum*, *Teucrium montanum-Stipetum pengata*, *Festucetum bosniaca-Thymus cherlerioides*, *Saturetum montona* etj. Vend të rëndësishëm zënë dhe livadhet gjysmë të thata me *Pteridio-Agristietum capillaries* dhe *Thymus striatus-Agristietum capillaries*, dhe livadhe të vërteta, me *Poa media-Festucetum panciana*, *Cynosuro-Trifolietum pratense*, *Phleum*

alpinum-Koleretum splendens, Asphodelus albus-Narcissus poeticus. Livadhet mesofile të ftohta me *Poa media-Nardetum* përhapen vende-vende në shpatet dhe gropat më të freskëta, me kundrejtim verior.

Ndikimi i njeriut në gjithë pellgun është i madh dhe shumë i dukshëm, sidomos në shpatet veriore dhe lindore. Pjesët e ulëta, deri në 700-800 m lartësi, janë ndër më të shfrytëzuarat, të cilat kanë shkaktuar ndryshime në biocenozat bimore natyrore; më të degraduarat duket se janë dushkajat, sidomos ato afër zonave të banuara. Mbulesa bimore e formacioneve pyjore ose shkurre e majave të lartë duket se është e pakësuar me 12-14%. Në zonën e ulët të shkurretave mesdhetare dhe dushkajave mbulesa bimore duket se është degraduar nga 18% deri në 22%; nuk janë të pakta zonat e zhveshura plotësisht, pa asnjë mbulesë bimore, Kjo ka sjellë si pasojë erozionin e fuqishëm dhe shtimin e lëndëve pezull në ujëra, shpesh mbi 25 mg/L që është norma e lejuar e BE-së për ujërat sipërfaqësore që përdoren për të pirë. Liqeni i nënshtrohet një procesi sedimentues me lëndë të ngurta mjaft të fuqishëm, e cila mendohet të jetë 1-1.3 m në vit. Zhveshja e tokës, e ndihmuar dhe nga struktura flishore-argjilore e kodrave bën që aftësia ujëmbajtëse të jetë e pakët dhe ujërat në liqen të luhaten dukshëm gjatë shirave.

Blegtoria dhe prerja e druve duket se janë aktivitetet kryesore që mbështesin mbijetesën e banorëve të zonës, popullsi me mbi 5'600 banorë të shpërndarë në rreth 9 fshatra. Prerja e druve është mbizotëruese kryesisht për shkak të kërkesës së madhe prej qendrave të mëdha të banuara, në Tiranë dhe Krujë. Mbi 12'000 kafshë shtëpiake, shumica e tyre bagëti e imët (dhen dhe dhi) mbahen të lira në pellg. Megjithëse, bujqësia duket se është tradicionale, pa përdorim plehrash, ndikimi i njerëzve dhe i bagëtisë në ndotjen e ujërave të liqenit është e dukshme, sidomos në nitrate, amonium dhe përmbajtje bakteriale.

Erozioni dhe shkalla e lartë e sedimentimit mund të parandalohen duke ndihmuar shtimin e mbulesës bimore, duke filluar së pari nga Brezi Mbrojtës, përgjatë përrenjve dhe tek sipërfaqet e zhveshura. Shumë formacione bimore, shkurre ose cungishte dushkajash, po qe se lihen të lira mund të ripërtërihen vetë. Është më se domosdoshme që të ndalohet mbajtja e dhisë në gjithë rajonin. Masë e domosdoshme do të ishte nxitja e pyllëzimit në hapësirën e pellgut, sidomos në zonën rreth liqenore të **Brezit Mbrojtës** (320 -420 m lartësi mbi det) si dhe në pjesët më të zhveshura, përgjatë përrenjve, në tokat e braktisura. Brezi Mbrojtës duhet të shpallet jo vetëm *de juro* Zonë Qendrore rreptësisht e mbrojtur, por të mirëmbahet realisht dhe mbrohet me masa të kujdesme dhe të vazhdueshme. Tipi i bimësisë mund të kombinohet nga përzierje bimësh barishtore, shkurre dhe drurësh nga flora spontane e pellgut. Masa të rëndësishme janë edhe ndërtimi i veprave sado të thjeshta hidroteknike, si prita nëpër përrenj, ujëmbledhës të vegjël etj. Po qe se menaxhohet me kujdes, edhe mbledhja e bimëve natyrore, për të cilën flora e zonës dallohet, mund të bëhet një drejtim i rëndësishëm dhe fitimprurës.

Që masat e mësipërme të kenë sukses duhet të mbështeten nga një program serioz ndihme në drejtim të aktiviteteve të tjera të qëndrueshme në zonë, si kredi të buta për pyllëzime, për sistemimin e vendbanimeve, shtëpive, për rrugë lidhëse të mira për të lëvizjen e shpejtë të banorëve etj. Nxitja e turizmit natyror do të ishte me interes të ndërsjellët për të dyja palët e interesuara për mbrojtjen e cilësisë së ujit të pijshëm në rajon.

Kjo gjendje vjen edhe nga shkalla e ulët e ndërgjegjësimit të banorëve dhe pushtetit vendor brenda pellgut, e kushtëzuar edhe nga varfëria e thellë, nga harresa dhe mungesa e mbështetjes financiare. Por shkallë akoma më e ulët ndërgjegjësi dhe përgjegjësie duket nga Tirana, nga organizmat e pushtetit vendor dhe atij qendror, si Bashkia, Prefektura, Ministria e Mjedisit dhe e Punëve Publike etj. Prej vitit 2006, gjithë hapësira e pellgut ujëmbledhës të Bovillës është përfshirë në Parkun Kombëtar të Dajtit (të zgjeruar). Të shpallësh zonën hapësirë të Parkut Kombëtar nuk mjafton në se kjo nuk shoqërohet me masa praktike mbrojtëse, mbikëqyrëse, për të luftuar varfërinë në zonë dhe mbrojtur cilësinë e ujërave njëkohësisht. Zona i ka të gjitha mundësitë të bëhet zonë model për sa i përket ruajtjes së cilësisë së ujërave, po qe se të dyja palët e interesuara, Kryeqyteti dhe popullsia vendore do të ndërgjegjësohen për rëndësinë e saj.

Falënderim

Z. N. Dragoti, Drejtorja e Politikave të Mbrojtjes së Natyrës, Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, na ndihmoi me një hartë me ngjyra të zonimit të Parkut Kombëtar të Dajtit (të zgjeruar), të cilën ne e kemi paraqitur në f. 298. Gjithashtu, Prof. P. Hoda i Kopshtit Botanik të Tiranës, FShN, UT, na vuri në dispozicion listën e plotë të llojeve bimore të gjetura prej tij dhe Dr. A. Kalajnxhiu, po në Parkun Kombëtar të Dajtit. Përfitojmë nga rasti të falënderojmë të dy kolegët për bashkëpunimin.

Literatura

2000/60/EC: The Water Framework Directive - integrated river basin management for Europe. Directive 2000/60/EC of the European Parliament and of the Council establishing a framework for the Community action in the field of water policy, adopted on 23 October 2000.

(http://ec.europa.eu/environment/water/water-framework/index_en.html)

2006/44/EC Fish Directive: Directive 2006/44/EC of the European Parliament and of the Council of 6 September 2006 on the quality of fresh waters needing protection or improvement in order to support fish life. Official Journal of the European Union. 264/20—264/31

(<http://rod.eionet.europa.eu/show.jsv?id=626&mode=S>)

Anonymous (1979): Convention on the Conservation of European Wildlife and Natural Habitats. Appendix I. Berne

Anonymous (1988-2000): Flora e Shqipërisë. Ak. Shkencave (Ed.). Vol. 1, 1988: 1-456; Vol. 2, 1992: 1-446; Vol. 3, 1991: 1-332; Vol. 4, 2000: 1-502

Anonymous (1996?): Eco-Guide – Dajti National Park / Parku Kombëtar i Dajtit. WWF & Phare Ed., Roma, Italia: 1-16

12. Mersinllari et al. *Bimësia dhe përdorimi i tokës në pellgun e Bovillës*

- Anonymous* (1997): Vëzhgim ekologjik i pyjeve të virgjër të Shqipërisë. World Bank Ed., Instituti i Kërkimeve Pyjore të Kullotave, Instituti i Kërkimeve Biologjike, Muzeu i Shkencave Natyrore. Tiranë: 1-332 (with a summary in English)
- Anonymous* (2004): Plani i Manaxhimit i Parkut Kombëtar të Dajtit. Menaxhimi i Biodiversitetit. DHV Agriculture and Natural Resources BV, Halcrow Rural Management, UK, DAVA. Shoqata e Zhvillimit Ndërkombëtar, IDA
- Anonymous* (2008): Libri i Kuq i Florës Shqiptare. Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave. Tiranë. Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave (MMPAEU Ed.). Tiranë. 1-256
- Bachofen R. (2008): Solving environmental problems by transdisciplinary research. Proceedings of International Conference on Biological and Environmental Sciences. University of Tirana, Faculty of Natural Sciences: 708-712
- Bardhi E. (2007): Bovilla, hidhen 60 mijë peshq për të përmirësuar cilësinë e ujit. Shtunë, 10 Nëntor 2007, 09:19:00. <http://www.shekulli.com.al/news/231/ARTICLE/17639/2007-11-10.html>
- Buzo K. (1989): Vështrim i përgjithshëm gjeobotanik i masiveve kryesore të kullotave dhe livadhe natyrore të Shqipërisë. Doktoratë. FShN, UT. Tiranë
- Council Directive 75/440/EEC of 16 June 1975 concerning the quality required of surface water intended for the abstraction of drinking water in the Member States as amended by Council Directive 79/869/EEC (further amended by Council Directive 81/855/EEC and Council Regulation 807/2003/EC) and both amended by Council Directive 91/692/EEC (further amended by Regulation 1882/2003/EC). <http://rod.eionet.europa.eu/instruments/202>
- Davies C.E., Moss D. (1997): EUNIS Habitat Classification., Final Report, European Topic Centre on Nature Conservation, Task 7.5.1.
- Demiri M. (1983): Excurionist Flora of Albania. Shtëpia Botuese e Librit Shkollor. Tirana. (*in Albanian*): 1-985
- Dring J., Hoda P., Mersinllari M., Mullaj A. (2002): Plant communities of Albania - A preliminary overview. *Annali di Botanica, Nuova Serie, Vol. II*: 7-30
- Dumishllari I. (2006): Studim i diversitetit bimor në zonën Dajt – Mali me Gropa. Doktoratë. Departamenti Biologjisë, FShN. Uiniveriteti Tiranës
- Dumishllari I., Buzo K. (2008): Karakteristika dhe vlera të diversitetit bimor në zonën Dajt-Qafëmolle-Mali me Gropa. Proceedings of International Conference on Biological and Environmental Sciences. University of Tirana, Faculty of Natural Sciences: 429-435
- Greenberg M., Mayer H., Miller T., Hordon R., Knee K. (2003): Reestablishing Public Health and Land Use Planning to Protect Public Water Supplies. *Am. J. Public Health*. 93(9): 1522–1526
- Greuter W., Raus Th. (Eds.) (2001): *Med-Cheklis Notulae*, 20. *Wildenowia*, 31:319-321
- Hoda P. (1989): Studim gjeobotanik i pyjeve të pishës së zezë (*Pinus nigra* Arn.) në Shqipëri. FShN, UT. Tiranë
- Juettner F., Watson B. S. (2007): Biochemical and Ecological Control of Geosmin and 2-Methylisoborneol in Source Waters. *Applied and Environmental Microbiology*, July 2007: 4395–4406
- Kabo M. (ed.) (1990-91): *Physical Geography of Albania*, Albanian Academy of Sciences. Geographic Centre. Tirana. (*In Albanian*), Vol. I, 1990: p. 400; Vol. II, 1991, p. 590.
- Kalajnxhiu A. (2006): Vlerësimi i biodiversitetit floristik e vegetacional të Parkut Kombëtar (të propozuar) të Dajtit. (Doktoratë), UBT.Tiranë
- Kalajnxhiu A., Proko A., Hoda P. (2004): Mbi florën e Parkut Kombëtar të Dajtit. *Rev. Shqiptare e Shkencave Bujqësore*, 3(4), Tiranë: 24-28
- Kodra B. (2002): Diskutim mbi masat që duhen marrë për minimizimin e ndotjes së ujit të ujëmbledhësit të Bovillës. *Ne dhe Mjedi*, 22. ShRMMNSh. Tiranë: 13
- Krutaj F., Dumishllari I., Buzo K. (2006): Environmental and plant diversity of beech zone in Dajt (Mali me Gropa). *Albanian Journal of Natural and Technical Sciences (AJNTS)* (Academy of Sciences, Tirana, Albania) Nr: 19/20: 205-212
- Markgraf F. (1931): *Pflanzen aus Albanien 1928*. *Denkschr. Akad. Wiss.Wien. Math.- Nat. kl.* 102: 317-360 + 1 plate + 1 map
- Mersinllari M. (1988): Studim gjeobotanik i ahishteve të vendit tonë. FShN, UT. Tiranë

- Michael J.P., Meyer J.L. (2001): Streams in the Urban Landscape, *Annu. Rev. Ecol. Syst.*, 32: 333-365.
- Miho A., Cullaj A., Hasko A., Lazo P., Kupe L., Schanz F., Brandl H., Bachofen R., Baraj B. (2005): Gjendja mjedisore e disa lumenjve të Ultësirës Adriatike Shqiptare. SCOPES program (Swiss National Science Foundation - SNSF), Tirana (In Albanian with a summary in English) : 1-235 (<http://www.fshn.edu.al/biologjia/SCOPES/007-008-Pasqyra-Content.htm>)
- Mitrushi I. (1955): Drurët dhe Shkurret e Shqipërisë. Instituti i Shkencave. Tiranë: 1-604
- Mitrushi I. (1966): Dendroflora e Shqipërisë. Tiranë.
- Murati M. (2002): Mendime mbi përmirësimin e ujëmbledhësit të Bovillës duke shmangur burimet e ndotjes së tij. *Ne dhe Mjedisit*, 22. ShRMMNSh. Tiranë: 12-13
- Murtaj B. (2007): Vlerësime kimiko-limnologjike të liqenit të Bovillës, Mikrotezë, Departamenti i Kimisë, FShN, Universiteti i Tiranës
- Murtaj B., Çullaj A. (2008): Limnologic assesment of Bovilla basin. Proceedings of International Conference on Biological and Environmental Sciences. University of Tirana, Faculty of Natural Sciences: 688-692
- Papadhoppulli G. (1987): Bimët mjekësore dhe aromatikë të Shqipërisë. Tiranë
- Paparisto K., Qosja Xh., Demiri M. (1961): Flora e Tiranës. Universiteti Shtetëror i Tiranës. Tiranë: 1-520 + vëllimi i Ikonografisë
- Pignatti S. (1982): Flora d'Italia. Vol. 1-3. Bologna
- Qiriazhi P., Sala S. (2006): Monumentet e Natyrës së Shqipërisë. Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave. IDEART (Ed.). Tiranë. 1-160
- REC (Ed.) (1997): Libri i Kuq (Botime, Shoqërimi Bimore dhe Kafshë të Rrezikuara). Shoqata për Ruajtjen dhe Mbrojtjen e Mjedisit Natyror në Shqipëri, Shoqata për Ruajtjen e Shpendëve dhe Gjitarëve të Shqipërisë, Shoqata e Biologëve të Shqipërisë. The Regional Environmental Center (REC), Tiranë: 1-312
- Rosenmeier M. F., Hodell D. A., Brenner M., Curtis J. H., Martin J. B., Anselmetti F. S., Ariztegui, D., Guilderson T. P. (2002): Influence of vegetation change on watershed hydrology: implications for paleoclimatic interpretation of lacustrine $\delta^{18}O$ records, *Journ. of Paleolimnology*, Vol. 27, 1: (15): 117-131
- Shuka L., Malollari I., Veizaj D. (2005): Assessment of phosphates and nitrates effects in water's quality of Ohrid and Prespa lakes. *Journ. of Envir. Protec. and Ecology*. Vol. 6, No 4: 761-770
- Shuka L., Xhulaj M., Kashta L., Casper S. J. (2007): The genus *Pinguicula* (*Lentibulariaceae*) in Albania - a critical review. *Klagenfurt. Wulfenia*, 14: 15-65.
- Spirkovski Z., Avramovski O., Kodzoman A. (2001): Watershed management in the Lake Ohrid region of Albania and Macedonia. *Lakes & Reservoirs: Research and Management*, 6: 237-242
- Urdhër 146 (2007): URDHËR Nr.146, datë 8.5.2007 'Për miratimin e listës së kuqe të florës dhe faunës'. Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave. Tiranë (<http://qpz.gov.al/>)
- Vangeli J. (1982): Studim gjeobotanik i rrobullit – *Pinus heldreichii* Crist subs. *leucodermis* (Antoine) Markgraf në Shqipëri. Disertacion). FShN, UT. Tiranë
- Vangeli J. (1993): Analiza taksonomike, floristike, fitosociologjike dhe të dhëna ekologjike mbi dushkajat e Shqipërisë. Doktoratë. Qendra e Kërkimeve Biologjike, Akademia e Shkencave, Tiranë
- Vangeli J., Ruci B., Mullaj A. (1995): Libri i Kuq – Bimët e kërcënuara dhe të rralla të Shqipërisë. Akademia e Shkencave, Instituti i Kërkimeve Biologjike, Tiranë. 1-169
- VKM 402 (2006): VKM Nr.402 dt.21.06.2006 Për shpalljen e ekosistemit natyror të malit të Dajtit 'Park Kombëtar' (me sipërfaqe të zgjeruar): 1-4 (<http://www.moe.gov.al/cms/>)
- VKM 49 (2007): VKM Nr. 49 dt.31.01.2007 Për shpalljen e ekosistemit natyror të Malit me Gropa-Bizë-Martanesh 'Peisazh i Mbrojtur': 1-3 (<http://www.moe.gov.al/cms/>)
- Walter S., Gillet J. H. (1998): IUCN Red List of Globally Threatened Species. IUCN.
- Zhou G., Wang Y., Wang S. (2002): Response of grassland ecosystems to precipitation and land use along the Northeast China Transect, *Jou. of Veg. Science*, 2002, 13: 361-368

SHTOJCA / ANNEX XII

Tabela XII-1. Lista e plotë e llojeve bimore të gjetura në zonën Dajt-Mali me Gropa-Bovillë (PK i Dajtit - i zgjeruar), të rifreskuara. / Checklist of plant species from Dajti-Mali me Gropa-Bovilla (Dajti NP - extended), updated data from *Anonymous* (2004), Kalajnxhiu (2006) and Dumishllari (2006).

Pteridophyta (Fierna): 19 taksone

Asplenium adiantum-nigrum, shkëmb
Asplenium onopteris, shkëmb
Asplenium trichomanes, shkëmb
Athyrium filix-femina, shkëmb
Ceterach officinarum, shkëmb
Cystopteris fragilis, çeltirë
Dryopteris filix-mas, pyll i lirë
Dryopteris villarii, shkëmbinjtë malorë
Equisetum arvense, vend i lagët
Equisetum maxima, hijetirë, lagët

Equisetum palustre, cektinë uji
Equisetum telmatea, buzë kanalesh
Ophioglossum vulgatum, livadhe, pyje
Polypodium vulgare, mure, shkëmbinjtë
Polystichum aculeatum, pyje malorë
Polystichum lonchitis, pyll, shkëmb
Polystichum setiferum, pyll
Pteridium aquilinum, livadhe, çeltira
Ptilostemon afer, çeltira

Gymnospermae (Halore): 8 taksone

Abies alba, pyll
Juniperus communis, shkurretë
Juniperus oxycedrus, shkurretë
Pinus halepensis, pyll

Pinus heldreichii (= *P. leucodermis*), pyll, shkëmbinjtë
Pinus nigra, pyll
Pinus sylvestris, pyll, shkëmbinjtë
Taxus bacata, pyll

Angiospermae – Dicotyledonae: 669 taksone

Acacia dealbata, e kultivuar
Acanthus spinosus, djerrinë, shkëmb
Acer campestre, pyll
Acer monspessulanum, pyll
Acer negundo, e kultivuar
Acer obtusatum, pyll
Acer platanoides, pyll
Acer pseudoplatanus, pyll
Acer tataricum, pyll
Achillea ageratifolia, shkëmb
Achillea holosericea, livadh
Achillea millefolium, livadh
Acinos alpinus, livadh
Acinos arvensis, djerrinë
Adenostyles alliariae, pyll dhe pranë përrenjve
Aethionema saxatile, shkëmb
Agrimonia eupatoria, livadh, shkurretë
Ajuga chamaepitys, djerrinë
Ajuga genevensis, buzë pylli
Ajuga reptans, vend i lagët, pyll
Alkana graeca, pyll
Altheae hirsuta, çeltirë
Alyssoides sinuata, vende gurishtore
Alyssum alyssoides, djerrinë
Alyssum repens, djerrinë
Alyssum sibiricum, anash arave

Amelanchier ovalis, çeltira malore
Anagallis arvensis, djerrinë
Anagallis caerulea, djerrinë
Anchusa cretica, djerrinë
Anchusa officinalis, djerrina
Anemone apenina, pyll
Anemone nemorosa, pyll
Anthemis triumfeti, djerrinë
Anthylus vulneraria, kullotë
Arabidopsis thaliana, shkurretë
Arabis alpina, shkëmbinjtë malorë
Arabis caucasica, djerrinë
Arabis hirsuta, djerrinë
Arabis muralis, gurë
Arabis pseudoturritis, çeltirë
Arabis turrita, shkurretë
Arenaria leptoclados, djerrina gurishtore
Arenaria serpyllifolia, djerrina gurishtore
Arbutus unedo, shkurretë, makje
